



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I JASHTËM I VLERËSIMIT

Nr.14/203 Prot

Tiranë, më 24/08/2020

V E N D I M

Nr.22 datë 19/08/2020

Trupa e vlerësimit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, e përbërë nga:

KRYESUES: Luljeta QOKU
RELATORE: Sonila KADAREJA
ANËTAR: Ledian RUSTA

asistuar nga anëtarë i Sekretariatit Teknik Suela Pashaj, më datë 19/08/2020, ora 09:55, në Tiranë, në Pallatin e Koncerteve, (*Ish –Pallati i Kongreseve*), salla B, kati 0, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore që i përket:

SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT: **Gjovalin Bardhok Loka**, i datëlindjes 12/11/1967, lindur në Mirditë dhe banues Tiranë, me funksion *Drejtor i Departamentit të Sigurisë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit*.

OBJEKTI: **Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit**

BAZA LIGJORE: **Ligji Nr.12/2018** “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” (i ndryshuar);
Ligji Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”(i ndryshuar);
Ligji Nr.49/2012 “Per Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” (i ndryshuar);
Rregullorja e Brendshme e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit,
Rregullorja për Miratimin e Hapave Proceduralë të Unifikuar për Procesin e Vlerësimit.

TRUPA E VLERËSIMIT TË KOMISIONIT TË JASHTËM TË VLERËSIMIT

pasi dëgjoji gjetjet bazuar në arsyetimin ligjor si dhe rekomandimin e relatores së çështjes Znj.Sonila Kadareja, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoji subjektin e vlerësimit Z.Gjovalin Bardhok Loka, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të Ligjit 12/2018 të ndryshuar,

V Ë R E N:

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit (këtu e në vijim Komisioni) është organi kompetent që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” (i ndryshuar) (këtu e në vijim ligji i vlerësimit 12/2018 (i ndryshuar)

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Sipas përcaktimeve të neneve 2, 3 pika “17” dhe “18” dhe neneve 4 e 6 të Ligjit të Vlerësimit nr. 12/2018 (i ndryshuar), shtetasi Gjovalin Bardhok Loka, është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, për arsye të funksionit të tij “Drejtor i Departamentit të Sigurisë Publike” në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Në kohën e dorëzimit të deklaratës “vetting” subjekti Gjovalin Loka mbante postin aktual.

Subjekti i vlerësimit, Gjovalin Loka, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 3/6/2019, nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit në përputhje me Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit”.

Trupa e Komisionit, në veprimet e saj procedurale, menjëherë pas hedhjes së shortit dhe marrjes së dokumentacionit të depozituar nga subjekti në zbatim të Ligjit të Vlerësimit nr.12/2018 (i ndryshuar), konstatoi se subjekti ka paraqitur konform ligjit dhe në afatin e përcaktuar në këtë ligj, datë 4/5/2018, të tre deklaratat, për kontrollin e pasurisë, kontrollin e figurës si dhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale. Formulari i pasurisë ka numër Indeksi Nr.618, viti 2018.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga Luljeta Qoku (Kryesuese) Sonila Kadareja (Relatore) dhe Ledian Rusta (Anëtar).

Trupa e vlerësimit në përputhje me Ligjin e Vlerësimit nr.12/2018 (i ndryshuar) si edhe në bazë të Rregullores së Brendshme të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit (*miratuar me Vendimin nr.17 datë 31/5/2019 “Për Hapat Proceduralë të Unifikuar gjatë Vlerësimit të Subjekteve nga Trupa e Vlerësimit”*), me Vendimin nr.1, datë 18/6/2019, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Gjovalin Loka.

1. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 24/6/2019 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
2. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Komision në datën 24/6/2019 duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
3. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit të Vlerësimit nr.12/2018 (i ndryshuar), duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
4. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit të vlerësimit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
 - a) *vlerësimin e pasurisë;*
 - b) *kontrollin e figurës;*
 - c) *vlerësimin e aftësive profesionale.*
5. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
6. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në Ligjin e vlerësimit nr.12/2018 (i ndryshuar), Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”(i ndryshuar), duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit në Ministrinë e Brendshme që janë:
 - *Deklarata e Pasurisë,*
 - *Deklarata për Kontrollin e Figurës dhe*
 - *Formulari i Vetëvlerësimit Profesional;*
 - *Provat shkresore / dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje Ligjin nr.12/2018.*
 - *Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit si edhe, ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gadishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*
7. Trupa e vlerësimit në datën 28.05.2020 pasi dëgjoji relatorin dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë ndjekur të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Gjovalin Loka, me Vendimin nr.2 datë 28.05.2020, vendosi:

Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Gjovalin Loka, me funksion *Drejtor i Departamentit të Sigurisë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit*.

- ❖ Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - ✓ *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 - ✓ *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*
 - ✓ *Të drejtën e subjektit për t'u njohur me dosjen, zyrën/vendin ku mund të njihet dosja, si dhe të marrë një kopje të tyre, me përjashtim kur subjektit i kufizohet kjo e drejtë në rastet e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror”. Dosja i vihet në dispozicion subjektit sipas neneve 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke respektuar të drejtat e palëve sipas neneve 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative.*
 - ✓ *Të drejtën e subjektit për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve apo marrjen e çdo prove mbështetëse. Kjo kërkesë duhet të përmbajë të gjitha informacionet e nevojshme për identifikimin dhe kontaktimin e dëshmitarit, si dhe të dhënat mbi thelbin e informacionit të pritshëm.*
 - ✓ *Afatin brenda të cilit duhet të bëjë kërkesën me shkrim për njohjen me dosjen dhe të paraqesë prova/shpjegime me shkrim apo të bëjë kërkesa në përputhje me pikat “d” dhe “e” të pikës 3 të Rregullores së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit për hapat proceduralë të unifikuar gjatë vlerësimit të subjekteve nga Trupa e Vlerësimit.*
- 8. Hetimi administrativ përfshiu edhe “personat e lidhur” apo “persona të tjerë të lidhur” në kuptim të pikës 11 të nenit 3 dhe neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe pika 1 e nenit 34 e Ligjit të Vlerësimit nr.12/2018 (i ndryshuar).
- 9. Në datën 14/08/2020, trupa e vlerësimit nëpërmjet kryesuesit të seancës, njoftoi subjektin e vlerësimit për mbajtjen e seancës dëgjimore në datën 19 Gusht 2020, ora 9.30, në Pallatin e Koncerteve, (*Ish –Pallati i Kongreseve*), salla B, kati 0, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit nr.12/2018 (i ndryshuar).

II. SEANCA DËGJIMORE

-) Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit Gjovalin Loka, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr.12/2018, (i ndryshuar) si dhe Kodin e Procedurave Administrative.
-) Gjatë seancës dëgjimore, pas fjalës së relatorit, subjekti i vlerësimit parashtrori disa shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e vlerësimit në tërësi të kryer ndaj tij (*të regjistruar në materialin audio në seancë dëgjimore*).
-) Në fund të seancës dëgjimore datë 19.08.2020, subjekti i vlerësimit Gjovalin Loka kërkoi konfirmimin në detyrë. Po në këtë datë Trupa e vlerësimit shpalli vendimin për subjektin e vlerësimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

- J) Subjekti i vlerësimi Gjovalin Loka ka qenë bashkëpunues dhe korrekt gjatë gjithë procesit të vlerësimit në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të Ligjit të Vlerësimit nr.12/2018(i ndryshuar);
- J) Subjekti ka paraqitur që në fazën e dorëzimit të deklaratave edhe dokumentacion shoqërues të vlerësuar nga ana e tij, si dhe gjatë gjithë fazës së hetimit administrativ, gjatë komunikimit dhe pyetjeve të drejtuara në mënyrë të vazhdueshme nga relatorja, është përgjigjur dhe ka përcjellë dokumentacion shoqërues/justifikues shtesë me qëllim vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive sipas rastit si dhe rrethanave të tjera të çështjes të lidhura me komponentin e figurës për sqarim siç kërkuar nga ana e relatores. Paraqitja e plotë e dokumenteve, që vërtetojnë ligjshmërinë e burimeve të të ardhurave, veprimeve të tjera juridike dhe fakte e prova të lidhura me komponentët e kontrollit të figurës dhe besueshmërisë së deklarimeve personale, u vlerësuan bashkë me rrethanat e tjera për marrjen e vendimit të vlerësimit.

IV – A) VLERËSIMI I PASURISË

- 🚩 Vlerësimi i Pasurisë është kryer bazuar në dispozitat që normon neni 31 -34 i ligjit 12/2018.
- 🚩 Objekt i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për punonjësin dhe për personat e lidhur me të.
- 🚩 Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32¹ dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të Ligjit të Vlerësimit nr.12/2018 bazuar në të cilin trupa e vlerësimit, zhvillon një procedurë kontrolli, në përputhje me këtë ligj, si edhe në ligjin Nr.9049/2003 “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të Personave të Zgjedhur dhe Nëpunësve të Caktuar Publikë”, ligjin Nr. 9367/2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, ligjin Nr.9917/2008 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, si dhe Kodin e Procedurave Administrative.
- 🚩 Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer veprimet verifikuese, ku Komisioni me anë të korrespondencës të rregjistruar me numër 14, ka kërkuar të dhëna në institucionet bankare në vend, institucionet financiare dhe jofinanciare, Kadastër, ZRPP rajonale, ALUIZNI, DPSHTRR, QKB, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, DPPP, ISSH, rregjistrin noterial, OSHEE, Ujësjellës Kanalizime, kompanitë e komunikimit telefoniks fix etj. Gjithashtu Komisioni ka mbajtur në konsideratë deklaratimet e vet subjektit për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar si dhe gjatë pyetësorit sqarime të tjera financiare për burim të ardhurash apo mbulim shpenzimesh/huash për personat e lidhur dhe të tjerë të lidhur.

¹ Neni 32 “Fillimi i procedurës për deklarimin e pasurisë” 1. Punonjësi deklaron çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar që nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, pavarësisht datës së emërimit në pozicionin dhe/ose gradën që mban, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, sipas shtojcës nr.1, bashkëlidhur këtij ligji. Ky deklarim fillon ditën e parë të marrëdhënies së punës.

Hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë edhe në saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklaramëve periodike të subjektit pranë ILDKPKI për ato vite kur ka qenë subjekt deklarimi në ILDKPKI krahasuar me ato të deklaratës “Vetting” duke kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, shlyerja e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të. Në zbatim të nenit 34, pika 3, Trupa vlerësuese është treguar e kujdesshme lidhur me marrjen e këtyre deklaramëve dhe vlerësimin e tyre në funksion të zbatimit të detyrimeve ligjore sipas ligjit për deklarimin e pasurisë dhe të raportit të rëndësisë që mbartin ato në vetvete krahasuar me deklaratën e pasurisë vetting 2018. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, si organ i ngritur në zbatim të Ligjit nr. 12/2018 të vlerësimit kalimtar, ka për prioritet dhe bazë thelbësore plotësimin e drejtë si dhe pasqyrimin dhe hetimin e çdo të dhëne pasurore, financiare, detyrime e shpenzime që i rezultojnë subjektit që nga koha e marrjes së detyrës në strukturat e policisë së shtetit e deri në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 12/2018 (i ndryshuar), kur i lind edhe detyrimi ligjor për të deklaruar interesat e tij privatë dhe aktet ligjore lidhur me to. Ndaj dhe KJV për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë, i ka vlerësuar këto deklarata së bashku me provat e tjera në tërësi dhe harmoni me të gjitha rrethanat e çështjes.

DEKLARIM I PASURIVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT, GJOVALIN LOKA
Në deklaratën vetting 2018, subjekti deklaron:

A) I. DEKLARATA E PASURISË

Pasuria Nr.1 :Subjekti ka deklaruar se është pronar i një apartamenti banimi me sipërfaqje 55.6 m2, adresa Rr. Labinoti, Pallati *, Shkalla *, Apartamenti * (sot Rruga: Bulevardi Bajram Curri, Pallati *, Shkalla *, Apartamenti *)Tiranë, blerë në vitin 2003. Burimi i krijimit: kursimet familjare ndër vite, vlera 1 900 000 (një milion e nëntëqind mijë)lek.

➤ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Çertifikatë për vërtetim pronësie Zona kadastrale *****, Tiranë, datë lëshimi i çertifikatës 24.09.2003 “Kontratë Shitje” Nr. Rep. ***; Nr.Kol.***, datë 19.09.2003 (noteriale me palët shitese dy bashkëshortë) me vlerë 1.900.000 (një milion e nëntëqindë mijë)lek, likuiduar jashtë zyrës plotësisht. Kontrata e shitjes shoqërohet me Çertifikatën e pronësisë së shitësve bashkelidhur kartelën dhe planimetrinë përkatëse.

Datë 3.10.2003, subjekti ka rregjistruar pasurinë në ZRPP.

❖ HETIMI NGA TRUPA E VLERËSIMIT TË KOMISIONIT:

Trupa kërkoi informacion ASHK, Regjistrin Noterial, OSHEE, Ujësjetllës Kanalizime, ILDKPKI si dhe ju drejtua vet subjektit.

Nga përgjigjet e administruara dhe të analizua nga trupa e KJV rezultoi se :

- Nga përgjigjia e ASHK rezulton se përputhet prona e deklaruar sipas të dhënave të rregjistruara në këtë Agjensi;
- Nga Regjistri Noterial konfirmohet kontrata e shitblerjes midis subjektit në cilësinë e blerësit dhe të palës shitëse;
- Nga përgjigjia e OSHEE , vërtetohet se subjekti ka lidhur kontratën e energjisë elektrike në emër të tij dhe sipas referencave dhe adrestarit të kësaj kontrate, përputhet kjo pronë me deklarimin;
- Nga përgjigjia e Ujësjiellës Kanalizime, vërtetohet se subjekti ka lidhur kontratën e ujit në emër të tij dhe sipas referencave dhe adrestarit të kësaj kontrate, përputhet kjo pronë me deklarimin;
- Deklarimi në ILDKPKI: për këtë pasuri të paluajtshme është deklaruar e njëjta pasuri në vitin 2004 (ku rezulton edhe deklarata e parë e subjektit më zbatim të Ligjit 9049/2003 , pas largimit nga detyra në datë 28.8.2003 (sipas ligjit të ILDKPKI ka deklaruar për gjithë vitin 2003).
- Nga Zyrat e Kadastrës rajonale, janë administruar përgjigjet zyrtare negative që vërtetojnë faktin se subjekti nuk ka pasuri të tjera të paluajtshme të rregjistruara në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Edhe nga OSHEE² dhe Ujësjiellës Kanalizime³, dhe kompanitë private të komunikimit tokësor dhe elektronik (telefoni fikse dhe internet abonim) në rastin konkret, (Albtelekom, Abcom, Digicom, etj) rezulton se nuk ka ndonjë kontratë abonimi tjetër përveç asaj që ka deklaruar dhe që pas vërtetimeve përkon me asetin deklarues (apartamentin e banimit).

❖ **Për sa më sipër, KJV konstaton se subjekti ka bërë deklaram të saktë të pasurisë në deklaratën vetting 2018 dhe ato në ILDKPKI, që në deklaratën e parë në vitin 2004 për vitin 2003, ashtu edhe në ato periode në vijim kur ka qenë subjekt deklarimi, për ekzistencën e këtij aseti të paluajtshëm.**

Lidhur me burimin e të ardhurave dhe kursimeve për blerjen e shtëpisë, konstatohet se në deklaratën vjetore të pasurisë së vitit 2004 për vitin 2003, ka deklaruar se shuma prej 1.900.000 (një milion e nëntëqindmijë)lek rrjedh përveç kursimeve familjare, (paga e subjektit dhe e bashkëshortes, pensioni i babait dhe nënës, shperblimi nga statusi i dëshmorit të atdheut (babai), si dhe nga ndihma e vëllezërve në emigrim).

✓ *Në pyetjet drejtuar subjektit datë 24 shtator 2019, është kërkuar nga relatori:*

-Shpjegoni për cilat pjesë të shumës është dhënë ndihmë nga vëllezërit dhe me çfarë aktesh e provoni burimin e tyre?

Subjekti është përgjigjur: *“vëllezërit kanë qënë në emigracion në Belgjikë nga prilli 1999 e në vazhdim dhe i kanë dhënë një shumë prej 2 milion lekësh të vjetra, të cilët i kanë dhënë në formë dhuratë për shkak së po blinte banesën e tij dhe se prindërit e tyre do të jetonin me të”.*

Subjekti ka deklaruar se nuk disponon dokument pasi këto lek janë dhënë në dorë në formë dhurate “cash”.

² Librezat e energjisë elektrike si abonent , vërtetim OSHEE që nuk rezulton debitor

³ Vërtetim nga UKT që vërteton se subjekti nuk rezulton debitor

VLERËSIMI I KOMISIONIT NË LIDHJE ME HUANË E VËLLEZËRVE:

Komisioni vlerësoi arsyet e lidhjeve familjare dhe marrëdhëniet tradicionale të këtij lloji brenda familjes të lidhura edhe me faktin e kontributit në vijimësi që ka patur subjekti për shkak të mbajtjes së nënës dhe babait në ngarkim të tij (kjo e vërtetuar edhe me certifikatat familjare të subjektit ndër vite), si dhe për faktin e pamundësisë objektive të subjektit për të faktuar me prova dhënien e shumës dhuratë prej vlerës 200.000(dyqind mijë)lek nga vëllezërit (në mirëbesim por edhe informaliteti në emigracion në atë periudhë kohe), faktin se vëllezërit kanë qenë në emigracion në atë kohë, (deklaruar kjo edhe në deklaratën e parë në ILDKPKI) të konsiderojë të mirëqenë shumën e deklaruar si dhuratë nga vëllezërit e tij dhe ta përfshijë atë në të ardhurat e ligjshme që u përlllogaritën nga ky komision për justifikimin tërësor të shumës së akumuluar për blerjen e banesës.

Vlerësimi tërësor i burimit të të ardhurave të subjektit dhe mjaftueshmëria e tyre për justifikimin e blerjes së shtëpisë.

Komisioni përlllogariti të ardhurat e akumuluar që nga fillimi i marrëdhëniet juridike të punësimit/emërimit për herë të parë të subjektit pas vitit 1990 e deri në vitin 2003, në muajin shtator të së cilit kryhet edhe blerja e shtëpisë së banimit.

Lidhur me burimin e të ardhurave dhe kursimeve për blerjen e shtëpisë, *konstatohet se:*

Të ardhurat e tij familjare deri në kohën e krijimit të asetit në vitin 2003, përbëhen kryesisht nga të ardhurat dhe shpërblimet e tij në polici, bashkëshortes për atë vit dhe ndihmës prej 200.000(dyqindë mijë) lek të dhuruar nga vëllezërit.

Pavarësisht deklarimeve të subjektit për të ardhura të tjera të përfituara nga :

- pensionet e babait të tij dhe nënës, si dhe të ardhura nga aktiviteti i tij privat në biznesin e vëllait të tij gjatë periudhës 94-97, (Gomisteri Rrëshen) KJV nuk i përfshiu ato për arsyet sa më poshtë:

1. Lidhur me vlerat e përfitura nga pensionet e nënës dhe babait, KJV mori vërtetimet zyrtare të ISSH për pensionet për çdo vit të nënës dhe babait. Nga këto vërtetime, rezulton se shuma vjetore e pensioneve të përfituara të nënës që ka patur ndër vite në ngarkim subjekti dhe ende sot aktualisht, është në një vlerë anomalisht të ulët monetare (nën minimumin jetik: psh Viti 1998: pensioni mujor i nënës ka vlerën prej 15.015(pesëmbëdhjetë mijë) lek të ardhura në vit ose 1.251 (njëmijë e dyqind e pesëdhjetë e një) lek/muaj të cilat në nivel krahasimor me shpenzimet për frymë nga INSTAT duhet të jenë në vlerën prej 5.000(pesëmijë)lek/frymë. Dukshëm rezulton se të ardhurat nga pensioni i nënës kanë qenë 4 herë më të ulta se mesatarja e shpenzimeve për frymë në vitin respektiv).

2. Po ashtu, edhe në pensionin e përfituar ndër vite nga babai i subjektit deri në vitin 2009 kur ka ndërruar jetë, nga vërtetimet zyrtare rezulton përsëri se e ardhura e përfituar nga babai, është në kufijtë e vlerave të minimumit jetik (p.sh. viti 2000, e ardhura vjetore nga pensioni është në vlerën monetare 59.714(pesëdhjetë e nëntëmijë e shtatëqind e katërmëdhjetë)lek ose 4.978(katërmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë)lek/muaj ndërkohë që shpenzimi mesatar për frymë sipas INSTAT për këtë vit llogaritet në vlerën më të ulët monetare të tyre të cilat ndër vitë rezultojnë që nuk mund të futet si e hyrë në të ardhurat familjare të subjektit, pasi ato janë të pakonsiderueshme dhe nuk mund të përfshihen në të hyrat e përgjithshme me impakt kursimi financiar. Ato (pensionet) janë të ardhura

minimale⁴ (shih vlerat përkatëse të cilat edhe në raport me indikatorët zyrtarë sipas INSTAT për të ardhurat për frymë dhe konsumin jetik për frymë, vlejnjë vetëm për konsum vetiak të individit, pra të konsumit jetik për nënën dhe babain), si të tilla ato nuk mund të përfshihen në përllogaritjet e raportit të ardhura – shpenzime (sipas formulës INSTAT me indikatorët 12⁵ bazikë që llogarit për frymë ky institucion).

3. Edhe sa i takon të ardhurave të pretenduara nga subjekti gjatë vitit 94-97, në aktivitet privat, nuk u provuan me akte ligjore për shkak të natyrës së punës (ndihmë pranë aktivitetit të vëllait Gomisteri) dhe informalitetit por edhe bazuar në vet shpjegimet e subjektit i cili nuk ka dhënë një shifër konkrete se sa kanë qenë të ardhurat e tij nga kjo punë, por dukshëm rezultoi se ato kanë qenë të ardhura të konsumuara vetëm për shpenzimet e tij jetike.

Në referim të INSTAT, u përllogarit, për çdo vit konsumi jetik midis të ardhurave dhe shpenzimeve. Nga shuma e akumuluar në vite për të hyrat monetare, janë zbritur dhe shpenzime sipas formulës (bashkëlidhur tabela financiare).

Trupa kreu analizën financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit dhe familjes së tij nga viti 1997 deri në vitin 2003 nga ku rezultoi se:

Shpenzimet per fryme sipas INSTAT	Per fryme	Konsumi per familje	Te ardhurat nga Pagat sipas viteve e Policine e Shtetit sipas viteve Gj.Loka	Te ardhura paga neto J.Loka	Te ardhura nga familjaret	Shperblime Gj. Loka	Shpenzime sipas deklarimeve DT Veting ne vite	Total te ardhurat	Diference te ardhura minus shpenzime	vitet	Progressive diference per cdo vit deri ne fund 2018
viti	1990	2,600	3,250					3,250	650	1990	650
viti	1991	11,990	14,988					14,988	2,998	1991	3,648
viti	1992	37,597	46,996					46,996	9,399	1992	13,047
viti	1993	55,534	69,417					69,417	13,883	1993	26,930
viti	1994	46,464	58,080					58,080	11,616	1994	38,546
viti	1995	-	-				-		-	1995	38,546
viti	1996	-	-				-		-	1996	38,546
viti	1997	5,000	60,000	96,878		79,912		176,790	116,790	1997	155,336
viti	1998	5,000	60,000	187,703				187,703	127,703	1998	283,039
viti	1999	5,000	60,000	109,183		97,972		207,155	147,155	1999	430,194
viti	2000	108,000	108,000	100,174				100,174	-7,826	2000	422,368
viti	2001	108,000	108,000	412,094		60,666		472,760	364,760	2001	787,128

⁴ Ligj nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, *Neni 8/1*” *Të ardhura të përjashtuara*” : *Përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale:*

1. *Të ardhurat e përfituara si rezultat i sigurimit në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe ndihmat ekonomike për individët pa të ardhura ose me të ardhura të ulta, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës ne fuqi.*

⁵ Të ardhura nën minimumin jetik nuk përfshihen në llogaritjet e 12 kuintilave të konsumit frymor (ku në to janë përfshirë shpenzime për duhan, pije alkoolike, karburant, udhëtime, restorante, shkollim, argëtim, etj që një pensionist as nuk llogaritet se mund t’i kryejë këto shpenzime si një person i punësuar aktiv. Duke qënë se nuk mund të llogariten as sa janë shpenzimet dhe prezumohen se ato konsumohen individualisht dhe nuk futen në të ardhurat familjare.

viti	2002	93,864	140,796	488,437	58,740		356,790	903,967	763,171	2002	1,550,299
viti	2003	93,864	187,728	414,222	160,857	200,000	4,700	1,900,000	779,779	2003	242,350
TOTAL shpenzime konsumi familje 1990-2003			878,709	2,001,422	219,597	200,000	600,040	1,900,000	3,021,059		242,350

Subjekti në deklaratën e pasurisë ka deklaruar se përtej të ardhurave kryesore të pagës , gjatë viteve në policinë e shtetit ka përfituar edhe të ardhura të tjera në formën e shpërblimeve dhe taksë solidariteti, në qarqe të ndryshme të vendit ku ka qenë punonjës i Policisë së Shtetit, por që vet subjekti nuk kishte mundur të përcillte vlerat zyrtarisht të tyre, me pretendimin se në drejtoritë vendore në Durrës, Lezhë, Vlorë, Kukës nuk gjenden borderotë.

Duke qënë se pretendohet se janë përfituar nga subjekti shuma të konsiderueshme vlerash monetare dhe që mund të ndikojnë në shtimin e të ardhurave të ligjshme të subjektit, trupa insistoi në hetimin e saj duke iu drejtuar edhe njëherë zyrtarisht Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorive Vendore në Durrës, Lezhë, Vlorë, Kukës, për të kërkuar vërtetime të të hyrave në formën e shpërblimeve apo taksave të solidaritetit të cilat sipas edhe deklarimeve të subjektit, figurojnë të pamundura për t'u paraqitur si vërtetime zyrtare dhe për më tepër në kushtet kur as nga subjekti nuk deklarohet një shumë e përafërt e përfitimeve të kësaj natyre.

Nga përgjigjet e institucioneve të drejtuara zyrtarisht (u dha informacion përkatësisht nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, Lezhë, Vlorë ku për subjektin Gjovalin Loka gjatë periudhës (1997/1999/2000/2002/2003) rezulton një shumë të ardhurash të ligjshme të përfituara në formën e shpërblimeve, taksës së solidaritetit plus pagave të subjektit në vlerën financiare në total një shumë shpërblimesh prej 600.040(gjashtëqind mijë e dyzetë) lek.

Për sa më lart, trupa të gjitha trajtimet dhe përfitimet extra pagës të përfituara si të ardhura nga subjekti në formën e shpërblimeve apo taksës së solidaritetit i përfshiu në përlllogaritje të të hyrave në formën e të ardhurave nga paga dhe shpërblimeve, si burime të ligjshme të ardhurash që janë përfituar nga subjekti në periudhat respektive të punësimit të tij në rradhët e Policisë së Shtetit, me qëllim vlerësimin e duhur në burimet e sakta të të ardhurave dhe të kursimeve të mjaftueshme për të blerë apartamentin në shumën monetare prej 1.900.000(një milion e nëntëqind mijë) lek.

Në përfundim të këtij analizimi, rezulton se subjekti ka patur të ardhura të ligjshme që kanë justifikuar në raport me shpenzimet për të blerë shtëpinë, në kushtet kur kjo shtëpi është blerë vetëm nga të hyrat paga dhe shpërblime si dhe ndihmë nga familjarët dhe nga asnjë përfitim tjetër të natyrës (trashëgimi, kredi, huamarje etj).

Pasuria Nr.2: Subjekti ka deklaruar se është pronar i një sipërfaqje banimi në fshatin Sang të Mirditës me sipërfaqje 120 m2, (trashëgimi familjare), me vlerë 3.000.000(tre milion) lek.
-Pronar me 1/10 i një sipërfaqjeje toke prej 1000 m2 në Sang të Mirditës, trashëgimi familjare.

Subjekti ka bashkëlidhur si dokument shoqërues aktin e marrjes së tokës në përdorim sipas ligjit 7501, me Nr.21 akt regjistrimi në emër të babait Z.Bardhok Loka, 1000 m2 tokë nga të cilat 100 m2 tokë arë dhe 100 m2 tokë truall.

Vlera :150.000(njëqind e pesëdhjetë mijë)lek.

❖ HETIMI NGA TRUPA E VLERËSIMIT TË KJV :

- Nga ASHK Mirditë dhe Malësi e Madhe nuk rezultoi se ka pasuri të rregjistruar si për tokën truall ashtu edhe për atë arë;
- Nga deklarimi në ILDKPKI, rezulton se Pasuritë e mësipërme janë deklaruar edhe në deklaratat periodike vjetore për vitin 2003, 2004 si dhe në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2013 por me disa mospërputhje të vogla në metra katror nga njëri deklarim në tjetrin për të cilin subjektit iu drejtuan pyetje për shpjegim.
- Subjekti u pyet edhe për vlerat e deklaruara për secilën pasuri se çfarë tregojnë këto vlera, nga janë përlllogaritur ato, a është bërë ndertim, investime dhe se a është prona trashëgimi familjare e rregjistruar në Zyrën Vendore të Rregjistrimit të Pasurisë.

Në përgjigje të pyetjeve të relatores, Subjekti ka bashkëlidhur:

1. Vërtetimin e Njesisë Administrative Fanë, Bashkia Mirditë Nr.*** datë 26.09.2019 e cila vërteton se: *familja e B. Loka, trashëgimtarët e tij (bashkëshortja dhe fëmijët e tij) kanë një banesë dhe tokë bujqësore (900 M) në fshatin Sang, Njësia Administrative Fan, Bashkia Mirditë. Në këtë ndërtesë banojnë dy familje, trashëgimtarët e B. Lokës dhe trashëgimtarët e Gj. Lokës të cilët kanë paguar rregullisht energjinë elektrike në emër të B. Loka.*
2. Vërtetimin e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, Zyra Vendore Mirditë e datës 26.09.2019, ku thuhet se: *Z.B. Loka, njëherazi babai i Z.Gjovalin Loka, janë përfitues të tokës bujqësore sipas Ligjit 7501 të sipërfaqes 900 metër katrorë në total në AMTP, ka të drejtë të marrë dhe 100 metra katrorë të tjera, kjo familje nuk ka tërhequr çertifikatë pronësie dhe nuk e ka depozituar çertifikatën e datës 01/08/1991, dokument të cilën e ka paraqitur sot përmes të cilit është përpiluar ky vërtetim.*

-Më tej subjekti ka shpjeguar se:

-Vlera e llogaritur e saj është bërë më hamendje duke mbajtur në konsideratë distancën nga qendra e rrethit Qyteti i Rrëshenit, mungesa e një rruge të mirë të asfaltuar deri kur u bë "Rruga e Kombit" në kohën kur është bërë deklarimi i parë, si dhe duke u orientuar nga tarifat që i përkasin rrethit të Mirditës.

-Prona është trashëgimi familjar ku toka është e regjistruar në emër të B. Loka (vdekur) aktualisht vazhdon të figurojë në emër të tij dhe nuk kemi kryer veprime për ndarjen mes 10 fëmijëve që jemi ne.

-Ndërsa shtëpia në fshatin Sang me sipërfaqe të deklaruar prej 120 m², është e ngritur mbi sipërfaqe trualli në emër D. Loka, trashëgimtar i xhaxhait tim, të ndjerit Gj.Loka, nga ku nuk është e ndarë me dokumente pjesa takuese e bababit tim të ndjerë, B. Loka.

-Sa i përket investimeve janë bërë disa ndërhyrje të vogla meremetime duke bërë riparim suvaje, ndërruar çatin (llamarinë e kuqe) dhe sistemuar oborrin pasi traseja (skarpati) e Rrugës së Kombit, na ka zënë një pjesë të mirë të oborrit.

-Këto shpenzime janë mbuluar me kontributin e të gjithë fëmijëve motra dhe vëllezër (gjithsej 10), tre nga të cilët punojnë e jetojnë jashtë në Itali, SHBA dhe Kanada. Për sa më sipër, subjekti ka paraqitur edhe foto ilustruese të shtëpisë e cila banohet nga dy trungje familjesh.

J) KONKLUZION :

Në përfundim, pas sqarimeve të subjektit dhe provave të vënë në dispozicion, trupa vlerësoi se deklaratimet e subjektit përputhen me dokumentet zyrtare dhe se u pranua shpjegimi dhe provat e dhëna në tërësi nga subjekti për pronën trashëgimi.

2. PASURITË E LUAJTSHME :

- J) Ka rezultuar se subjekti ka qenë Pronar i një automjeti tip “Benz 190”, blerë në vitin 2006 me kursimet familjare, vlera 250.000(dyqind e pesëdhjetë mijë) lek (hequr nga qarkullimi më dt.19.12.2013)
- J) Pronar i një motori “Java”, vlera 15.000(pesëmbëdhjetë mijë)lek, blerë nga kursimet familjare (hequr përgjithmonë nga qarkullimi).

➤ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

Dy vërtetime të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor përkatësisht me lëndë:

1. “Për heqjen e përhershme të mjetit nga qarkullimi”, datë 19.12.2013 për automjetin Mercedes Benz TR ***H për të cilin ka dorëzuar lejen e qarkullimit, targat e automjetit si dhe çertifikatën e pronësisë.
2. “Për heqjen e përhershme të mjetit nga qarkullimi”, datë 19.12.2013 për llojin e mjetit “Motor” me targë TR *** D, për të cilin ka dorëzuar targat e motorrit, lejen e qarkullimit si dhe çertifikatën e pronësisë.

❖ HETIMI NGA TRUPA E KOMISIONIT :

- Nga verifikimet e trupës në DPSHTRR, rezulton e vërtetuar blerja e motorrit tip “Java” sipas kontratës noteriale të shitblerjes në 12.2.2007 në vlerën 15.000(pesëmbëdhjetë mijë) lek me blerës Gjovalin Loka.
- Nga verifikimet e trupës në DPSHTRR, rezulton e vërtetuar blerja e automjetit tip Mercedes Benz me targë TR *** H, blerë më datë 21.10.2006, në vlerën 250.000(dyqind e pesëdhjetë mijë)lek.

Trupa konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e DPSHTRR.

Dy blerjet dhe përdorimi i këtyre aseteve të luajtshme motorrike (automjet dhe motor) janë kryer gjatë periudhës 2006-2013 kohë kur subjekti nuk punonte në Policinë e Shtetit.

Sa i përket burimit të të ardhurave për blerjen e automjetit në vlerën 250.000(dyqind e pesëdhjetë mijë)lek edhe sipas shpjegimit të subjektit, ka qenë përsëri vëllai i tij që e ka ndihmuar për të blerë automjetin që do të vlente si mjet për Biznesin “Loka” sh.p.k. për hapjen e aktivitetit “Autoshkollë”, kurse të specializuara. Të ardhurat për këtë biznes janë të panjohura nga Komisioni pasi ato nuk

konfirmohen nga institucionet tatimore përveç të dhënës se bazuar në QKB dhe organin tatimor, rezulton se subjekti ka qenë administrator me emrin tregtar “Loka” sh.p.k., regjistruar Shoqërinë dt.07.09.2006, me (NUIS) K *** E me objekt veprimtarie “Autoshkollë , import-eksport, tregëtim të mallrave të ndryshëm industrialë, ushqimorë” por sipas tatimeve⁶ nuk disponohen të dhëna të tjera përveç faktit se subjekti nuk është subjekt as i deklarimit të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave dhe se rezulton i regjistruar në 15 shtator 2009. Duke qenë se Komisioni nuk disponoi asnjë të dhënë tjetër zyrtare, ju drejtua subjektit i cili dha shpjegime lidhur me aktivitetin e tij si administrator, pavarësisht se ka patur një objekt të gjerë veprimtarië kjo shoqëri ka realizuar objektin tregëtar vetëm atë të “Përgatitjes teorike dhe praktike të kursantëve për drejtues automjetesh për klasat “A”, “B”, “C”, “D” dhe “E” (Autoshkollë), ku vetë ka qenë administrator dhe instruktor praktike, ndërsa vëllai i tij i quajtur N. Loka, ka qenë instruktor teorie.

Subjekti sqaron se: *Pranë Autoshkollës “LOKA” janë regjistruar dhe kanë marrë lejen e drejtimit 81 kursantë, kostoja për një kursant në atë periudhë ka qënë 30.000(tridhjetë mijë) deri në 35.000 (tridhjetë e pesë mijë)lek. Dhe nga ky aktivitet, pasi ka shlyer detyrimet duke paguar sigurimet shoqërore, shëndetësore, taksat vjetore dhe shpenzime të tjera për zhvillimin e këtij aktiviteti i kanë ngelur rreth 1.200.000(një milion e dyqind mijë) lek (shuma e pagave në vite për vete), për gjithë periudhën që kjo kompani ka patur aktivitet.*

Me datë 15.09.2009 subjekti informon se ka mbyllur shoqërinë “LOKA” sh.p.k., duke shlyer të gjitha detyrimet që ka patur ndaj shtetit, duke bërë dhe ç’regjistrimin e saj në QKL⁷.

Duke qenë se Komisioni nuk mundi t’i konfirmojë këto të dhëna në rrugë zyrtare ashtu sikundër edhe vet subjekti nuk dispononte dokumentacion në lidhje me aktivitetin e shoqërisë “LOKA” sh.p.k., edhe pasi është interesuar personalisht në D.R.T.RR. Dega Tiranë, ku ka kërkuar dosjen e kësaj shoqërie por i është thënë se nuk gjendet dhe pas kërkesës së dt 19.11.2019, drejtuar për vënie në dispozicion të dhëna Drejtorise Rajonale të Tatimeve, Dega Tiranë⁸.

Komisioni nuk i ka përfshirë në të hyrat e të ardhurave të subjektit për periudhën shtator 2006- shtator 2009 (datë kur është ç’regjistruar si biznes) pasi nuk ka konfirmime zyrtare nga institucionet përkatëse.

Trupa konstaton gjithashtu se që nga viti dhjetor 2013 e aktualisht subjekti nuk disponon mjet motorrik të asnjë lloji që nga marrja e detyrës në vitin 2013, kur është riparuar në Policinë e Shtetit dhe për të cilën subjekti ka kryer procedurat përkatëse me heqjen nga qarkullimi, në mënyrë të përhershme dy mjetet e tij motorrike të disponuara më herët prej tij.

Drejtoria e Përgjithshme Detare, me përgjigjen e administruar Nr. *** Prot., datë 09.07.2019 hyrje në KJV, nuk konfirmon asnjë mjet lundrues në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur me të.

⁶ Shkresë nr.*** prot administruar në KJV dt.12.7.2019

⁷ Ekstrakti i Shoqërisë Loka sh.p.k. si dhe historiku i saj, verifikuar edhe nga KJV në institucionet përkatëse (QKB dhe Tatime)

⁸ Regjistruar në Protokoll Nr. *** datë 19.11.2019, për Shoqërinë "LOKA" sh.p.k., pa përgjigje

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE në vijimësi :

-) Subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor (po ashtu deklaruar edhe në deklaratën vjetore periodike në ILDKPKI të vitit 2015 për vitin 2014) shtuar në llogarinë e pagës në Raiffeisen Bank shuma prej 1.111.668 (një milion e njëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë shtatë)lek.
-) *Burimi i krijimit* : zbatimi i Vendimit Nr.245, dt.19.2.2014 të Gjykatës Apelit Administrativ për largimin në mënyrë të paligjshme nga rradhët e Policisë së Shtetit, ku është njohur vlera e dëmshpërblimit, paga e një viti pune në gradën “Komisar” si dhe pagat që nga Gusht 2003 deri në Janar 2004 kur u ekzekutua urdhëri i përjashtimit nga policia.
-) Të ardhura të përfituara nga ndihma financiare nga e motra V.S. e cila në vitet 2008-2010-2012, dhënë shumat për kontribut familjar për shkak se subjekti mban nënën dhe konkretisht shumat:
- 400.000(katërqind mijë)lek, 100 000 (njëqind mijë)lek, 266.000(dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë)lek si dhe 20.000(njëzetë mijë)lek.
-) Të ardhura (neto) të përfituara nga aktivitet privat bazuar në vërtetimet e punësimit respektivisht në vitet:
- “TRIMED” sh.p.k. për periudhën Dhjetor 2010-Gusht 2011; 216.000 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lek;
 - “MATEIMPEX Pharma Commerce”, për periudhën Maj 2010-Nëntor 2010; 156.720 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzetë) lek;
 - “PREMIUM SECURITY” për periudhën Maj 2013-Tetor 2013; 150.597(njëqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lek;
 - “DENIZ PATLIXHAN” (njesoj si lart capital) shpk për periudhën Dhjetor 2011-Dhjetor 2012; 502.698 (pesëqind e dy mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë) + 69.100(gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind) lek.

❖ HETIMI NGA TRUPA E KJV :

➤ Për ndihma financiare:

Edhe pse në periudhë jetese jashtë rradhëve të Policisë së Shtetit, Trupa verifikoi për derdhjet e shumave në Bankën Raiffeizen nga ku rezultoi se: Motra e subjektit e V. S. më datë 19.11.2012 ka derdhur shumën 400 000(katërqind mijë) lek;

-) Në ProCredit Bank motra e subjektit V. S. ka depozituar më datë 12.07.2008 shumën 100 000 (njëqind mijë) lek. Më datë 07/04/2010 ka depozituar shumën 266.000(dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë) lek. Më datë 03/05/2010 ka depozituar shumën 2.000(dymijë) lek.

depozitë V. S. Laç	2008	100,000	lek
depozitë V. S. Laç	2009	266,000	lek
depozitë V. S. Laç	2010	22,000	lek
Të ardhura nga V.S. /Pro Credit bank		388,000	lek
Ndihmë financiare Raiff bank /V. S.	2012	400,000	lek

J) KJV pasi bëri verifikimet konstatoi se deklaratimet e subjektit për ndihmën e dhënë nga motra e tij ishin të sakta, vijoi me hetimin e subjektit duke i kërkuar të provonte nëse motra kishte të ardhura të mjaftueshme për të dërguar vëllait të tij si ndihmë dhe kontribut për mirëmbajtjen e nënës së tyre.

Në përgjigjet e subjektit rezultoi se, motra dhe bashkëshorti i motrës kishin të ardhurat e tyre , *me burim të ardhurash:*

- Pagat e motrës punonjëse disa vite në sistemin bankar në qytetin e Laçit si dhe një periudhë kohe nga 01.04.2006 deri me 09.01.2013 , Supervizore e Shërbimit me Klientin në Qendrën e Shërbimit Laç në Bankën “Prokredit Bank”, ku paga e marrë për keto vite pune ka qënë 4.145.013(katër milion e njëqind e dyzetë e pesë mijë e trembëdhjetë) lek, përveç pagës ajo ka marrë dhe bonuse të ndryshme që iu ka dhënë banka për punë të mirë të bërë nga filiali ku ajo ka punuar për këtë periudhë në vlerën 127.868 (njëqind e njëzetë e shtatë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lek.
- Të ardhurat e bashkëshortit të saj si pension i parakohshëm ku nga data 16.09.2006 deri me 01.09.2009 ka përfituar 40.000(dyzetë mijë) lek të reja/muaj (pension i privilegjuar me statusin “Ushtarak”) dhe nga data 01.09.2009 e në vazhdim deri në dhjetor 2012=16.400 (gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind)lek në muaj.

Nga këto burime, të cilat u vërtetuan me prova të paraqitura nga subjekti i cili vuri në dispozicion të KJV pagat e motrës⁹ dhe të bashkëshortit¹⁰, rezultoi se motra kishte mundësi të ndihmonte me këto kontribute herë pas herë në vitet kur subjekti ishte i papunë apo me të ardhura të pakta nga aktiviteti privat, në favor të familjes së vëllait si shpërblim për mbajtjen e nënës së tij.

➤ **Hetimi për periudhat e punësimit privat :**

-KJV verifikoi nga institucionet tatimore të ardhurat nga punësimi privat i subjektit për kohën kur ishte jashtë rradhëve të policisë dhe konstatoi se deklaratimet e tij ishin të sakta për vlerat dhe periudhat përkatëse.

➤ **Hetimi për të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor:**

KJV verifikoi statement bankar, në Bankën Raiffeizen ku rezultoi hyrje më datë 23.12.2014 shuma 1.116.687(njëmilion e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë)lek e dëmshpërblimit financiar nga vendimi gjyqësor¹¹, çka provon deklaratimin e saktë të subjektit lidhur me burimin e kësaj të hyre në llogarinë e subjektit në vitin 2014 kur është bërë edhe ekzekutimi i zbatimit të vendimit të gjykatës për dëmshpërblim për urdhër të paligjshëm për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së subjektit pa shkaqe të justifikuara.

⁹ Vërtetim “ ProCredit Bank”, dt.26.9.2019 për motrën e subjektit shtetasen V.Suli me liste pagesat si punonjëse e Bankës

¹⁰ Vërtetim pagash dhe pensioni status ushtarak Gj.M.Suli nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë, Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

¹¹ Vendimi i Gjykatës Apelit Administrativ i formes se prere Nr. 245 datë 19.02.2014 e cila vendos “Detyrimin e palës së paditur Ministria e Brendshme t’i paguajë paditësit Gjovalin Loka, pagën bazë, shtesat mbi pagë sipas pagës për gradën komisar për periudhën 27.08.2003 deri në datën 14.01.2004. Detyrimin e palës së paditur Ministria e Brendshme ti paguajë paditësit Gjovalin Loka pagën bazë, shtesat mbi pagë sipas pagës për gradën “Komisar” për periudhën një vit si dëmshpërblim për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës pa shkaqe të justifikuara.

VEPRIME TË TJERA FINANCIARE:

1.Rezulton se subjekti ka përfituar gjatë periudhës Qershor 2011-Mars 2012, shuma të ndryshme në valutë kryesisht dollarë dhe euro, përmes Western Union, dërgesa nga një kompani turke në Izmir të Turqisë (Silo Tarim su Urunleri San) dërguar për çeljen e aktivitetit për gjuetinë dhe eksportin e “Kastravecit të detit” me të cilin Shoqëria “Deniz Patlixhan” sh.p.k. e përfaqësuar nga subjekti kishte lidhur një kontratë shitblerje “Kastravec deti” me Kompaninë Turke dt.14.9.2011.

❖ HETIMI NGA TRUPA E KOMISIONIT :

Subjekti ka deklaruar në Deklaratën Veting si dhe ka bashkëlidhur ekstraktin e shoqërisë si dhe kontratën. Po ashtu ka deklaruar në deklaratën vetting shumat e dërguara për çeljen dhe fillimin e aktivitetit në Shqipëri për periudhën nga datat 17.6.2011-19.3.2012. Këto shuma janë në vlera euro dhe dollarë.

Nr.	Data e dërgimit	Vendi nga janë transferuar paratë	Dërguesi	Marrësi	Valuta e dërguar USD	Kursi këmbimit	Tërhequr shuma në US Dollar	Shuma e marrë Euro
1	17/06/2011	Turkey/usd/izmirrl	*****	Gj.Loka	7.500	10000000	7.500	
2	26/08/2011	Turkey/usd/izmirrl	*****	Gj.Loka	1.200	6928566		831.43
3	21/09/2011	Turkey/usd/izmirrl	*****	Gj.Loka	1.850	10000000	1.850	
4	11/10/2011	Turkey/usd/izmirrl	*****	Gj.Loka	800	10000000	800	
5	22/10/2011	Turkey/usd/izmirrl	*****	Gj.Loka	1.850	10000000	1.850	
6	16/11/2011	Turkey/usd/izmirrl	*****	Gj.Loka	2.000	10000000	2.000	
7	09/01/2012	Turkey/usd/izmirrl	*****	Gj.Loka	2.000	10000000	2.000	
8	26/01/2012	Turkey/usd/izmirrl	*****	Gj.Loka	5.500	10000000	5.500	
9	19/03/2012	Turkey/usd/izmirrl	*****	Gj.Loka	2.000	10000000	2.000	
SHUMAT E MARRE NE US DOLLAR DHE EURO							23.500	831.43

Nga dokumentacioni shoqëruar që ka dërguar subjekti që në depozitimin e deklaratave të pasurisë sipas detyrimeve të Ligjit të Vlerësimit nr.12/2018(i ndryshuar), janë paraqitur kopje të faturave nga ku rezultojnë dërgesat në Western Union për çdo datë dhe shume, individët dërgues nga shteti Turk, punonjës të kompanisë turke, ndaj dhe për këtë KJV i konsideron si prova të vërtetueshme.

Nga subjekti nuk janë pretenduar se këto shuma janë burim i ndonjë shtimi personal të pasurisë së tij të luftshme ose të palujtshme pas kohës së transferimit të tyre ashtu sikundër edhe nga të hyrat bankare ose verifikimi pasuror në vijim, nuk rezulton se ka ndonjë aset apo depozitë/cash/likuditet bankar. Në shpjegimet që ka dhënë subjekti, këto shuma kanë shërbyer një pjesë për investimet fillestare për çeljen e aktivitetit, marrjen me qera të disa anijeve dhe ambienteve si dhe pagat e administratorit. Të gjitha likuditetet në vlera eurosh dhe dollarë të dërguara në Shqipëri u shpenzuan me mbylljen e aktivitetit nga kompania në Turqi si dhe disa materiale të blera për llogari të aktivitetit që do të zhvillohej në Shqipëri.

Pavarësisht dokumentacionit të përcjellë si gjatë dorëzimit të deklaratës së pasurisë vetting 2018, por edhe dokumenteve të tjera shtesë të dërguara nga subjekti gjatë fazës së hetimit administrativ, Komisioni administroi dokumentacionin e plotë si nga Organet Tatimore dhe QKB ku vërtetohet çelja dhe rregjistrimi në QKB si biznes, po ashtu edhe ekstraktin historik të tatimpaguesit si administrator i licencuar në biznesin privat Kompania “Deniz Patlixhan” sh.p.k. si dhe akte/prova të tjera dokumentare si (kontratat për qeratë e ambientit në Tiranë për ushtrimin e aktivitetit, qiratë e anijeve të peshkimit etj).

Siç dhe deklarohet nga vet subjekti por edhe në dokumentet e tjera të kërkuara nga vet Komisioni , licenca për peshkim është revokuar e plotë nga Ministria e Mjedisit më dt.9.4.2012 si pasojë se njëra nga speciet e përshkruara në leje për gjueti (konkretisht “holothurja tubolosa”) ndodhet në listën e Kuqe të Florës dhe Faunës sipas Urdhrit Nr.146, dt.8.5.2007 të Ministrisë së Mjedisit.

Komisioni administroi të gjithë praktikën administrative lidhur me lejen e lëshuar dhe më tej të revokuar nga autoritetet administrative si dhe praktikën gjyqësore, pasi rezulton se subjekti ka ankimuar aktin administrativ të revokimit të lejes për ushtrimin e aktivitetit.

Nga hetimi i Komisionit rezultoi se më dt 25.6.2012, subjekti në atë kohë në pozicionin e administratorit të kompanisë “Deniz Patlixhan”sh.p.k., ka kërkuar pranë QKB më lëndë: Kërkesë për kalimin me status i “Pezulluar” (pushim i përkohshëm) i shoqërisë për shkak të revokimit të licencës, (revokimi i licensës dt.9.04.2012¹² nga Ministria e Mjedisit: *Revokuar plotësisht leja e dhënë pasi ka rezultuar se speciet e përshkruara në leje ndodhet në listën e kuqe të Florës dhe Faunës sipas Urdhrit Nr.146, d.8.5.2007 të Ministrisë së Mjedisit*).

Që prej datës 19.12.2014 kjo shoqëri rezulton me status tatimpaguesi “PASIV” dhe se nuk ka detyrime tatimore të paguara.

Në korrespondencën me organet tatimore pranë Komisionit ka ardhur informacion i detajuar për kompaninë “Deniz Patlixhan”sh.p.k. (konkretisht dt.21.8.2019, 9.09.2019 dhe 12.7.2019) nga ku rezulton se:

Shoqëria ka Administrator dhe Ortak të vetëm të saj Gjovalin Loka.

Ky subjekt është regjistruar në organin tatimor për ushtrimin e aktivitetit më 23.06.2011, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me (NUIS) L11823007C me Seli në Tiranë, me aktivitet kryesor: “Tregtia me pakicë e pëshkut, gaforreve dhe molusqeve në dyqanë të specializuara”, me objekt aktiviteti: “Gjuetia në dete, grumbullimi, përpunimi dhe eksporti i kastravecit të detit (Sea cucumber, Holothoria mamata)”.

Është pajisur me leje pranë QKL dt.13.01.2012 për peshkimin e kategorive të Kastravecit të Detit të klasës “Holothoridae”.

Aktualisht me status tatimpaguesi: “PASIV”, nga data 19.12.2014.

Nga verifikimet e kryera të historikut të statusit për subjektin “Deniz –Patlixhan” sh.p.k., rezulton se në QKB ka kryer edhe:

- Aplikim për pushim i përkohshëm i aktivitetit: “Pezulluar” më datë 31.05.2012
- Aplikim mbi aktivizimin e aktivitetit: “Aktiv” nga data 14.06.2012
- Aplikim për pushim i përkohshëm i aktivitetit: “Pezulluar” nga data 25.06.2012.

¹² Akt nr.*** prot, dt.9.4.2012 për revokimin e lejes së peshkimit PN 2793-01-2012 miratuar nga Ministria e Mjedisit dt.13.1.2012.

Nga verifikimet e kryera, për ushtrimin e aktivitetit të subjektit “Deniz - Patlixhan” sh.p.k., tatimpaguesi nuk është i regjistruar për përgjegjësinë tatimore: Tatimi në burim, as për adresën kryesore (Tiranë) dhe as për adresën dytësore për periudhën e deklaruar (Vlorë).

Nga verifikimet e kryera për të gjithë periudhën kronologjike që nga regjistrimi deri aktualisht, deklaramet në librat e shitjes dhe blerjes rezultojnë:

- Viti 2012 - (pas datës 26.06.2012 që ka deklaruar pezullimin e aktivitetit) Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor - deklarohen me zero. Viti 2013 - gjithë muajt e vitit deklarohen gjendjen financiare “zero”;
- Viti 2014 - gjithë muajt e vitit deklarohen gjendjen financiare “zero”.

Pavarësisht elementëve të sjelljes së subjektit në atë kohë jashtë rradhëve të policisë por si i punësuar privat në funksion të zbatimit të legjislacionit tatimor, *ajo që Komisioni konstaton është se:*

Subjekti nuk e ka ç’regjistruar shoqërinë në QKB.

Subjekti ka nisur një proces gjyqësor më dt. 22.5.2012¹³ periudhë në të cilën nuk ka qenë në Policinë e Shtetit, me objekt “Anullimin pjesërisht të aktit administrativ të Ministrisë së Mjedisit për revokimin e lejes së peshkimit dhe lejimin e aktivitetit normal të saj për dy speciet e tjera që nuk bëjnë pjesë në ndalimin e peshkimit, si dhe dëmin pasuror dhe jopasuror”.

Në këtë periudhë kohore, nuk ka asnjë situatë konflikti të subjektit sipas përcaktimeve të Ligjit 9367/2003 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, i ndryshuar, pasi subjekti nuk ushtronte funksion publik.

Duke qenë se në 24.7.2014 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë¹⁴ e ka anuluar pjesërisht aktin e administrativ të Ministrisë për revokimin e lejes dhe më tej pas kërkesës ankimore të subjektit në Gjykatën e Apelit Administrativ¹⁵, më dt.20.10.2017¹⁶ ka ndryshuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, ka rrëzuar padinë e shoqërisë “Deniz Patlixhan” sh.p.k., si të pabazuar në ligj, ndërsa vijon rekursi në Gjykatë e Lartë¹⁷ me objekt: “Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe Shkallës së Parë Administrative, anullimin pjesërisht të aktit administrativ mbi Revokimin e Lejes së lëshuar nga Ministria e Mjedisit, detyrimin e palës së paditur për të nxjerrë leje të re peshkimi për Shoqërinë “Deniz Patlixhan” sh.p.k. për zhvillimin normal të aktivitetit të saj dhe detyrimin e palës së paditur për të shpërblyer dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga nxjerrja e aktit administrativ përkatësisht akt revokimi i lejes”.

Subjekti edhe pse këto procese janë vijim i procesit gjyqësor të çelur në vitin 2012 kohë kur nuk ishte në ushtrim të funksionit publik, është subjekti ai që prej vitit 2014 e në vazhdimësi, vijon ankimmimet gjyqësore më shpresën për t’ju rikthyer aktivitetit normal të biznesit të krijuar në vitin 2011, duke vijuar të përfaqësojë biznesin e tij privat si palë ndërgjyqëse dhe siç edhe deklarohen vet, figurojnë ende *de jure* administrator i vetëm i kësaj kompanie.

¹³ Ankesë e Veçantë drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë dt.22.5.2012, administrator Gj.Loka (Denis Patlixhan shpk)

¹⁴ Nr akti ***, Nr. Vendimi 4423 dt.24.7.2014 Gjykatës Adm Shkallës së Parë Tiranë.

¹⁵ Kërkesë ankimore e subjektit Gj.Loka depozituar në Gjykatës së Apelit Administrativ dt.6.8.2014

¹⁶ Vendim Nr. 4317 dt.20.10.2017 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

¹⁷ Rekurs në Gjykatën e Lartë, Nr. Rregjistri në Gjykatë të Lartë: 31003-00135-00-2018, dt. 18.01.2018

Qënia ende administrator i vetëm i një kompanie private e cila edhe pse që prej kohës së fillimit të funksionit të lartë policor e deri më sot, nuk ushtron aktivitet dhe nuk gjeneron asnjë të ardhur, pavarësisht kësaj nuk çbën faktin se subjekti si punonjës policie, ka detyrimin të deklarojë para organizatës së policisë (punëdhënësit), se ka patur angazhime private para fillimit të punës në Policinë e Shtetit dhe se ndodhet në procese gjyqësore civile edhe pse jo që bien ndesh në mënyrë të drejtëpërdrejtë me fushën e përgjegjesisë së tij në funksionin policor.

Lidhur me faktin nëse një aktivitet është ose jo i ligjshëm, përcaktohet nga legjislacioni specifik/ndryshimet e tij më të fundit dhe nga interpretimet fundore që do të jepen me vendimet e gjykatave duke qenë se kjo çështje është në shqyrtim ende gjyqësor. Në mënyrë të pashkëputur nga përcaktimet e nenit 31 të Ligjit 9367/2003 “*një zyrtar i lartë drejtues në rradhët e policisë edhe në të ardhmen nuk mund të ushtrojë aktivitet të dytë dhe të përfitojë të ardhura duke qenë administrator dhe ortak 100% i vetëm i saj*”.

Çka del në konkludimin se si për shkak të statusit aktual që ka kompania si dhe për shkak të mos krijimit të asnjë të ardhure, *nuk duket se jemi në kushtet e konfliktit faktit të interesit.*

Por pavarësisht arsyeve që subjekti ka parashtruar duke mos gjetur asnjë lidhje apo ndikim midis objektit të kësaj veprimtarie me funksionin dhe juridiksionin e Departamentit të Sigurisë Publike, Komisioni është i bindur se ky subjekt nuk mund të ushtrojë në të ardhmen asnjë aktivitet të dytë ndërkohë që mban edhe postin e një funksionari të lartë të Policisë së Shtetit, nëse eventualisht mund të krijojë premisën në të ardhmen të rilicensohet për një ushtrim aktiviteti të caktuar sipas ligjit të peshkimit apo ndonjë fushe tjetër, pasi e pengon ligji specifik, (Ligji për Policinë e Shtetit) në këtë rast norma specifike më e rëndë është ajo e ligjit të posacëm të Policisë së Shtetit 108/2014, nenit 91¹⁸ të saj.

Në këtë kontekst, është ndalesë absolute e çdo punonjësi policie që të ushtrojë një veprimtari të dytë private.

Në referim edhe të vet Ligjit 9367/2003 i cili bazuar në nenin 26 të tij përcakton se :

1. Llojet dhe kufizimet e interesave privatë të kategorive të zyrtarëve, të përcaktuara në këtë seksion, nuk përjashtojnë llojet dhe kufizimet e përcaktuara në ligje të tjera për këto kategori zyrtarësh, të zbatuara për të njëjtin qëllim, por, në çdo rast, zbatohet kufizimi më i rreptë, në përputhje me përcaktimet e nenit 5¹⁹ të këtij ligji.

¹⁸ Kufizimi për veprimtari të dyta : Punonjësi i policisë nuk mund të punësohet ose të kryejë veprimtari tjetër private më përjashtim të mësimdhënies.

¹⁹ Neni 5 “Interesat privatë”

1. Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga:

a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre;b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale; ç) negociime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negociime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse , sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.

2. Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.

3. Nëse në këtë ligj, në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për këtë ligj dhe anasjelltas.

2. Për zyrtarët e tjerë, të patrajtuar në këtë seksion, zbatohen kufizime të përcaktuara në ligje të veçanta për të njëjtin qëllim. Kur me ligj përcaktohet se këta zyrtarë nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari private, kjo kupton edhe ndalimin e zotërimit në mënyrë aktive të aksioneve ose pjesëve në kapital në shoqëritë tregtare në ato kushte për të cilat ndalohet veprimtaria private.

Subjekti ka dhënë shpjegimet e tij gjatë fazës së hetimit, por edhe në seancë duke përcjellë bindjen e tij se në asnjë çast nuk është ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit dhe se ai si administrator nuk bie ndesh me kufizimet që përcakton Ligji 9367/2005 për Konfliktin e Interesit dhe as rastet specifike të kategorisë së pozicioneve të nëpunësve publikë ku përfshihet edhe zyrtari i nivelit të mesëm dhe të lartë drejtues i policisë së shtetit që normohen në nenin 31²⁰ i Ligjit 9367/2005.

Komisioni vëren se vërtetohet ligjërisht se subjekti nuk ka ushtruar aktivitet privat përmes një shoqërie tregtare, pasi rezultoi e pezulluar dhe me status “Pasiv” që prej një periudhe para 8 vitesh, kohë kur nuk ishte në rradhët e policisë, dhe as nuk ka përfutur asnjë të ardhur prej saj që kur ka filluar funksionin publik në Policinë e Shtetit.

Po ashtu rezultoi se subjekti nuk ka asnjë detyrim në kohë reale sipas vërtetimit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë (shkresë dt.5.7.2019) pra as detyrime kryesore, as gjopa të rregjistruara/parregjistruara dhe interesa.

²⁰ Neni 31. "Kufizime për zyrtarin e nivelit të lartë dhe të mesëm, drejtues të administratës publike, institucioneve të tjera publike, Policisë së Shtetit dhe Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë. A) Nuk mund të jenë drejtues në organizata fitimprurëse: Në rastin konkret unë nuk jam në konflikt interesi me këtë pikë të këtij neni, pasi Shoqëria "Deniz-Patlixhan" shpk ku unë figuroj administrator, nuk është organizatë fitimprurëse. b) Nuk mund të jenë anëtarë në organet drejtuese të një shoqërie tregtare ose në një organizatë jofitimprurëse, kur këta ushtrojnë veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, me akte të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këto shoqëri a organizata , apo mbi shoqëri ose organizata të tjera që bashkëpunojnë apo konkurojnë me shoqërinë në fjalë, përjashtuar rastet kur ky pozicion në shoqëri ose organizatë vjen për shkak të funksionit apo statusit. Edhe sipas parashikimeve në pikën "b" këtij neni unë si drejtues i lartë në Policinë e Shtetit, nuk jam në konflikt interesi me parashikimet e kësaj pike të nenit 31, pamvarësisht se figuroj administrator i një shoqërie me status të pezulluar, pasi fusha e veprimtarisë së kësaj është "Gjuetia selective, përpunim dhe eksport të kastravecit të detit", e cila nuk përputhet apo pritet me sferën e juridiksionit apo kompetencës sime si Drejtor i Departamentit për Sigurinë Publike ku veprimtaria ime është në fushën e rendit dhe sigurisë publike.(Departamenti që unë drejtoj e shtrin juridiksionin e tij në gjithë territorin tokësorë në Republikën e Shqipërisë, ndërsa në detë dhe liqene, përgjegjës për problematikat që kanë të bëjnë me sigurinë e kufijëve dhe luftën kundër krimit ndërkufitarë apo cdo lloj tjetër e ka Departamenti i Policisë Kufitare në Policinë e Shtetit kjo dhe për shkak të funksionimit të saj Vertikal nga qendra në bazë pra nga Drejtori i Departamentit të Kufirit dhe Migracionit varen drejtpërdrejt DVKM) pra mes objektit të punës Sime si Drejtor Departamenti dhe objektit të shoqërisë që figuroj si administrator, nuk kanë asnjë lidhje mes tyre.Gjithashtu ju bëj me dije se unë në funksionin që mbuloj, nuk kam asnjë rol në nxjerrjen e akteve që krijojnë pasoja juridike për këtë shoqëri që aktivitetin e saj, apo shoqëri të tjera që e konkurrojnë atë që në momentin e çeljes së këtij aktiviteti ishte e vetmja e licencuar për këtë aktivitet, ndërsa aktualisht janë dy kompani që e zhvillojnë atë.

c) Nuk mund të ushtrojnë veprimtari private , që krijojnë ardhura në formën e personit fizik tregëtar, ortakëri personash fizikë tregëtarë të çdo forme....."Edhe sipas parashikimeve kësaj pike të nenit 31 "Kufizime" unë nuk jam në konflikt interesi , pasi shoqëria "Deniz-Patlixhan" shpk, që unë figuroj si administrator i saj, nuk ka prodhuar asnjëherë të ardhura për mua, kjo e vërtetuar dhe me Vërtetimin Nr prot 5628 datë 16.04.2018 e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve.

ç).Mund të zotërojë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë kapital të një shoqërie tregtare, pa asnjë kufizim, me përjashtim të rastit kur shoqëria ushtron veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këto shoqëri apo mbi shoqëri të tjera, që bashkëpunojnë ose konkurojnë me shoqërinë në fjalë, rast për të cilin zyrtarin mund të zotërojë aksione ose pjesë në kapital vetëm, në përputhje me kushtet e përcaktuara në shkronjën "c" të nenit 27 të këtij ligji. Edhe sipas kësaj pikës "ç" të nenit 31 "Kufizime" dhe kufizimet e përcaktuara në shkronjën "c" të nenit 27 të këtij ligji, unë nuk jam në konflikt interesi, dhe jam në pozita që përputhen me këtë pikë të nenit 31, pasi fusha e veprimtarisë si administrator i një shoqërie me aktivitet të pezulluar e cila ka si objekt të saj "Gjuetia selective, përpunim dhe eksport të kastravecit të detit", nuk përputhet apo pritet me sferën e juridiksionit apo kompetencës sime si Drejtor Departamentit Sigurisë Publike i cili është fushën e rendit dhe sigurisë publike, si dhe unë nuk kam asnjë rol në funksionin që mbuloj në nxjerrjen e akteve që krijojnë pasojajuridike për këtë shoqëri apo shoqëri të tjera që e konkurojnë atë".

Njëkohësisht edhe sipas shkresës së vënë në dispozicion nga subjekti dhe verifikuar edhe nga Komisioni Nr.***, dt.16.4.2018 Nga Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, Drejtoria Rajonale Tiranë, vërtetohet se tatimpaguesi “Deniz Patlixhan” sh.p.k. me administrator Gj.Loka me objekt tregtar “Tregtim peshku gaforre dhe molusqe”, për vitet 2013 -2014 ka raportuar “zero” të ardhura dhe “zero” shpenzime.

Kështu ka vijuar edhe aktualisht nuk ka asnjë ushtrim aktiviteti pasi leja është e revokuar që prej prill 2012 dhe çështja është në proces gjyqësor, aktualisht në Gjykatë të Lartë që prej 18.01.2018.

Pra deri në këto momente, subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit ndërmjet funksionit publik dhe interesave privatë, pasi nuk ka asnjë interes privat konkret që ndikon, ose duket sikur ndikon në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike në policinë e shtetit.

Megjithatë, Komisioni ngre vëmendjen se mund të krijohen në të ardhmen premisat për një konflikt në dukje apo të mundshëm të interesit në të ardhmen .²¹

Për sa më lart, Komisioni sjell në vëmendje se në çdo rast subjekti duhet të zbatojë dispozita të tjera të ligjit të konfliktit që përcaktohen në lidhje me zotërimin aktiv apo pasiv të aksioneve apo pjesëve në kapital si dhe në harmoni me kufizimet dhe detyrimet e Ligjit të Policisë së Shtetit (*neni 91 dhe 92 i tij*).

Lidhur me këtë, subjekti në seancë publike të datës 19.08.2020 sqaroi Komisionin se nuk ka asnjë aktivitet të zhvilluar prej 8 vitesh, nuk ka përfutur asnjë të ardhur dhe se mbajtja “de jure” e statusit “administrator” ka qenë fillimisht thjesht si veprim procedural në kohën kur ankimoi vendimin në vitin 2012 kur ishte ende jashtë rradheve të policisë së shtetit, më tej zgjati si procedurë gjyqësore dhe se ka patur qëllim për ta ç’rregjistruar pasi edhe nëse do të zgjasë në kohë procesi gjyqësor dhe koha e përfundimit të tij, ai nuk mund ta vazhdojë sido që të jetë vendimi gjyqësor pasi përfundon periudha e vlefshmërisë së licencës ndaj nuk do të ushtrojë aktivitet jo vetëm për këtë rrethanë por edhe sepse bën pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit.

NGA KORRESPONDENCA ME INSTITUCION RAPORTUES PËR TRANSAKSIONE TË KRYERA NGA SUBJEKTI

Institucioni ligjzbatues me informacionin e përcjellë, me shkresën Nr. *** prot., datë 16.07.2019, niveli i klasifikimit “Sekret”, afat ruajtje 20 vjet, raporton tre transaksione si më poshtë, për shtetasin Gjovalin Bardhok Loka:

-Transaksion bankar në bankën e nivelit të dytë, “Raiffeisen”, dt.31.12.2013 në numrin e llogarisë bankare të subjektit, në shumën 2.050.000 (dy milion e pesëdhjetë mijë) lek, tërhequr nga z.Gjovalin Loka.

²¹ b) “konflikt në dukje i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësi të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë: c) “konflikt i mundshëm i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara

❖ HETIMI NGA TRUPA E KOMISIONIT:

Në lidhje me transaksionin bankar për transfertën e parë, nga rekordet bankare të subjektit, rezultoi se në llogarinë rrjedhëse të tij në “Reiffeizen Bank” në dt. 27.12.2013 është bërë transfertë e një shume prej rreth 2.066.070 (dy milion e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëdhjetë) lek nga një shtetase M.M me banim në Itali me shënim “Hua” dhe tërheqje në dt.31.12.2013 i tërë shumës. Kjo shumë është e deklaruar nga subjekti në deklaratën vetting po ashtu edhe në deklaratën periodike vjetore në ILDKPKI në vitin 2014 për vitin 2013 ku ka dhënë të njëjtin shpjegim me atë në deklaratën vetting si dhe e konfirmuar me transaksion bankar dhe me akte të tjera noteriale të cilat Komisioni do të vlerësojë më poshtë.

Komisioni vijoi me pyetjet lidhur me këtë transaksion huaje që deklarohen se janë kryer në favor të vëllait të subjekti N.Loka, të cilin në kuptim të Ligjit nr.12/2018 të Vettingut të Policisë, neni 3 pika 12 dhe 14, këta persona konsiderohen “persona të lidhur” dhe “persona të tjerë të lidhur”. Për rrjedhojë, subjekti i lind detyrimi të vërtetojë interesat privatë të këtyre personave të lidhur dhe të tjerë të lidhur, burimin e këtyre të ardhurave dhe ligjshmërinë e tyre.

Në pyetjet drejtuar subjektit:

“Lidhur me këto deklarime, nga dokumentet shoqëruese që keni bashkëlidhur në D-Vetting datë 4.5.2018 rezulton marrëdhënie huadhënie parash në valutë Euro ku përfshihet si huadhënës shtetasi P. N., ndërkohë që derdhjet dhe likudimet e kësaj shume bëhen nga persona të tretë (M. M., F. M.) dhe në harkun kohor të 5 viteve për shlyerje pa interes, ndërsa përfitues i huasë, është vëllai juaj N. Loka”.

- 1. Për cilat shkaqe dhe arsye jepet kjo hua?*
- 2. A ka kontratë huaje në vitin 2013 midis këtyre personave? Nëse po, ku është depozituar dhe aktet provuese të tyre?*
- 3. Përse është kryer veprimi i transaksionit (transfete parash në emër dhe llogarinë tuaj bankare?)*
- 4. A ka patur llogari bankare vëllai juaj, në cilën bankë dhe përse nuk është bërë depozitimi i kësaj shume direkt në llogarinë e tij?*

Në përgjigjet e subjektit: *“Huaja është marrë nga vëllai im i quajtur N.Loka, me qëllim vazhdimin e aktivitetit për të bërë furnizimin me materiale elektrike (abazhure) të dyqanit të shoqërisë “LOKA-GLO” sh.p.k., me adresë të ***, Pallati ***, Shkalla *, Kati *, Tiranë, me administratore Znj.A. Loka, bashkëshortja e vëllait N.Loka.*

Nuk ka kontratë mes huadhënësit dhe huamarrësit, kjo transfertë është bërë në mirëbesim pasi N. Loka (im vëlla për llogari të të cilit është bërë kjo transfertë) ka shok A. M. (i cili është djali i xhaxhait të huadhënës M. M.), pasi janë njohur gjatë kohës që kanë qënë të punësuar për disa vite në Kosovë.

*Veprimi i transaksioneve është kryer në numrin e llogarisë sime bankare, pasi vëllai im N. Loka ka marrë kredinë në emër të Kompanisë “LOKA-GLO” sh.p.k., tek Banka *** dhe *** Bank, ku kishte këste të pashlyera për disa muaj dhe në këto kushte nuk mund të kryente transfertë bankare nga llogaria e vet.*

Po vëllai im ka patur llogari bankare në emër të kompanisë “LOKA-GLO” sh.p.k., administratore e së cilës është znj.A. L., bashkëshortja e vëllait tim N. Loka, në Banka Tirana sh.a., me të cilën ka:

-Kontratë Hipotekimi Nr.*** Rep dhe Nr.*** kol datë 04.12.2006;

-Kontratë Huaje afatgjatë Nr.*** Rep, Nr.***kol datë 15.10.2007;

-Kontratë për Ndryshim Kontrate Kredie Hipotekore Nr.***, dt.01/03.2012, ku nënshkrues si marrës të kredisë janë bashkëshortja e tij A.Loka dhe vëllai im N. Loka por për shkak të kësteve të pashlyera të kredisë nuk mund të bënte transaksione në emër të vetë apo të bashkëshortes së tij.

-Vendim i Përmbartës gjyqësor privat D. M. datë 15.07.2016 “Mbi kalimin e pronesisë së sendit të pranuar si blerje e kreditorit” ku kërkohet zbatimi i Urdhër Ekzekutimit Nr.*** datë 21.05.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me tituj ekzekutiv-Kontrat për kufi kredie shumëvjeçore Nr.*** datë 29.12.2009 Nr.*** rep Nr.*** Kol Marrëveshjes shtese Nr.ABA ***, date 18.04.2013 të Kontratës Shumëvjeçore Nr.***, datë 29.12.2009 Nr.*** rep Nr.*** kol, Kontratë e Hipotekës Nr.*** rep, Nr.*** kol datë 27.04.2013 me palë: Kreditor “Alfa Bank Albania” sh.a., Debitor “LOKA-GLO”shpk me Nuis K71319007S, përfaqësuar nga administratorja A. Loka, në të cilën është vendosur kalimi në pronësi të kreditorit “Alfa Bank Albania” sh.a. pasurinë e palujtshme të hipotekuesve N.B.Loka dtl.*** dhe A. N. K., dtl.*** përberë nga pasuria me Nr.***, ZK ***, Vol.***, Fq.***, apartament me sipërfaqe totale prej 92 m2 ndodhur në rrugën “***Tiranë”.

Ashtu siç kam sqaruar në deklaratën time, sasia në vlerën prej 15.000(pesëmbëdhjetë mijë) euro e huas së marrë është likuajtur dy herë nga 5.000(pesëmijë) euro nëpërmjet bankës “Intesa San Paolo Bank” më datë 20.07.2016 dhe 21.07.2016 (10.000(dhjetëmijë) euro në total në llogarinë e shtetases M. M. nga shtetasi F. M. nëpërmjet “Intesa Sanpaolo Bank”, pasi vëllai im N. Loka nuk kryente veprime në bankë nëpërmjet llogarive që kishte në emër të kompanisë për shkak të kësteve që kishte në banka.

Por dua të theksoj se tek rubrika detatje qëllimi i veprimit të “Kërkesë për transferë” e datës 20.07.2016 është shkruajtur tekstualisht “Shlyerje e detyrimit të marrë në dhjetor 2013 nga zoti N.Loka si dhe tek kërkesa e dytë e transfertës së datës 21.06.2019 është shkruajtur “shlyerje detyrimi të marrë më 2013 nga zoti N.Loka pjesa e dytë”.

Diferenca e mbetur prej 5.000(pesëmijë) euro është likuajtur cash në dorë me pëlqimin e palëve P. N. i cili e ka mbesë huadhënësen M. M. siç dhe është përshkruar tekstualisht në deklaratën noteriale Nr.*** rep, Nr.*** kol, datë 16.04.2018 ku thuhet: “Deklaroj me përgjegjësi ligjore se kam marrë nga shtetasi N. Loka shumën prej 5.000(pesëmijë) euro vlerë e palikuajtur nga shuma 15,000(pesëmbëdhjetë mijë) euro që mbesa ime M. M. i ka kaluar në numrin e llogarisë shtetasit Gjovalin Loka më datë 27.12.2013 për llogari të shtetasit N. Loka. Me likuidimin e kësaj shume palët nuk kanë asnjë detyrim ndaj njëri tjetrit”.

Pra P.N nuk është huadhënësi, ai është personi që ka marrë vlerën e mbetur prej 5.000(pesëmijë) euro të detyrimit që N.Loka nuk kishte shlyer akoma mbeses së tij Znj.M. M., nga e cila kishte marrë miratimin për marrjen e këtij detyrimi të pashlyer nga huamarresi N. Loka.

Dua të theksoj se veprimin e kryer në llogarinë e pagës së personit tim si shtim ashtu edhe pakësim i llogarisë, une e kam pasqyruar në deklarimin periodik të vitit 2013 që e kam bërë më 25.03.2014.

Sa më lart, Komisioni kërkoi më shumë informacion dhe subjekti dha shpjegimet të tjera shtesë lidhur me personin tjetër të lidhur, vëllain e tij.

Në pyetjet e metejshme drejtuar subjektit nëse ka patur aftësi të mjaftueshme shumash monetare personi M.M për të dhënë këtë hua vëllait të tij, Subjekti është përgjigjur se : *“Në dijeninë time shtetasja M.M. që nga viti 2005, punon dhe jeton në Itali me dokumente të rregullta dhe në Dhjetor 2013 ajo i ka patur mundësitë që me të ardhurat që disponon nga puna e saj atje të jepte hua prej 15,000(pesëmbëdhjetë mijë) euro”*.

A.M. siç e kam shpjeguar është djali i xhaxhait të huadhënëses M. M., i cili ka hyrë garant tek ajo për vlerën në 15,000(pesëmbëdhjetë mijë) euro që M.M. i ka dhënë vëllait tim të quajtur N.Loka. Ai njihej që nga viti 2002 me vëllain tim N. Loka gjatë kohës që të dy punonin në Prishtinë, Kosovë dhe sipas deklaratës noteriale të datës 07.10.2019, A. M., me të ardhurat që siguronte nga paga e tij për punën që bën kishte mundësitë financiare që ta shlyente vlerën prej 15,000(pesëmbëdhjetë mijë) euro që huadhënësia M. M. i ka dhënë vëllait tim.

Komisioni verifikoi nëse deklaratimet e subjektit ishin të vërteta dhe rezultoi se: shtetasja M.M., punonte dhe jetonte në Itali së bashku me familjen prej vitesh dhe nga të ardhurat që përfitonte, kishte mundësi që të ofronte huanë e kërkuar si ndihmë për vëllain dhe përveç kësaj, ajo kishte garanci edhe nga djali i xhaxhait të saj (A.M) për të siguruar kthimin e shumës nga huamarrësi.

Nga verifikimet e Komisionit, rezultoi se shtetasi A.M. kishte qënë në Kosovë dhe kishte punuar ashtu siç deklarohet nga subjekti për lidhjet e tij me vëllanë.

Subjekti ka vënë në dispozicion kontratë noteriale të M.M.dhe A.M. që deklarojnë për huan që i kanë dhënë Gjovalin Lokës. Po ashtu subjekti vuri dokumentacion shpjegues shoqërues të llogarisë bankare të M.M.

Nga provat e paraqitura, Komisioni konstatoi për shtetasen M.M. që rezulton nga statement bankar se ka patur të ardhura gjendje sipas vërtetimit bankar (Banca Popolare dell Emilia Romagna)²² për të dhënë shumën si dhe verifikohet transferimi i bërë nga kjo shtetase²³, mbajtëse e kësaj llogarie në favor të Gjovalin Lokës në llogarinë rrjedhese të tij. Ky transferim rezulton edhe në të hyrën bankare të Gj.Lokes në llogarinë e tij rrjedhëse).

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit konstaton se :

- ✓ Shpjegimet e dhëna në përgjigjet e pyetsorit për situatën e kreditimit të kësaj shume faktohen dhe përputhen edhe me shpjegimet për vëllain. Derdhja siç bëhet në një ditë, tërhiqet e tëra po atë ditë.Shpjegimet se transfeta e parave ishte e dedikuar për vëllain e tij dhe jo për vet subjektin

²² Banca Popolare dell Emilia Romagna ,statement bankar te gjendjes se M.M që nga data 31.3.2013 deri në 31.12.2013 dhe ekstrakt mbi lëvizjet në llogari në këtë Bankë.

²³ Dt.17.12.2013 trasferimi prej 15.000(pesëmbëdhjetë mijë) euro euro në favor të Gjovalin Lokës, borxh.

merren për bazë pas marrjes në konsideratë të tre dekaratave noteriale përkatësisht deklarata noteriale e M.M.²⁴, A.M.²⁵ dhe P. N.²⁶ se ishin detyrime për vëllain e tij.

- ✓ Statement bankar për kthimin e shumave të transferuara siç është deklaruar edhe në deklaratat noteriale.
- ✓ Shpjegime të tjera të subjektit dhe statement bankar të M.M. në llogarinë e saj bankare në Itali nga ku pasqyrohet edhe gjëndja e saj në llogari si dhe transfetra e dedikuar bërë në emër të Gj.Lokës.
- ✓ Kontratë huaje viti 2016 midis shtetasve Gj.Gj. dhe N.Loka në shumën 16.280(gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) Euro me qëllim shlyerjen e shumës prej 15.000(pesëmbëdhjetë mijë) Euro shtetas M.M, marrë si hua për N.Lokën (vëllain) në 2013.
- ✓ KJV vëren faktin që vëllai ka pasur probleme me biznesin dhe nuk përdorte dot llogarinë e tij bankare (*kjo nga të dhënat e administruara nga organet tatimore, QKB në komision dhe shpjeguar nga vet subjekti*).Vëllai i subjektit N.Loka ka qenë ortak në biznesin privat “Loka Gloë” sh.p.k. Për subjektin tatimpagues "Loka Glow" sh.p.k., me NUIS ****, me aktivitet “Importim, tregtim me shumicë dhe pakicë, i ndriçuesve dekorativ dhe profesional, pajisjeve elektrike, projektim dhe zbatim i projekteve elektrike” Biznes i Madh, në juridiksionin e DRT Tiranë; Aktualisht me status tatimpaguesi “PASIV” nga 26.06.2018; Aksioner i vetëm dhe Administrator, A. Loka, (gruaja e vëllait) e deklaruar/sipërmarres; me detyrime tatimore të papaguara (të dhënat datë 13.08.2019) në shumën 120,000(njëqind e njëzetë mijë) leke; është deklarues për Tatim Fitimin; është i regjistruar për tatimin në burim.

Referuar të dhënave për këtë subjekt, e konkretisht Bilancit të vitit 2008 dhe faturave financiare, rezulton se Shoqëria ka marrë hua afatgjatë në shlyerje, ku deri në vitin 2011 ka patur hua të palikujduar shumën kredi në masën 14,523,471(katërmëdhjetë milion e pesqind e njëzetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një) lek, kjo shihet e qartë edhe në bilancin e vitit 2011.

Gjithashtu po në këtë bilanc rezulton se Kontributi i Ortakut është 16,260,176(gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) leke. Kontribut i ortakut do të thotë që shoqëria këtë të ardhur nuk mund ta përdor për efekt të shoqërisë pasi shoqëria është me borxhe rezulton “kredimarrës”. Kontributi i Ortakut të vetëm qëndron i ngrirë.

Nga statement bankar i vënë në dispozicion nga subjekti, rezulton kredi e marrë nga N.Loka dhe A. Loka në vlerën 23.000(njëzetë e tre mijë) euro në vitin 2013.

²⁴ “Deklaratë Noteriale” Nr.*** Rep., Nr.*** Kol., datë 24/10/2019, ku Deklaruesja M.M.me vullnetin e saj të lire dhe të plotë deklaroi se më datë 27.12.2013 ka kaluar në llogarinë e z.Gjovalin Loka me transfertë bankare vlerën prej 15.000(pesëmbëdhjetë mijë) Euro. Këto vlera monetare janë dhënë në mirëbesim dhe pa kamatë për llogari të vëllait të tij të quajtur N.Loka i cili në një kohë sa më të shpejtë të më kthente huanë e dhënë nga ana ime për të. Kjo sasi monetare është dhënë në mirëbesim pasi për këtë transfertë ka hyrë garnat djali i xhaxhait tim i quajtur A.M., i cili është i njohur me z.N.Loka gjatë kohës që punonin të dy bashkë në Prishtinë. Dua të theksoj se shuma prej 15000(pesëmbëdhjetë mijë) Euro mua më është kthyer nga z.N.Loka me transfertë bankare nëpërmjet “Intesa Sanpaolo Bank” vlera prej 10.000(dhjetë mijë) euro (dy herë nga 5.000(pesë mijë) euro) në datat 20 dhe 21.07.2016, veprime të kryera në llogari të z.Loka nga z.F.M., ndërsa diferenca e mbetur me pëlqimin tim i është dhënë nga z.N.Loka dajës tim të quajtur P.N. Në përfundim me vullnetin tim të lirë deklarohet se z.N.Loka ka shlyer detyrimin prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) Euro që unë i kam dhënë hua në Dhjetor 2013 dhe se ai nuk ka asnjë detyrim ndaj meje si huadhenese.

²⁵ “Deklaratë Noteriale” NR.*** REP., NR.*** KOL., datë 07/10.2019, ku deklaruesi A.P.M ka deklaruar me vullnetin e tij të lirë dhe përgjegjësi të plotë se në Dhjetor të vitit 2013 ka hyrë garant tek vajza e xhaxhait të tij, M.M. përmes komunikimit telefonik për shumën e huas 15.000(pesëmbëdhjetë mijë euro), pa interes në mirëbesim që i ka transferuar tek llogaria bankare e z.Gjovalin Loka për vëllain e tij z.N.Loka. A.M ka hyrë garant për këtë shumë, sepse z.N.Loka e njoh prej vitit 2002, kohë kur ai punonte me Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Kosovë.

²⁶ “Deklaratë Noteriale” Nr.*** Rep., Nr.*** Kol., datë 16.04.2018, ku Deklaruesi P.N. deklaroi nën përgjegjësinë e tij ligjore ka marrë nga shtetasi N.Loka shumën prej 5.000(pesë mijë) Euro vlerë e palikuduar nga shuma prej 15.000(pesëmbëdhjetë mijë) Euro që mbesa ime M.M. i ka kaluar në llogarinë e shtetasit Gjovalin Loka më datë 27.12.2013 për llogari të shtetasit N.Loka. Me likuidimin e kësaj shumë palët nuk kanë asnjë detyrim ndaj njëri-tjetrit.

Institucioni ligjzbatues me informacionin e përcjellë, me shkresën Nr. *** prot., datë 16.07.2019, niveli i klasifikimit “Sekret”, afat ruajtje 20 vjet, raporton 2 transaksione përmes veprimeve noteriale si më poshtë, për shtetasin Gjovalin Bardhok Loka:

- Raportimi i parë ka të bëjë me Kontratën me palë huadhënës shtetasin Gj.H., në statusin individ, dhe palë huamarrëse Gjovalin Bardhok Loka, datë regjistrimi 20.02.2013, Nr. Rep/Kol ***, rregjistruar pranë noteres V. S. për dhënien e shumës hua në vlerën 16.280 (gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) Euro, tipi i transaksionit “Cash”. Në objektin e kontratës jepet informacion se huamarrësi Gjovalin Loka do ta shlyejë shumën deri në dt.20.2.2014, si garanci bllokohet në ZRPP Apartamenti Banimi 55.6 m2, ndodhur Rruga *****, Pallati **, Shkalla **, Kati**, Apartamenti**, Tiranë.
- Kontrata e dytë, me palë deklarues : Gj.H., dhe palë huamarrës Gjovalin Loka, rregjistruar pranë noterit A.B, dt.28.9.2017 me Nr.Rep/Kol***, vlerë financiare 16.280(gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) Euro, tipi i transaksionit “cash”.
Lloji i Kontratës: “Deklaratë fshirje hipoteke”, mënyra e pagesës: mes palëve vitit 2013, objekti i kontratës “Fshirja e hipotekës mbi pasurinë e lënë garanci për shlyerje detyrimi për shumën e përfshirë në transaksion 16.280(gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) Euro”, burimi i deklaruar i fondeve dhe informacion shtesë: “Hua e marrë sipas kontratës së huasë Nr.***, dt.20.02.2013, për ndihmë financiare”.

❖ HETIMI NGA TRUPA E KOMISIONIT:

KJV kërkoi regjistrin noterial nga ku rezultuan këto akte noteriale (kontrata dhe deklarata noteriale) :

1.Kontratë Huaje Nr.***, datë.20.2.2013 ndërmjet Gj.H. huadhënës dhe Gjovalin Loka huamarrës për sigurimin e një shume hua prej 16.280(gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë)Euro me afat shlyerje një vit nga nëshkrimi i kontratës dhe dhënese pëlqimi edhe bashkëshortja e huamarrësit, në këtë rast e subjektit Z.Gjovalin Loka, pasi për këtë hua u vu garanci hipotekore shtëpia e banimit e subjektit.

Kjo kontratë është e shoqëruar edhe me Kontratën e Hipotekimit Nr.***, datë.20.2.2013 të apartamentit të banimit që qëndron i bllokuar si kolateral për llogari të përfituesit/huadhënësit deri në shlyerjen e detyrimit sipas kontratës së huasë në vlerën 16.280(gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë)Euro.

2.Deklaratë Noteriale Nr.***, datë 28.09.2017 ku Gj.H. deklaroi se është likuiduar plotësisht me shtetasin Gjovalin Loka për shumën 16.280(gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë)Euro dhënë hua këtij të fundit sipas kontratës noteriale datë.20.2.2013. Me këtë deklaratë, huadhënësi deklaroi se është dakort të lirojë nga barra hipotekore apartamentin e lënë si garanci për huanë.

3.Amendim Kontrate huaje dhe hipotekimi Nr.***, datë.1.11.2017 ku palët huamarrës Gjovalin Loka dhe bashkëshortja e tij dhënese pëlqimi si dhe huadhënësi Gj. H., deklarojnë së shuma hua, është në të vërtetë për shtetasin N.Loka, vëllai i huamarrësit (subjektit) pavarësisht se Gjovalin Loka ka nënshkruar në kontratë sikur është ai huamarrësi. Në fakt Gjovalin Loka deklaroi në këtë deklaratë noteriale se ai është vetëm dorëzanësi që ka lënë shtëpinë e banimit të tij si kolateral për efekt të likuidimit të shumës. Edhe vëllai i subjektit N.Loka futet si palë në këtë amendim kontratë ku deklaroi se është ai huamarrësi i vërtetë dhe se shumën do ta shlyejë ai dhe jo Gjovalin Loka.

4.Kontratë Nr. ***, datë.13.11.2017 ku përsëri shtetasi Gj.H, deklaroi se ka marrë shumën e shlyer të plotë nga huamarrësi real (vëllai i subjektit) pavarësisht se veprimet dhe kontratat për marrjen e huasë janë kryer nga subjekti. Huadhënësi deklaroi se njësi dorëzuarës Gjovalin Lokën dhe se me shlyerjen e huasë nga vëllai i tij, mund të lirohet apartamenti nga barra hipotekore.

Të njëjtat kontrata paraqiti edhe subjekti gjatë fazës së hetimit administrativ ku dha shpjegimet e tij të detajuara për arsyet përse ishte ai nënshkruar në kontratën e huasë dhe jo vëllai i tij që ishte përfituesi real.

Subjekti parashtroi lidhur me situacionin e kësaj huaje se: *“Dua të sqaroj se huaja prej 16.280 (gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) Euro, sipas Kontratës së huasë me Nr. Rep. ** dhe Nr. Kol. *** datë 20.02.2013, si dhe Kontratë Hipotekimi Nr. Rep *** dhe Kol. *** datë 20.02.2013, duke lënë si garanci apartamentin tim prej 55,6 m ndodhur në Rrugën ***, pallati nr. **, shkalla nr.**, Apartamenti Nr.**, Tiranë, Zona Kadastrale *** nr pasurie *** vol **, fq.** në pronësi Gjovalin Loka, me dakortësinë e bashkëshortes sime, J. Loka, nuk është marrë dhe përdorur nga unë dhe familja ime për nevojat tona, por është marrë dhe likuajduar nga vëllait im i quajtur, N. Loka. Kjo vlerë e marrë hua shtetasi, Gj. H., është likuajduar në afat nga vëllai im, N.Loka, nga huaja e marrë nga shtetase M. M., kaluar në Ilogarinë e Gjovalin Loka me transfertën e datës 17.12.2013, për Ilogari të vëllait tim, N. Loka, (për të cilat kam dhënë shpjegime pranë Jush gjatë procesit të hetimit dhe depozituar tre deklarata noteriale), ndërsa zhblllokimi i banesës sime është bërë shumë kohë më vonë pas kërkesës së bërë nga vëllai im shtetasi Gj. H., për lirim të banesës sime të lënë si garanci për huanë e marrë. Dua të them kjo ka ndodhur për arsye se shtetasi, Gj. H. lëvizte shpesh jashtë shtetit për aktivitetin e tij tregëtar dhe unë nuk e kisha emergjente lirim të banesës nga barra hipotekore, pasi nuk kisha ndërmend ta shisja apo të bëja ndonjë veprim me të.*

Vlera prej 15.000(pesëmbëdhjetë mijë) Euro e marrë hua nga nga vëllai im N. Loka nga shtetase M. M., e cila është likuajduar në tre këste në datat 20 dhe 21.07.2016 nga 5.000(pesëmijë)Euro, gjithsej 10.000(dhjetëmijë)Euro duke i derdhur në Ilogarinë e M.M. nëpërmjet "Intesa San Paolo Bank" nga F. M. , i cili është kushuri i yni (dhe i vëllait tim, N. Loka i cili nuk kryente dot veprime bankare për shkak të detyrimeve/ kësteve të pashlyera që kishte në bankë, për shkak të kredive të marra dhe ende të pashlyera), ndërsa vlera prej 5.000 (pesëmijë) Euro, i janë dhënë dorazi me pëlqimin e saj, shtetasi P. N. (dajo i M. M), disa kohë më vonë. (Bashkëlidhur do keni dokumente që vërtetojnë këtë likujdim, dy kërkesat për tansferta bankare të datës 20 dhe 21.07.2016 , Deklaratë Noteriale të datës 16.04.2018, e shtetasi P. N., Deklaratë Noteriale të datës 24.10.2019 e shtetases M. M).

*Kjo sasi eurosh për likujdimin e M. M., është marrë hua në tre këste, nga vëllai im N.Loka shtetasi, Gj. Gj. (djali dajos), e cila është formalizuar në Kontratën së Huasë Nr.*** Rep dhe Nr.*** Kol, datë 08.08.2016 ku në pikën 1.1 të kësaj kontrate shkruhet, "Objekt i kësaj kontrate është dhënia hua e shumës 15.000(pesëmbëdhjetë mijë) euro dhe 50.000(pesëdhjetë mijë) lek, nga Z.Gj. Gj. dhe marrje e kësaj huaje nga N. Loka.*

Akualisht shuma prej 15.000(pesëmbëdhjetë mijë) eurosh e marre hua djalit të dajos, Gj. Gj. vazhdon të likujdohet me këste nga vëllai im, N.Loka. Lekët për likujdimin e këtij detyrimi i siguron nga paga si Specialist në Drejtorinë e Akreditimit, (paga bruto 70 000 (shtatëdhjetëmijë) lek , ose paga neto 56.960(pesëdhjetë e gjashtëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lek dhe si i punësuar me kohë jo të plotë Kompaninë "Albrecovey" (paga bruto 62.650(gjashtëdhjetë e dymijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lek), si dhe nga paga e bashkëshortes së tij, A.Loka, si e punësuar si Specialiste Projektsh pranë Drejtorisë Juridike në Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1 sh.a., Bashkia

Tiranë, (paga bruto 50.000 (pesëdhjetëmijë)lek). Këtë fakt e vërtetoj me: a. Vërtetimin Nr.*** datë 02.03.2020 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, b.Vërtetimin e lëshuar me datë 02.03.2020 nga Kompania "Albrecovey" dhe c. Vërtetimin e lëshuar nga Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1 sh.a, Bashkia Tiranë. (Bashkëlidhur do keni 3 vërtetimet e pagave).

Dua të sqaroj se qëllimi i marrjes së kësaj huaje nga vëllai im N. L., ka qënë garantimi i vazhdimi të aktivitetit tregtar në shoqërinë "LOKA GLOW" sh.p.k., pasi ai kishte marrë kredi dhe nuk kishte mundësi shlyerje. Vëllai im ka kontaktuar shtetasin, Gj. H. dhe kanë rënë dakort për t'i dhënë huanë e kërkuar por me kusht, duke i lënë garanci pasurore. Në kushtet kur ai banesën e vete e kishte lënë kolateral për llogari të bankës për kreditë që kishte marrë, më është drejtuar mua si vëlla, që të lija shtëpinë time si garanci hipotekore, për sasinë e eurove që do merrte.

Si gjithë shqiptarët, edhe unë bashkë me nusen time kemi pranuar për të ndihmuar vëllain tim ndaj të cilit përveç detyrimit e të qenit vëlla, kisha dhe një detyrim plus, pasi gjatë periudhës 16.08.1994 deri me 25.04.1997, periudhë kur kam qënë pa punë dhe nuk kam siguruar të ardhura siç dhe i kam deklaruar në shpjegimet e mia të mëparshme që kam dhënë gjatë hetimit, unë kam jetuar dhe ushqyer në shtëpinë e tij, bashkë me motrën tonë, kështu që nuk mund ta refuzoja një kërkesë të tillë.

Kontrata e huasë është bërë në emrin tim meqënëse po lija si garanci shtëpinë time dhe dhënëse pëlqimi bashkëshortja ime, J. Loka, thjesht nisur nga fakti se ne po linim garanci hipotekore banesën tone, pa patur anjë lloj përfitimi nga ky fakt. Theksoj së në atë kohë, unë nuk kisha asnjë funksion publik apo në Policinë e Shtetit.

Nisur nga fakti që shtetasi Gj. H. lëvizte shpesh jashtë shtetit për aktivitetin e tij tregëtar, vetë me inisiativë pa dijeninë time apo e vëllait tim, N. Loka, pasi nuk ishte detyrim ligjor, ka bërë Deklaratë Noteriale me Nr.*** Rep dhe Nr.*** Kol, datë 28.09.2017, në të cilën ka deklaruar se vlerën e marrë prej 16.280(gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) euro të cilën ia kishte dhënë hua vëllait tim N. Loka, jashtë zyrës noteriale dhe para përpilimit dhe nënshkrimit të kontratës së huasë, (kjo tashmë dhë ligjërish, sipas Amendimit të Kontratës së Huasë Nr. Rep *** dhe Nr. Kol *** datë 01.11.2017), i është rikthyer nga ana ime Gjovalin Loka, thjesht dhe vetëm nisur nga fakti që kontrata e parë e huasë është bërë në emrin tim. Ky veprim juridik është bërë shumë kohë më vonë nga shlyerja huasë nga vëllai im N. Loka në favor të Gj. H.(Nga lekët e marra hua në dhjetor 2013 M. M.), por që për këtë fakt nuk kishim dijeni.

Nisur nga fakti se përfituesi real i huasë ishte vëllai im dhe jo unë, ne kemi bërë dhe rregullimin juridik të këtij fakti ku kemi bërë Amendim Kontrate Huaje dhe Hipotekimi me Nr. Rep *** dhe Nr.Kol *** datë 01.11.2017, mes Xh. H.(Gj.), vëllait tim N. Loka, Gjovalin Loka, sipas amendimit të kontratës së huamarrjes, si huamarrës është vëllai im N. Loka dhe huadhënës është shtetasi Gj. H, ndërsa unë jam me cilësinë e garantuesit, duke hequr sipas meje dhe detyrimin për ta deklaruar një gjë të tillë pasi kjo ishte hua e marrë nga vëllai im.

Të gjithë palët kemi rënë dakort që detyrimin prej 16.280(gjashtëmbëdhjetëmijë e dyqind e tetëdhjetë)Euro sepse ashtu është realitetit, huamarrës i kësaj vlere, është vëllai im, N. Loka ndaj huadhënësit Gj. H, ndërsa unë Gj. Loka, jam me cilësinë e garantuesit duke lënë banesën si garanci hipotekore dhe jo të huamarrës.

Më vonë Zotit Gj.H., pasi ka kontaktuar me vëllain tim i cili i ka kërkuar të më lirojë nga barra hipotekore banesën time, ai i është përgjigjur se e kam bërë një gjë të tillë por meqë kontrata e parë ka qënë në emrin Gjovalin Loka, deklaratën për shlyerjen e këtij detyrimi e ka bërë në emër të Gjovalinit, pra sikur detyrimin e kisha shlyer unë. Vëllai im N.Loka, i ka kërkuar që të deklarojë faktin pasi pas Amendimit të Kontratës së Huasë Nr.Rep *** dhe Nr. Kol *** , datës 20.02.2013 të bërë me Amendim Kontrate Huaje dhe Hipotekimi me Nr.Rep *** dhe Nr.Kol *** datë 01.11.2017.

Si huamarrës figuron vëllai im, N. Loka dhe huadhënës Z.Gj. H., unë isha më cilësinë e garantuesit të kësaj huaje.

*Pas kësaj kërkesë Gj. H. ka bërë Deklaratën Noteriale me Nr.***Rep dhe Nr.***Kol, datë 13.11.2017 në të cilën shprehimisht shkruhet "Sa më sipër unë deklaruesi Xh. (Gj.) H., deklaroj se : " Shuma prej 16.280(gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë)Euro më është kthyer nga huamarrësi real nga shtetasi N. Loka" dhe banesa ime 55.6 m2, në adresën rruga *** pallati **, shk**, A p. **, Tiranë ZK *** Nr pasurie ***, vol **, fq.**, në pronësi të Gjovalin Loka është çliruar nga barra hipotekore".*

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, pavarësisht se huaja është marrë në kohën kur subjekti nuk ishte në marrëdhënie pune në Policinë e Shtetit dhe ishte për personin tjetër të lidhur, në këtë rast vëllain e tij , mori në konsideratë të gjithë aktet noteriale dhe shpjegimet e shtuara të subjektit më qëllim që të vërtetojë nëse deklaratimet e personave që kanë shkëmbyer para dhe kanë qenë palë në këto akte, kanë qenë të vërteta dhe nuk kanë qenë fiktive e përputhen me vullnetin real të personave nënshkrues në to.

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit pasi u njoh me shpjegimet e subjektit, kontrolloi nëse nga kontrolli pasuror do të rezultonte ndonjë tregues financiar në formën e një shtimi/pakësimi pasuror të subjektit apo shtim/pakësim likuiditetesh që mund të përkonin me vlerën e huasë.

Në pyetjet e tjera të Komisionit drejtuar subjektit për burimin e mjaftueshëm të të ardhurave që mund të kishte shtetasi Gj.H., për të dhënë shumën :

Subjekti u përgjigj se : "Në dijeninë time shtetasi Gj. H. është marrë me shitje makinash ai bente rrugën e Gjermanisë ku sillte manika nga andej dhe i shiste në Shqipëri, nga shitja e të cilave nxirrte fitim si dhe merrej me kambizëm.

Me tim vella njiheshin prej vitesh pasi ai është nga qyteti i Rreshenit dhe vëllai nga viti 1988 ka punuar si inxhinier mekanik dhe Kryetar dege në NTPN Dega Mirditë dhe më vonë aktivitet privat, Gomisteri dhe Autoshkollë në qytetin e Rrëshenit".

Por, Komisioni konstatoi se kjo marrëdhënie huaje që daton me nënshkrimin e kontratës së parë me dt.20.02.2013 nuk është pasqyruar në IDKPKI në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2013 (1.11.2013) të subjektit.

Komisioni vërejti shkelje të natyrës së zbatimit të ligjit të posaçëm Nr. 9049/2003 për Deklarimin e Pasurisë :

Së pari, subjekti në fillim të marrjes së detyrës më datë 1/11/2013, kishte detyrimin të deklaronte huanë edhe për faktin se kishte vendosur barrë hipotekore shtëpinë si aset i paluajtshëm.

Nga ana tjetër, lidhur me mundësinë financiare të shlyerjes së huasë nga personi tjetër i lidhur, vëllai, bazuar edhe në shpjegimet e subjektit, huamarrësi, vëllai i subjektit ka kryer disa kontrata huaje më qëllim shlyerjen e disa detyrimeve që i rezultojnë dhe ka përdorur skemën e kontratave të njëpasnjëshme të huasë për të shlyer huanë paraardhëse.

Duket se kontrata e huasë e lidhur në 20 shkurt 2013 ndërmjet Gj.H. dhe Gjovalin Loka që më pas amendohet me huamarrës real vëllain N. Loka, shlyhet me shumën prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro të marra në dhjetor 2013 nga dërgesa e M.M. + 1.280 (njëmijë e dyqind e tetëdhjetë) euro nga të

ardhurat e vet N.Loka (dhe kjo përputhet me dokumentet e hartuara nga palët dhe që përkojnë edhe si veprime kohore).

Por nga ana tjetër ka lindur përsëri një detyrim i ri për likuidimin e shumës 15.000(pesëmbëdhjetë mijë) euro të dërguar nga M. M. në Dhjetor 2013 (të cilat likuidohen në datat 20 dhe 21 Korrik 2016 në shumën 10.000(dhjetëmijë) euro dhe 5.000(pesëmijë)euro në 2016 me person të autorizuar P. N.). Burimi i parave për të shlyer këtë shumë, pretendohet tashmë nga subjekti se është shlyer nga huaja e marrë përsëri nga vëllai i subjektit N. Loka., djalin të dajos (Gj. Gj.) me të cilin lidh kontratë huaje në 8 Gusht 2016, për huanë në shumën 15.000(pesëmbëdhjetë mijë)Euro + 50.000(pesëdhjetëmijë) lek.

Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit, Kontratën e Huasë Nr.*** datë 8.08.2016 të lidhur midis dy palëve: Gj.Gj. dhe N.Loka për dhënien e shumës nga N.Loka në vlerën e 15 000(pesëmbëdhjetë mijë) Euro.

Në këtë skemë shlyerjesh, vëllai i subjektit gjatë harkut kohor 2013-2018 ka shlyer dy huatë në shumën 15.000(pesëmbëdhjetëmijë) euro dhe 16.280(gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) euro. Ndërkohë që kontrata e tretë e huasë, që është e lidhur midis Gj. Gj. dhe N. Loka në vlerën prej 15.000(pesëmbëdhjetë mijë)Euro pretendohet nga subjekti se është në vijim të shlyerjes. Dhe për këtë, subjekti ka paraqitur të ardhurat e vëllait nga punësimi i tij në dy marrëdhënie pune dhe përfitimin financiar në shumën 62.650²⁷(gjashtëdhjetë e dymijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lek(pagë mujore neto) dhe 56.960²⁸(pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lek(pagë mujore neto), si dhe të ardhurat nga paga e bashkortes së tij A.Loka²⁹.

Bazuar në njohjen familjare të palëve nënshkruese në këtë kontratë të re huaje tashmë, por edhe bazuar në kushtet e kontratës së lidhur, nuk ka afat të shprehur për shlyerjen e huasë si dhe nuk ka garanci të kërkuar prej huamarrësit.

Po ashtu Komisioni verifikoi mbi të ardhurat e vëllait dhe gruas së tij në organet tatimore dhe rezultoi e dhënë e vërtetë deklarimi dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti për punësimet e tyre dhe të ardhurat e tyre mujore.

Në lidhje me burimin e të ardhurave të personit tjetër të lidhur Gj.Gj. në cilësinë e huadhënësit, subjekti ka paraqitur pranë Komisionit të ardhurat e këtij personi³⁰ ku vërtetohen mundësitë financiare për dhënien e kësaj shume.

Në lidhje me këtë veprim juridik, Komisioni nuk ka kompetencë direkte hetimi pasi këto janë dy palë të lira, që nuk përfshihen dhe nuk kanë shkëmbim interesash privatë me subjektin e vlerësimit, ndaj dhe si të tillë në kuptim të nenit 3 pika 14 e Ligjit të Vlerësimit 12/2018 (i ndryshuar), nuk

²⁷ Vërtetim Shoqëria "Albrecovery", dt.2.3.2020, N.Loka i punësuar me kohë të pjesshme pagë bruto 62.650(gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) Lek (vërtetuar edhe nga organi tatimor)

²⁸ Vërtetim Drejtoria e përgjithshme e Akreditimit me detyrë : specialist me të ardhura bruto 70.000(shtatëdhjetë mijë) lek dhe neto 56.960(pesëdhjetë e gjashtëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lek (vërtetuar edhe nga organi tatimor)

²⁹ Vërtetim nga Rezidenca Studentore Universitare nr.1, Sh.A , dt.2.3.2020 , A.Loka me funksion Specialist Projektsh pranë Drejtorisë Juridike me pagë mujore bruto 50.000(pesëdhjetë mijë) lek (vërtetuar edhe nga organi tatimor)

³⁰ Vërtetim kontrate punësimi me page, ekstrakt bankar i Gj.Gj.16.746 (gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzetë e katër) euro, karte ID italiane, derdhje ne llogari te Gj.Gjoka nga bashortja e tij. F.Gjoka shuma 20.000 (njëzet mijë) euro (5.000(pesëmijë) euro ne vitin 2012, 5.000(pesëmijë) euro ne 2013 dhe 10.000(dhjetëmijë) euro ne 2016

konsiderohen subjekt i Ligjit për Vetingun. Duke qenë se subjekti i vlerësimit, nuk është pjesë e përfshirë në këtë kontratë huaje, edhe hetimi administrativ lidhur me këtë marrëdhënie juridike nuk është objektiv në vetvete.

Pavarësisht këtij fakti, subjekti ka përcjellë në vijim të shpjegimeve, dokumente justifikues edhe për këtë palë.

Ajo çka Komisioni ka në detyrimin e saj ligjor, është të konstatojë veprimet e subjektit në raport me detyrimet e tij për zbatimin e ligjit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive si dhe Ligjin e Vetingut të Policisë së Shtetit, në harmoni me dispozitën e nenit 32-34 të Ligjit 12/2018(i ndryshuar).

Në këtë kontekst ligjor, Komisioni ka konstatuar se subjekti Gjovalin Loka nuk ka zbatuar drejtë ligjin 9049/2003 për deklarimin e interesave privatë në IDKPKI (pavarësisht se këto hua ishin të destinuara për vëllain e tij) në deklaratën para fillimit të detyrës në Nëntor 2013.

Edhe për këtë fakt, subjekti ka dhënë shpjegimet e tij nga ku ka deklaruar se:“Në lidhje me mospasqyrimin e këtij detyrimi në deklaratën e pasurisë në procesin e vetingut, ju bëj me dije se ajo është plotësuar në mënyrë korrekte sipas rubrikave, në përputhje me nenin 5 “Interesa privatë” dhe nenin 7 “Deklarime rast pas rasti të interesave priovatë të zyrtarit“ të Ligjit 9367/2005“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”(i ndryshuar) për të cilin ju sqaroj sa më poshtë:

Në faqen 9 të saj në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” e cila ka si objekt : detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj) që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetura ende pa shlyer deri në datën e deklarimit të subjektit të vlerësimit dhe personave të lidhur me të (pra si detyrim i ngelur deri më datë 4.5.2018 kur janë dorëzuar dokumentet e Vetingut).

*Ju sqaroj se, ky detyrim nuk është pasqyruar nga ana ime në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizik” e cila ka si objekt Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve) që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e deklarimit të subjektit të vlerësimit dhe personave të lidhur që i tajkon deri më datë 4.5.2018, pasi në këtë datë kur është plotësuar/dorëzuar formulari Deklaratë e Pasurisë për procesin e vetingut, detyrimi prej 16.280(gjashtëmbëdhjetëmijë e dyqind e tetëdhjetë)euro i huasë së marrë shtetasit Gj.H., siç dhe theksova është likuiduar në dorë shumë kohë më parë, por edhe ligjërisht, sipas Deklaratës Noteriale me Nr. *** Rep dhe Nr.*** Kol, dt.13.11.2017, kjo shumë është likuiduar nga N.Loka (vëllai im) dhe banesa ime prej 55.6 m2 në adresën Rruga ***, pallati **, shkalla **, Apartamenti **, Tiranë, ZK***, Nr.pasurie ***, në pronësi të Gjovalin Lokës është çliruar barra hipotekore. Po ashtu në këtë datë ishte shlyer edhe detyrimi ndaj shtetasës M. M. me lekët e marra hua djalit të dajos tim Gj. Gj.sipas Kontratës së Huasë Nr.*** Rep, dhe Nr.*** Kol, dt 8.8.2016 ku në pikën 1.1. të kësaj kontrate shkruhet: “Objekt i kontratës është dhënia hua e shumës 15.000(pesëmbëdhjetëmijë) euro dhe 50.000(pesëdhjëmijë)lek. Në këto kushte unë nuk kisha çfarë të deklaroja pasi tashmë ky detyrim ishte shlyer dhe nuk ekzistonte. Nisur sa më lart, ju bëj me dije se plotësimi i formularit Deklaratë e Pasurisë për Procesin e Vlerësimit më datë 4.05.2018 është plotësuar korrekt nga ana ime”.*

Komisioni, vëren se shpjegimet e subjektit orientohen vetëm në lidhje me detyrimet bazuar në Ligjin e Vetingut të Policisë dhe jo në detyrimet sipas ligjit për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të disa nëpunësve publikë. Edhe pse arsyetimi i subjektit lidhur me zbatimin e duhur të Ligjit të Vetingut është i saktë, në përfundim të gjithë këtij komunikimi shkresor dhe shpjegues me subjektin, Komisioni ka arritur në konkluzionin se :

Ka mosdeklarim të huasë sipas aktit noterial vetëm sa i takon deklaratës në IDKPKI para fillimit të detyrës në Nëntor 2013. Kontratë Huaje Nr.***, datë 20.2.2013 ndërmjet Gj.H. huadhënës dhe Gjovalin Loka huamarrës për sigurimin e një shume hua prej 16.280(gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) euro.

Në konsideratë të shpjegimeve të subjektit dhe bazës ligjore për detyrimin e subjektit të vlerësimit sipas formularit të deklarimit të pasurisë (pjesa për detyrimet financiare ndaj personave juridikë/fizik) Komisioni i ka vlerësuar të gjitha faktet, provat dhe shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë huadhënie, afatin ligjor brenda të cilit i lindin detyrime subjektit për të deklaruar si dhe/apo kur ato (dy huatë) janë krijuar në kohën kur subjekti ishte jashtë rradhëve të policisë së shtetit.

Por duke qenë se këto veprime janë të lidhura dhe kanë vijuar pasojat e shlyerjes së tyre në vitet kur subjekti ishte punonjës policie, pavarësisht se ato ishin për persona të tjerë të lidhur, Komisioni i ka hetuar ato.

I pyetur në seancën publike, subjekti dha shpjegimet e tij, duke qenë se kishte kohë që ishte shkëputur nga rradhët e Policisë së Shtetit dhe kur u ripranua ishte i papërditësuar për këto detyrime ligjore dhe mënyrën e duhur të plotësimit të formularit të deklarimit. Po ashtu ai theksoi se edhe kur ka kërkuar këshillim nga strukturat përkatëse në Policinë e Shtetit, është orientuar që të mos deklaronte një hua që në vetvete ishte për vëllain e tij. Shpjegimet e subjektit për këtë fakt, u moren parasysh në fund të procesit të dëgjimit me vendimarrjen e saj.

Si dhe në raste të tjera të ngjashme me subjekte të tjerë të ligjit të vlerësimit, Komisioni vëren se ka një mangësi të theksuar në njohjen e ligjit për detyrimet që përcakton ligji i posaçëm 9049/2003 për subjektet që duhet të deklarojnë interesat privatë, por akoma dhe më shumë mangësi shfaqen në gadishmërinë dhe përgjegjësinë për konsultimin dhe asistencë të vazhdueshme që strukturat përgjegjëse brenda Policisë së Shtetit duhet të mbështesin subjektet e ligjit për deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit.

Komisioni vlerëson se kjo mangësi në raportimin e një deklarate periodike 2013 kur subjekti u bë subjekt deklarimi në ILDKPKI , nuk mund të pasjell *a priori* shkaqet e penalizimit të subjektit në atë masë të procesit të vlerësimit tërësor të KJV sipas dispozitave të nenit 60 të ligjit 12/2018 (i ndryshuar).

Komisioni si organ i ngritur në zbatim të Ligjit të Vlerësimit Kalimtar, ka për prioritet dhe bazë thelbësore plotësimin e drejtë dhe të saktë si dhe pasqyrimin e çdo të dhëne pasurore, financiare, detyrime e shpenzime që i rezultojnë subjektit që nga koha e marrjes së detyrës në strukturat e Policisë së Shtetit e deri në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit 12/2018 (i ndryshuar), kur i lind edhe detyrimi ligjor për të deklaruar pasuritë e tij të rregjistruara ose jo në rregjistrat publike.

Për peshën që këto deklarime apo mosdeklarime mbartin në raport me tërësinë e procesit të vlerësimit të subjektit, dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit, trupi vlerësues i çmon si fakt/rrethanë të

pamjaftueshme për të passjellë, në rastin konkret, në mënyrë të vetme dhe të drejtëpërdrejtë aplikimin pikës c, të nenit 62, të Ligjit nr. 12/2018(i ndryshuar), me pasojat e parashikuara prej tij. Këto cilësohen si shkelje të Ligjit 9049/2003 por jo të Ligjit të Vlerësimit 12/2018 (i ndryshuar).

Në çdo rast Komisioni ka patur mundësi të hetojë situacionin në fjalë dhe të mos ketë asnjë pengesë për shkak të vet deklarimit të subjektit në njërin nga deklaratat periordike të vitit 2018 dhe më tej në deklaratën vetting 2018.

Trupa vlerësuese vë në dukje se në Ligjin e Vlerësimit 12/2018(i ndryshuar), nuk ka një dispozitë të shprehur lidhur me marrjen si dhe deri ku si provë nga ana e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit të këtyre deklarimeve, fuqise prapavepruese të vlerësimit të Komisionit për mënyrën e zbatimit të ligjit në kohën e plotësimit të deklaratave sipas ligjit specifik të ILDKPI (bazuar në nenin 34 të ligjit 12/2018(i ndryshuar), pika 3 të Ligjit ILDKPKI, vë në dispozicion të gjitha informacionet që disponon si rezultat i deklarimit).

BASHKËSHORTJA E SUBJEKTIT VLERËSUES:

Rezultojnë të ardhura të përfituara nga paga si mësuese në Shkollën e Ciklit nëntëvjeçar në total shuma 6,319,983 (gjashtë milion e treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre) lek.

➤ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

Të ardhura nga barrë lindja në vitet 2002 dhe 2003 si dhe 2005 si dhe të gjitha të ardhurat nga punësimi në Drejtorinë Arsimore gjatë viteve 2002-2018 si më poshtë:

Të ardhura në vitet 2002 - 2005 përfshirë të ardhurat nga barrë lindja 527.359 (pesëqind e njëzet e shtatë mijë treqind e pesëdhjetë e nëntë)lek;

Të ardhura nga 2006 -2009 listë pagesa e Insitutit Arsimor shuma 1,294,105 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e pesë) lek;

Të ardhura nga 2010 -2013 listë pagesa e Insitutit Arsimor shuma 1,903,225(një milion e nëntëqind e tre mijë e dyqind e njëzet e pesë)lek;

Të ardhura nga 2014 -2017 listë pagesa e Insitutit Arsimor shuma 2,595,294(dy milion e pesëqind e nëntëdhjetë e pesëmijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) lek.

Në total të ardhurat deri më 4 Maj 2018

6,319,983 lek.

Gjithashtu shpërblime të përfituara në vitet 2006-2011, në shumën 56.500 (pesëdhjetë e gjashtëmijë e pesëqind)lek.

Nga verifikimet e Komisionit ne organet tatimore, rezultojnë të konfirmuara këto të ardhura.

Nga hetimi i KJV ka rezultuar se më datë 28/3/2014 ka çelur llogari rrjedhëse në “Abi Bank” bashkëshortja e subjektit.

Ndërsa më datën 15/5/2015 ka çelur llogari kursimi për I.Loka dhe A. Loka, dy vajzat e bashkëshortëve.

Nga levizjet bankare rezulton se bashkëshortja në vitet 2015 kur ka hapur dy llogaritë e kursimit e deri në Shkurt 2017, ka transferuar nga llogaria e saj rrjedhëse të pagës, në mënyrë periodike vlefte monetare për dy vajzat e saj me nga 5.000(pesë mijë)lek/muaj për secilën. Nga të dhënat bankare në periudhën e përmendur, paga e bashkëshortes mujore ishte rreth 50.000(pesëdhjetë mijë) lek/muaj. Në diferencën e transfertës mujore që bënte bashkëshortja çdo muaj për kursim për vajzat e saj (-10.000(dhjetë mijë) lek/muaj), bashkëshortja e subjektit ka patur një pagë rreth 40.000(dyzetë mijë) lek/muaj. Bazuar në llogaritjet e INSTAT për raportin të ardhura-shpenzime, gjëndja financiare e bashkëshortëve për këto vite rezulton pozitive.

Në vijim është vërejtur se bashkëshortja e subjektit ka vijuar në mënyrë permanente të furnizojë me para dy llogaritë e vajzave duke transferuar në mënyrë të rregullt çdo muaj shuma nga llogaria e saj bankare. Kështu, ka rezultuar se në vitin 2017 disa muaj ka rritur masën e parave të transferuara nga 5.000(pesë mijë) lek/muaj për secilën vajzë në 10.000(dhjetë mijë) lek/muaj ndërsa ka shkuar në fund 2017 e në vijim 25.000(njëzetë e pesëmijë) lek për secilën.

Sipas statement bankar të bashkëshortes së subjektit dhe transfertave të kryera për dy llogaritë e çelura respektivisht për dy vajzat, deri në datën e deklarimit 4/5/2018, rezultojnë kalim depozitë bankare kursimi në emër të dy vajzave respektivisht në shumën 310.000 (treqind e dhjetë mijë)lek për secilën. Komisioni bazuar në llogaritjet e të ardhurave mujore për frymë si dhe shpenzimeve të konsumit në familje sipas përbërjes familjare, konkludon se të ardhurat familjare të përfuara në këto vite nga paga dhe shpërblime, kanë krijuar mundësi financiare për bashkëshortët për të krijuar këto vlera llogarish kursimi në emër të dy vajzave të tyre.

SHPENZIMET SIPAS DEKLARATËS VETTING, SUBJEKTI GJOVALIN LOKA PËR TRE VITET E FUNDIT:

Në pasqyrën shpenzimet e deklarueshme në deklaratën Vetting, subjekti deklaron:

- Shpenzimet e vitin 2017 për furnizim me ujë të pijshëm për periudhën Janar-Dhjetor 2017 në shumën 22.937(njëzetë e dymijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë) lek;
- Shpenzimet e vitit 2017 për funizim me energji elektrike për periudhën Janar-Dhjetor 2017 në shumën 81.193(tetëdhjetë e një mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tre) lek;
- Shpenzimet e vitit 2017 për telefon fiks dhe internet për periudhën Janar-Dhjetor në shumën 30. 000 (tridhjetë mijë) lek.

Dokumentet që shoqërojnë deklarinimin lidhur me shpenzimet e deklarueshme:

Nr.	Përshkrimi i shpenzimeve të deklarueshme në DT-Vetting	Vlera në Lek
1	Librezë pagesë ujë i pijshem (UKT)	22.937
2	Librezë pagese energji elektrike (OSHEE)	81.193
3	Librezë pagese ALBtelecom	30.000
TOTAL		134.130

Verifikimi për ekzistencën e shtëpisë si aset i ligjshëm dhe që përputhet me gjetjet e hetimit, është bërë më lart. Ndërkohë që për mjaftueshmërinë e mbulimit të të ardhurave rezulton se nuk ka mopërputhje dhe se subjekti është i gatshëm në kohë të paguajë detyrimet mujore.

Në pasqyrën e shpenzimeve të deklarueshme në deklaratën e Vetingut, subjekti deklaron: shpenzimet totale për udhëtimet jashtë shtetit për vitet 2015, 2016, 2017 janë në shumën 344.521 (treqind e dyzetë e katër mijë e pesëqind e njëzet e një) lek.

Për të vërtetuar saktësinë e deklarimit të subjektit si dhe mjaftueshmërinë ne burimeve të ligjshme për të përballuar këto udhëtime dhe shpenzimet përkatëse për to, KJV i është drejtuar DPPSH (TIMS) për të verifikuar hyrje – daljet.

Me shkresën “Kthim Përgjigje” Nr.*** Prot, datë 21.08.2019 (hyrje në Komision) nga TIMS është administruar përgjigjia sipas të cilës konfirmohen të gjitha rrugët hyrese dhe dalëse nga territori i vendit në përputhje me deklarimin e subjektit.

Sa i takon mbulimit të shpenzimeve, trupa në vlerësim të analizës financiare të kryer për këtë subjekt, del në konkluzionin se subjekti ka të ardhura për të përballuar këto shpenzime, (shih tabelën të ardhura-shpenzime).

Analizë financiare për secilin nga vitet 2015, 2016, 2017, 2018.

Shpenzimet per fryme sipas INSTAT	Per fryme	Konsumi per familje	Te ardhurat nga Pagat sipas viteve e Policine e Shtetit sipas viteve Gj.Loka	Te ardhura nga punesimi te tjera Gj.Loka	Te ardhura paga neto J.Loka	Shperblime J.Loka	Te ardhura nga familjar et	Te ardhura te tjera nga kursimet sipas DT Vetting	Shperblime Gj. Loka	Shpenzime sipas deklarimeve e DVetting	Total te ardhurat	Diference te ardhura minus shpenzime	Progresive e diference per cdo vit deri ne fund 2018
vitë 2015	224,276	1,121,380	1,122,331.50		591,480				110,030	41,922	1,823,842	660,540	1,393,814
vitë 2016	235,092	1,175,460	1,137,150.57		617,119				21,816	82,146	1,776,086	518,480	1,912,294
vitë 2017	235,092	992,933	1,259,600.69		657,108				187,741	67,075	2,104,450	1,044,442	2,956,735
vitë 2018	86,206	344,824	867,755.73		164,591					153,108	1,032,347	534,415	3,491,150
TOTAL shpenzime konsumi familje 1990-2018		12,093,824	7,590,269	1,095,115	6,319,983	56,500	986,000	1,900,000	1,451,018	2,509,251	18,094,225	3,491,150	

(përmbledhëse e gjëndjes tërësore 1991-2018 financiare dhe shtojca 1 bashkëlidhur vendimit)

Të ardhurat nga (paga + shpërblime bashkëshortët) + (llogari kursimi vajzat) + nga familjarë vitet 1990-2018					Total shpenzime (Instat + tjera) vitet 1990-2018		Progresivi ndër vite (1990-2018)
Gj.Loka	J.Loka	A.Loka	I.Loka	Familjarët	Konsumi Familjar	Blerje shtëpie, automjet, motorr dhe udhëtime	3,491,150
10,721,718	5,646,183	410,000	410,000	986,000	12,093,824	2,509,251	
TOTALI 18,173,901					TOTALI 14,603,075		

<i>Total asete (pasuri palujtshme + cash + depozitë deri datën e dek Vetting 2018)</i> 1.900.000 lek shtëpi banimi Tiranë 820.000 lek depozite kursimi dy vajzat 50. 033 lek llogari rrjedhese b.shortja 50. 639 lek llogari rrjedhese subjekti	<i>Total detyrime deri datën e dorëzimit të deklaratës vetting 2018:</i> 0 (zero)
2.820.672 lek total	<i>Pasuria Neto deri në datën 04.05.2018 = 2.820.672 lek total</i>

❖ **Në përfundim të procedurës së kontrollit të pasurisë, trupa vlerësuese e Komisionit konstaton se :**

- ✓ *Nuk është kryer deklarim i rremë;*
- ✓ *Nuk është kryer fshehje e pasurisë;*
- ✓ *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;*
- ✓ *Subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.*

B) KONTROLLI I FIGURËS

1. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të vlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimin e atyre që janë përfshirë apo kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë veprimtari kriminale.
2. Subjekti Gjovalin Loka në zbatim të nenit 36, pika 2 e ligjit nr. 12/2018 “*Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*”, ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në datën 4.5.2018, brenda afatit ligjor.
3. Kontrolli i figurës për subjektin e vlerësimit Gjovalin Loka, është kryer bazuar në përcaktimet e nenit 4, pika 1, gërma “b” dhe neneve 35-42, 48 dhe 51 e 52 të parashikuara në Ligjin e Vlerësimit nr.12/2018 (i ndryshuar).
4. Procedura për kontrollin e figurës është kryer sipas përcaktimeve të neneve 36-37 për bashkëpunimin me institucionet publike dhe ato ligjzbatuese, informuese dhe verifikuese në vend dhe jashtë tij, verifikimit të informacioneve nga publiku në lidhje me akti vitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo personave të lidhur, si dhe vlerësimit të provave, informacioneve të klasifikuara dhe informacioneve të tjera të disponueshme që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet, përfshirë rrethanat rënduese dhe lehtësuese bazuar në ato që parashikohen në nenin 38-41 të Ligjit.
5. Trupa e vlerësimit ka proceduar në dy momente të rëndësishme të verifikimit të figurës sipas ligjit 12/2018:

) Fillimisht është administruar dhe verifikuar Formulari i Kontrollit të Figurës i plotësuar nga subjekti si detyrim i Ligjit 12/2018.

) Më tej janë administruar përgjigjet nga institucionet ligjzbatuese, verifikuese dhe informuese. Në Deklaratën për Kontrollin e Figurës, Subjekti i vlerësimit, Gjovalin Loka, ka deklaruar si më poshtë:

- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër;
- nuk është njohur me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që ka pasur apo ka të rregjistruar në gjendjen civile,
- nuk ka pasur shtetësi tjetër

Të dhëna për vendbanimin : Të njëjtën adresë që ka deklaruar edhe në formularin e deklarimit të pasurisë, nuk ka vendbanim të dytë. Këtu Komisioni sqaron se ndërkohë që është deklaruar në këtë periudhë kohe për shkak të detyrimit ligjor pas hyrjes në fuqi të ligjit, nga rregjistrari noterial si dhe nga vet komunikimi shkresor gjatë fazave të pyetjeve përgjigjeve me subjektin, ka rezultuar se në vitin 2019 ka marrë një shtëpi me qera për arsye zgjerimi të kushteve të banimit. Subjekti ka bashkëlidhur kontratën e qirasë me të dhënat përkatëse marrjen me qera të një Apartamenti banimi me çmim 30.000(tridhjetë mijë)lek/muaj si dhe ka paguar edhe detyrimin tatimor mbi qeranë.

- Të dhëna për arsimin dhe kualifikimet: të njëjta me ato të deklaruara në formularin e vlerësimit profesional;
- Të dhëna për Punësimin: të njëjta me ato të deklaruara në formularin profesional,
- Të dhëna për Sigurinë: Në pjesën 5 të këtij formulari subjekti i është përgjigjur të 18 pyetjeve me përgjigjen negative “jo”.

Në përgjigjen për pyetjen e 18-të: *“A keni qenë anëtar, bashkëpunëtor, ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish shërbimit të Sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*, subjekti është përgjigjur **“Jo”**.

Ndërkohë në zbatim të kërkesave të Ligjit 12/2018 (i ndryshuar) konkretisht të nenit 36 pika “dh” për Bashkëpunimin me Institucionin e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, këtu e në vijim Autoriteti i Dosjeve dhe Ligjit 45/2015, nenit 26 pika 1 dhe 6, gërma “b” si dhe nenit 29, pika 1 dhe 2 e ligjit 45/2015, Autoriteti ka detyrimin të informojë dhe përgjigjet çdo kërkesë të institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike, lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo kërkohet në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t’u emëruar ose ngritur në detyra të cilat edhe specifikohen/apo përfshihen në rastin konkret në të dyja ligjet e posaçme 45/2015 dhe 12/2018.

Në vijim të korrespondencave midis institucioneve, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit fillimisht me shkresën Nr.*** prot, dt. 25.6.2019 ka kërkuar informacion në bazë të ligjit të Autoritetit të Dosjeve

dhe më tej ka përcjellë pranë këtij Autoriteti formularin tip të aplikimit³¹ për subjektet që ka në vlerësim, të plotësuar nga ana e tyre sipas rubrikave që përmban ky formular.

Mbi këtë aplikim ligjor, Autoriteti i Dosjeve ka nisur verifikimin përkatës dhe me shkresën “Kthim Përgjigje” Nr. *** prot, dt.8.10.2019, ka përcjellë pranë Komisionit vendimin kolegjal të Autoritetit të Dosjeve, mbi gjetjet e kërkimeve për subjektin e vlerësimit Z. Loka, **përmbledhtas si më poshtë:**

“Nga verifikimet e kryera, deri tani për kandidatin Z.Gjovalin Bardhok Loka, sipas kërkesës së paraqitur nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, në zbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme", sipas Ligjit nr. 45/2105 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, rezultoi se janë identifikuar disa dokumente që i përkasin Fondit Dega e Punëve të Brendshme Kukës si dosje personale, dosje pune dhe dosje përpunimi, libër evidence ku figuron ndër të tjera edhe emri i subjektit Gjovalin Loka. Në këto dosje Z. Loka rezulton me detyrë funksionale Punonjës Operativ në Dega e Punëve të Brendshme Kukës, Ana e Sigurimit në disa dokumente si: Lista e punonjësve operativë që janë njohur me dosjen, lista e punonjësve operativë që mbajnë dosjen. Data e marrjes në dorëzim të dosjes dhe materialeve të dosjes 29 janar 1991.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes të dosjeve rezultojnë se materialet shkresore të këtyre dosjeve janë hartuar nga punonjësi operativ pararendës i Z. Loka pra raporte, informacione, vendime, plan — kombinacioni për kontaktimin e bashkëpunëtorit me personin në përpunim ose në përgjimin e bisedave të tyre etj., që më pas ja ka dorëzuar dosjen punonjësit tjetër operativ në detyrë Z. Loka në momentin e emërimit.

Në analizë dhe sintezë sa më sipër, referuar Rregullores së Evidencës Operative të vitit 1987 "Libri i evidencës së punëtorit operativ është dokumenti bazë ku pasqyrohet i gjithë fondi aktiv dhe i arkivuar i dokumenteve të rrjetit sekret informativ i cili shërben për të njohur në çdo kohë situatën operative të zonës. Punëtorët operativë të zonave mbajnë Librin e evidencës operative model 4 të Sigurimit" siç është identifikuar edhe në rastin konkret të punonjësit operativ Z. Gjovalin Loka.

Neni 3 i Ligjit nr. 45/2015, në pikën 5 përcakton qartë se, cilat konsiderohen dokumente të ish Sigurimit të Shtetit.

"Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit" janë: a) të gjitha mjetet bartëse të informacioneve, të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, të disponuara prej tij apo që i janë vënë në përdorim, pavarësisht nga

31

SEKSIONI E: INFORMACION SHITESË PËR TË DIJENË NËSHMËRË PËR IDENTIFIKIMIN E DOKUMENTACIONIT

ARKIVJË

1. VËNDI I MËSIMIT/PUNËSIT PAS MËRSHËS SË MOSHËS TË VËLË (PËRA 7 KORRIKUT 1991)

Nr	Qyteti	Vendi i Punës
1	ZHARRË FAN MIRDIË	MEZUES SHALLLA PËRVEGARE DARRANZ MIRDIË
2	ZHARRË FAN MIRDIË	210 BARTIAKË (FINANCE) KOOP. BART. MEZ. FAN MIRDIË
3	ZHARRË FAN MIRDIË	DËGAPINËVE BRENDSHME QYRES

2. A KËNI APLIKUAR MP BARRË PËR VERIFIKIM FIGURJË

Komisioni Mësimi Komisioni Bashkës Kopje dokumente tilla ka

SEKSIONI D: DOKUMENTACIONI I PAKAQTËSIT

Futuranga e karrës së identitetit.

Kopje e notuar e vendimit të ndryshimit të emrit nëse ka emra apo mbetura të tjera që gjenden në listat e mëposhtme 3 dhe 4.

Argumentimi nga subjekti për trajtimin e bërë me përparësi.

Mësimi: Ky formular plotësohet dhe mblidhet nga aplikanti dhe kthehet nëse ka detyrë të plotësojë dhe detyrë të plotësojë.

Mësimi/Komisioni i Aplikantit: GJOVALIN LOKA

03072019

forma e ruajtjes, veçanërisht, por pa u kufizuar: i) dosje, të dhëna, shkresa, harta, plane, filma, regjistrime me figurë, me zë dhe regjistrime të tjera; ii) riprodhimet, kopjimet e tyre dhe publikata të tjera, të cilat janë fotokopjuar dhe administruar në bazë të akteve ligjore e nënligjore; si dhe iii) mjetet ndihmëse të domosdoshme për të bërë interpretime, veçanërisht programet për përpunimin automatik të të dhënave; b) dokumentet e gjykatave dhe të prokurorive, për aq sa disponon fondi i ish-Sigurimit të Shtetit; c) dokumente të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe organizatave politiko-shoqërore që kanë lidhje me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit, vetëm në masën dhe sipas përcaktimeve të nenit 2, pika 1, të këtij ligji.

Pika 5 germa "a" e nenit 3 për përkufizimin e dokumenteve ("të gjitha mjetet bartëse të informacioneve të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, të disponuara prej tij apo që i janë vënë në përdorim), i përfshin dokumentet e administruara në rastin konkret.

Sipas informacionit të Autoritetit të Dosjeve rezulton se ka patur edhe vendim për heqje nga rrjeti "sekret" të një bashkëpunëtori nga punëtori operativ Z.Loka.

Nga përmbajtja e Platformës Politike dhe Organizative të Sigurimit të Shtetit e vitit 1948, lidhur me "Aparatin e Sigurimit të Shtetit" kreun III, dhe kreun V "Funksionarët e Sigurimit të Shtetit" rezulton se sipas kreut III "Të gjitha organet e sigurimit të shtetit formojnë aparatet e sigurimit. Seksionet dhe Degët e Brendshme (Ana e Sigurimit) që punojnë në terren varen drejtpërdrejtë nga Drejtoria e Sigurimit të Shtetit e cila është organ i Ministrisë së Brendshme dhe e drejton Ministri i Brendshëm me anë të Zv. Ministrave për Sigurimin".

Në kreun V parashikohet se; "Funksionarë të Sigurimit quhen gjithë njerëzit e Sigurimit (Oficerë, N/oficerë, Nënpunësa) që kanë funksione legale në aparatet e sigurimit si në qendër edhe në bazë."

Nga ky përkufizim, del qartë se funksionarët janë persona që kanë qenë të emëruar për të kryer detyrat në strukturat e Sigurimit, në zbatim të detyrave që i ngarkonin aktet e kohës dhe për punën e tyre si struktura ligjore janë paguar konform ligjit të kohës.

Çmohet se termi "anëtar" ka të bëjë me cilësitë e funksionit /detyrës konkrete që ka pasur një funksionar në Sigurimin e Shtetit, duke e interpretuar rast pas rasti në kuadër të platformës së punës operative dhe mënyrës organizative, duke përcjellë me vendim të arsyetuar dhe shterues kolegjal nëse subjekti:

1. Rezulton me arsimim të kohës së ish-Sigurimit;
2. Ka pasur funksion përkatës zyrtar në Sigurimin e Shtetit dhe çdo akt tjetër të nevojshëm për efekt provueshmërie;
3. Çdo të dhënë tjetër që rezulton e vlefshme në sqarimin e pozicionit të subjektit në raport me organet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Mbi bazën e analizës së mësipërme, si dhe nga verifikimet e kryera deri tani; bazuar në nenin 10, nenin 26 e vijues të ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", ekzistojnë të gjitha kushtet që Autoriteti nëpërmjet vendimmarrjes së tij, të informojë Institucionin e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit mbi informacionin që kërkohet në shkresën Nr. *** prot., datë 25.06.2019, sipas objektit të kërkesës, të cilat përputhen dhe konvenojnë në frymën dhe qëllimin e Ligjit 45/2015, pa cënuar dhe kaluar caqet e informimit.

Sa më sipër dhe nga verifikimet e kryera deri tani, për kandidatin Z. Gjovalin Bardhok Loka, sipas kërkesës së paraqitur nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, në zbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit,

Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme"(i ndryshuar), sipas Ligjit nr. 45/2105"Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, rezultoi se :

1. *Nuk ka qenë Person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm;*
2. *Nuk ka qenë bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit;*
3. *Ka qenë me detyrë funksionale Punonjës Operativ, në strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit. Koha e ushtrimit të detyrës si Punonjës Operativ, nga data 29.01.1991 deri në datën 1 Qershor 1991. (Vlen të përmendet se, sipas nenit 2 të ligjit nr. 45/2015, merret në konsideratë vetëm periudha e ushtrimit të detyrës deri në datën 01.06.1991, pra në total 4-5 muaj) provuar me dokumentacionin përkatës.*

Analiza e trupës vlerësuese:

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, mori në konsideratë:

- Vendimin e Autoritetit të Dosjeve lidhur me informacionin përfshirë sqarimet dhe shpjegimet e dhëna sipas Ligjit organik 45/2015, mbi rezultatin e procesit të verifikimit të figurës së subjektit në këtë vendim,
- të dhënat në dosjen e punës së subjektit;
- deklaratimet në formularët e vetdeklarimit;
- shpjegimet e subjektit gjatë fazës së hetimit administrativ.

Komisioni konstaton se:

- Subjekti ka mbaruar Shkollën e Sigurimit me datë 30.6.1990 dhe ka qenë në dispozicion për periudhën nga 1 gusht 1990 deri në 16 janar 1991, datë në të cilën sipas të dhënave të shënuara në dosjen e punës së tij, është emëruar si punëtor operativ në Zonën Bicaj Kukës, në ish strukturën e Sigurimit të Shtetit.
- Sipas informacionit të Autoritetit të Dosjeve përcjellë me Vendimin nr.631, datë 8/10/2019, rezulton se shtetasi Gjovalin Loka ka marrë detyrën si punëtor operativ në Zonën Bicaj , Kukës, në datën 29/01/1991 – data e marrjes në dorëzim të dosjes dhe materialeve të dosjes nga pararendësi .
- Në formularët e vetdeklarimit të kontrollit të figurës dhe të aftësive profesionale për efekt të Ligjit të Vlerësimit, subjekti ka deklaruar se:
 - a) Në faqen 6 të formularit të kontrollit të figurës: Të dhëna për arsimimin dhe kualifikimet: 1.09.1986-30.6.1990, Shkolla e Lartë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Oficer i MPBr, Sauk, Tiranë.
 - b) Në faqen 11 të formularit të aftësive profesionale: Ka mbaruar shkollën e lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme nga dt.1.9.1986 deri më 30.6.1990.
- Në formularin Tip të aplikimit për efekt të verifikimit të subjektit nga ana e Autoritetit të Dosjeve me objekt informimin për zyrtarët përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta sipas ligjit 45/2015 “Për të drejtën e informimit me dokumentet e ish shërbimit të Sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë “(shih të skanuar më sipër Footnote 31) përcjellë Autoritetit të Dosjeve pasi është nënshkruar nga vet subjekti dhe dërguar pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit datë 03/07/2019, në seksionin “C” të këtij formulari: “Informacion shtesë për të dhëna ndihmëse për identifikimin e dokumentacionit arkivor, në pyetjen : “vendi i banimit/punës pas mbushjes së moshës 18 vjeç (para 2 korrikut 1991), subjekti ka deklaruar në përgjigjen e tretë (3) se : ka qenë i punësuar në Degën e Punëve të Brendshme Kukës”.
- Në shpjegimet e subjektit gjatë fazës së hetimit administrativ dhe pyetjeve të drejtuara nga relatorja e çështjes për të sqaruar pozicionin e tij, **subjekti është përgjigjur se:**

“Unë kam mbaruar studimet në Shkollën e Lartë e MPB, Dega "Sigurim", Shkollë e Lartë të M.P.Brendshme në 30/06/1990, konform rregullave dhe legjislacionit në fuqi të asaj kohe, duke plotësuar kriteret ligjore të kohës për arsimim.

Për këtë arsimim nuk duhet të jem i diskriminuar, kjo bazuar në nenin 17 dhe 18 të Kushtetutës së RSH, dhe në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Ju bëj me dije se, Shkolla e Lartë e MPB, ishte krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave, të Republikës Popullore të Shqipërisë, Nr.184 datë 20.12.1971 "Mbi Organizimin e Shkollës së Ministrisë të Punëve të Brendshme", dhe aktualisht kjo shkollë vazhdon aktivitetin e saj si Akademi e Sigurisë, pas proceseve reformuese që ndodhën në vitet 1990 në gjithë sistemin e lartë arsimor shqiptar dhe është e vetmja shkollë që përgatit oficerë të Policisë së Shtetit në RSH. Unë jam diplomuar në këtë shkollë në Qershor të vitit 1990, dhe jam titulluar "Oficer". Me Urdhër nr 654/10, datë 04.08.1990, jam vënë në dispozicion të Degës së Punëve të Brendshme Kukës. Kjo diplomë bazuar në pikën 2, të nenit 124, të Ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" është ekuivalente me diplomën "Master i shkencave".

Me Vendim të Rektoratit të Akademisë së Sigurisë është vendosur që studentët që kanë mbaruar këtë shkollë, barazohen me studentët që mbarojnë Akademinë e Sigurisë.

Dua të sqaroj se nga data 05.08.1990 deri me datë 16.01.1991 unë kam qënë në dispozicion të D.P.B. Kukës dhe nuk kam kryer asnjë lloj detyre, (bashkëlidhur do kenë dokumentin që vërteton këtë periudhë kohe kur kam qëndruar në dispozicion të Degës Punëve të Brendshme Kukës)".

Komisioni bazuar në faktet sa më sipër mban qëndrimin lidhur me përgjigjen e dhënë “ **jo**” në pyetjen 18 të formularit të kontrollit të figurës :

- Në interpretimin të pyetjes numër 18, të formularit të figurës për efekt të vlerësimit nga ana e Komisionit, (dorëzuar së bashku me dy deklaratat e tjera për verifikimin e pasurisë dhe profesionalit) kërkohet informacion për ata persona që kanë pasur cilësinë e anëtarit, bashkëpunëtorit ose të favorizuar nga ish – Sigurimi të Shtetit **para vitit 1990**.
- Siç rezulton e provuar nga të dhënat arkivore, statusi real i subjektit për këtë periudhë është qenia student deri në qershor të vitit 1990 dhe jo i emëruar në strukturat e Ish Sigurimit të Shtetit. Pra para vitit 1990 kur kërkohet edhe verifikimi, subjekti në fjalë ishte student ende pa përfunduar shkollimin. Është e evidente se në kontekstin për të cilin vet kufizimi ligjor jepet, përlllogarit apo përfshin ata individë që kanë qënë më funksione të anëtarit apo bashkëpunëtorit në periudhën kohore deri në 31 dhjetor 1989 (para vitit 1990). Në rastin në fjalë subjekti Gjovalin Loka deri në gusht të vitit 1990 ka qënë ende student në shkollën e Ish Sigurimit të Shtetit. Përgjigjia mohuese në këtë rubrikë në vlerësim të Komisionit, nuk mund të konsiderohet si fshehje e të dhënës apo si qëllim në vetvete për ta fshehur atë, pasi ajo është një përgjigje reale e statusit të tij në atë periudhë që e përcakton pyetjen lidhur me përfshirjen si anëtar, bashkëpunëtor në ish-Sigurimin e Shtetit para vitit 1990 dhe është e faktuar për shkak të qënies student para vitit 1990 se nuk ka ushtruar dhe nuk kishte se si të ushtronte funksione në ish Strukturat e Sigurimit të Shtetit para vitit 1990 ende pa u diplomuar. Siç dhe shpjeguar më lart, subjekti në formularin e depozituar në Autoritetin e Dosjeve i cili kërkon informacion për vendin e punës **pas moshës 18 vjeç dhe deri para Korrikut 1991**.

Nuk e ka fshehur faktin se ka qënë i punësuar në Degën e Punëve të Brendshme, Kukës. Ky formular është autentik dhe gjendet i depozituar zyrtarisht pranë këtij Autoriteti gjithashtu edhe pranë Komisionit.

Në këtë kuptim evidentohet qartazi se subjekti *prima facia* nuk ndodhet në kushtet e fshehjes së të dhënës sipas pyetjes në formularin e kontrollit të figurës.

Trupa e vlerësimit, **arrin në përfundimin** se subjekti i vlerësimit e ka plotësuar formularin për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi.

Nga ana tjetër, Komisioni nuk mund të mos e shohë në kontekstin e thelbit të Ligjit 45/2015 pra të ligjit kuadër që normon fushën e veprimit të ligjit, të informacionit për aktivitetin e ish punonjësve të Sigurimit të Shtetit dhe kush përfshihet në të. Në kontekstin e referimit të dispozitës sipas ligjit 45/2015, nuk mund të mos merret paragrafi dy i këtij ligji që përcakton kohën e përfundimit të Ish-Sigurimit të Shtetit deri në korrik të vitit 1991.

Në një kontekst edhe më të gjerë në raport me nivelin dhe rolin e Ish-Sigurimit të Shtetit në fund vitin 1990, vit në të cilin vet sistemi komunist dhe organet e tij kishin pësuar goditjen e tyre për shkak të krijimit të pluralizimit politik, (konkretisht sipas Ligjit Nr.10 242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, nenit 3 “Periudha e komunizmit” është periudha e historisë së Shqipërisë **nga 29 nëntori 1944 deri më 8 dhjetor 1990**) duke i dhënë analizë të plotë jo vetëm qëllimit në tërësi të dispozitës së Ligjit 12/2018(i ndryshuar), por edhe thelbit të Ligjit referues 45/2015, Komisioni nuk mund të mos merrte parasysh edhe kuptimin dhe mënyrën e zbatimit sipas këtij ligji duke ngritur për shkak të specifikës së rastit konkret (*tërësisë së angazhimit dhe kohën e këtij angazhimi*) disa pyetje :

- Sa ka qënë periudha e përfshirjes në këtë strukturë?
- Cilat kanë qënë funksionet dhe roli konkret i subjektit?
- Çfarë dosjesh dhe çfarë aktiviteti ka patur subjekti?
- A ka patur ndikim, rekrutim konkret personi në bashkëpunim?
- A ka patur ndonjë persekutim, dënim apo shkelje të të drejtës së njeriut, akte kundër jetës dhe shëndetit të individit, në kuptim të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe të legjislacionit penal si pasojë e aktivitetit që mund të ketë kryer subjekti në këtë strukturë?
- Sa ka qënë e qënësishme influenza, fuqia e zbatimit të ligjit të ish sigurimit të shtetit në vitin 1991, kohë kur ishte shpallur pluralizimi etj.?

Në të gjithë analizën e bërë nga Komisioni, nga dokumentacioni krahasues si dhe nga vet shpjegimet e hollësishme që ka dhënë vet subjekti lidhur me përfshirjen e tij në këtë strukturë:

“Nga data 16.01.1991 deri më 01.06.1991, jam emëruar punëtor operativ për Zonën Bicaç në Degën e Punëve të Brendëshme Kukës. Gjatë kësaj periudhe unë kam marrë në dorëzim dokumentacionin operativ që i takonte zonës një periudhe 1 mujore, sipas rregullave të kohës, por nuk kam arritur të kontaktoj me asnjë nga bashkëpunëtorët dhe paraardhësi im kishte patur në lidhje, pasi kishin filluar proceset demokratike, ishte shpallur pluralizmi politik në Shqipëri dhe ky rrjet ishte i terhëqur dhe nuk pranonte të bashkëpunonte më me Sigurimin, aq më tepër që personi që i kishte patur në lidhje ata po tranferohej dhe tek une s' kishin anjë lloj njohje apo besim.

Dua të theksoj se gjatë gjithë kësaj periudhe rreth 4.5 mujore (përfshi këtu dhe 1 muaj që ishte marrja në dorëzim e zonës dhe njohja me aktet normative), unë si punëtor operativ zone thjesht kam marrë në dorëzim dokumentacionin operativ nga paraardhësi im dhe kam firmosur në dosjet e kam marrë në dorëzim vetëm tek:

- lista e personave që njihen me dosien”

-Lista e personave që mbajnë dosjen

-Librin e Evidencës Operative (detyrim sipas akteve normative në fuqia) kur merrej në dorëzim një zonë nga punëtori operativ paraardhës.

Bazuar në urdhërin e ish Ministrisë të Brendshme të asaj kohe, në pak raste, kam përpiluar vetëm vendime arshivimi të dosjeve, pasi ishte dhënë urdhër që disa nga kategoritë e dosjeve që bënin fjalë për agjitacion e propagandë kundër shtetit dhe tentativë arratisje jashtë shtetit dhe disa tendenca të tjera, tashmë kishin rënë si vepra penale që ndiqeshin nga Sigurimi i Shtetit.

Unë nuk kam: Çelur, Ndjekur, Analizuar asnjë:

-Dosje përpunimi aktiv 2.A të subjektit,

-Dosje përpunimi paraprak 2.B të subjektit.

(Thjesht kam firmosur në dosjet që kam marrë në dorëzim, vetëm tek lista e personave që njihen me dosjen dhe lista e personave që mbajnë dosjen dhe kam përpiluar disa vendime arshivimi).

Kjo do të thotë, se nga puna ime si punëtor operativ i zonës nga data 16.01.1991 deri më 01.06.1991 nuk është: Dënuar Demaskuar ose Këshilluar asnjë shtetas shqiptarë.

Si dhe nuk kam: a) Çelur; b) Ndjekur asnjë:

-Dosje personale bashkëpunëtori.

-Dosje pune bashkëpunëtori. (Thjesht kam administruar këto dosje dhe firmosur në dosjet që kam marrë në dorëzim, vetëm tek lista e personave që njihen me dosjen, lista e personave që mbajnë dosjen dhe Librin e Evidencës Operative).

Nuk kam tërhequr në bashkëpunim asnjë person, si dhe marrë asnjë lloj informacioni nga bashkëpunëtorët (aq më tepër informacion që përbën dokument të ish-sigurimit të shtetit sipas kuptimit të pikës 5, të nenit 3, të Ligjit 45/2015), pasi me ndryshimin e sistemit ndryshuan dhe aktet ligjore dhe nënligjore që normonin punën e këtyre organeve dhe arsyeja përse ishin tërhequr në bashkëpunim këta persona kishte rënë, por dhe siç e kam theksuar dhe më lart, nuk kam arritur të kontaktoj asnjë nga bashkëpunëtorët që parardhësi im kishte patur në lidhje, pasi ky rrjet ishte i tërhequr dhe nuk pranonte të bashkëpunonte më me Sigurimin.

Gjithashtu ju bëj me dije se nuk kam evidentuar asnjë kontigjent për tendencat që ndiqte sigurimi në atë kohë, pasi me shpalljen e pluralizmit dhe fillimin e proceseve demokratike, ndryshuan aktet ligjore dhe nënligjore që normonin punën e këtyre organeve, rrjedhimisht dhe objekti i punës së këtyre strukturave.

Nga dita e parë e emërimit si punëtorë operativ zone, me datë 16.01.1991 dhe deri më 01.06.1991:

-Nuk kam prodhuar asnjë dokument në kuptimin e pikës 5, të nenit 3, të Ligjit 45/2015;

-Nuk kam asnjë veprimtari që lidhen me vepra penale politike të parashikuara në Ligjin 7514 datë 30.09.1991, “Për pafajësinë dhe amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve

politikë”(të ndryshuar), që mund të ketë shkaktuar qoftë edhe një viktimë të ish Sigurimit të Shtetit në kuptimin e nenit 2 të Ligjit 45/2015.

-Nuk kam qenë punojës i nivelit të lartë të ish-Sigurimit të Shtetit sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 30 të Ligjit 45/2015. "Për pafajësinë dhe amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", të ndryshuar (pasi unë kam qenë për 4.5 muaj punëtorë operativ Zone).

Regjistri i dosjeve, fashikujve dhe evidencat e punëtorëve operativ, Libër i evidencës operative të punëtorit operativ, janë regjistra të hapur nga DPB Kukës, nuk janë rregjistra të hapur dhe administruar nga ana ime, por nga oficerë të Sektorit të Katrotekës së DPB Kukës. Fakti se unë kam nënshkruar në to përbën thjesht një veprim tekniko — administrativ e procedural që ka të bëjë thjeshtë me marrjen në dorëzim të këtyre materialeve pasi punëtori operativ që e kishte pas zonën, po transferohej dhe atë zonë po e merrja unë dhe nuk ka asnjë lidhje me objektin e punës së ish-sigurimit të shtetit që ishte “Zbulimi, parandalimi dokumentimi dhe goditjen e veprimtarisë armiqësore” dhe si i tillë nuk është objekt i Ligjit 45/2015, sepse nuk përfshihet në fushën e veprimit të këtij ligji. Ju bej me dije se, investimi im arsimor e profesional nuk përfundoi me mbarimin e Shkollës së Lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, por vazhdoi dhe me:

-Përfundimin e studimeve niveli “Bacelor” dega Juridik në Universitetin Jo publik “Justicia”, aktualisht vazhdoj studimet master shkencorë Dega Juridik, në Universitetin Shtetërorë të Tiranës.

-Trajnime të shumta profesionale nga disa ditore në disa mujorë të kryera brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë karrieres profesionale në struktura të ndryshme të Policisë së Shtetit kam kryer me përkushtim e profesionalizëm të lartë çdo detyrë që më është besuar, në Policinë së Shtetit, duke u vlerësuar disa herë me stimuj moralë e materialë, për kontributin e dhënë për garantimin e rendit dhe sigurisë publike dhe luftën kundër krimit të organizuar, për të cilën gjatë karrierës sime në Policinë e Shtetit, më kanë vlerësuar duke më besuar drejtimin e tre komisariateve, tre Drejtorive Vendore të Policisë së Qarqeve, 3.5 vite si Drejtor i Rendit Publik dhe prej 2 vitesh si Drejtor i Departamentit për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Sa më sipër, pas disa vitesh karriere jetësore e profesionale në strukturat e Policisë së Shtetit, mua nuk mund të më atribohen gjetje apo cilësime në tejkalim të pikës 2 të nenit 29, dhe pikës 2 neni 30 të Ligjit 45/2015, pavarësisht studimeve të kryera në Shkollën e Lartë të Ministrisë së Brendshme në degën "Sigurim" dhe emërimit tim për një periudhë prej 4,5 muaj (16.01.1991 deri 01.06.1991),si punëtor operativ në DPB Kukës, gjykoj që Komisioni Juaj në vleresim përfundimtar duhet të udhëhiqet nga parimi i mosndëshkimit kolektiv dhe respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut”.

Për sa më sipër, Komisioni nuk u bazua vetëm në shpjegimet e subjektit dhe duke qenë se në vendimin e Autoritetit të Dosjes Nr.631, dt.8.10.2019, nuk ishte e qartë informacioni se si dhe sa ishte i përfshirë subjekti në aktivitetin e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe nuk kishte përcjellë bashkëlidhur dokumentacion arkivor, i kaloi barrë prove subjektit për ta faktuar me dokumentacionin arkivor pranë Autoritetit të Dosjeve se thëniet e tij ishin të vërtetueshme dhe të provuara me aktet e kohës.

Më datë 8/6/2020, Subjekti ka përcjellë pranë Komisionit, vendimin e dytë të Autoritetit të Dosjeve Nr.295, dt.5.6.2020, i cili u mor pas kërkesës së vet subjektit drejtuar Autoritetit me shkresën Nr. *** datë 3/6/2020, për vënie në dispozicion të dokumentacionit arkivor dhe interpretim të pikës 3 të

vendimit Nr.631, dt.8.10.2019, si dhe përgjigje disa pyetje të ngritura në relacionin e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit të cituara më lart.

Autoriteti i Dosjeve e ka gjetur të bazuar në ligj trajtimin e kërkesës individuale të shtetasit Gjovalin Loka pasi referuar në thelb, përmbajtjes së kërkesës si dhe parashikimeve ligjore, përbën detyrim për autoritetin publik të shprehet për të gjitha çështjet e ngritura dhe kërkimet e bëra.

Bazuar në këtë vendim të dytë **nr.295, dt.5.6.2020** Autoriteti i Dosjeve me vendim kolegjal të të katër anëtarëve të tij, **ka konkluduar se:**

Nga dokumentacioni arkivor në dispozicion dhe verifikimet e deritanishme,

-Nuk është gjetur asnjë dokument gjatë periudhës 29 Janar 1991-1 Qershor 1991 që të jetë hartuar dhe firmosur nga shtetasi Gjovalin Loka;

-Nuk rezulton të ketë rekrutuar bashkëpunëtorë;

-Nuk ka marrë info nga RSI;

-Nuk ka rregjistruar ndonjë kontigjent për llogari të Sigurimit;

-Nuk rezulton të ketë patur viktimë, të dënuar, arrestuar, këshilluar, dënuar, dëbuar apo internuar si pasojë e aktivitetit të tij

Për sa më sipër, Komisioni me qëllim vlerësimin e rrethanës së mësipërme në shqyrtimin përfundimtar të informacioneve të vëna në dispozicion nga Autoriteti i Dosjeve me dy vendimet e tij dhe, shpjegimet e dhëna nga subjekti edhe në seancë publike, mbajti në konsideratë edhe parimin e objektivitetit dhe propocionalitetit, mos ndëshkimit kolektiv dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut, mosndikimit të karakterit personal, të cilat mund të favorizojnë ose jo punonjësën, duke referuar edhe në aspekte të tjera ligjore si Ligji i Policisë së Shtetit 108/2014(i ndryshuar), aktet e tjera nënligjore specifike në fuqi.

Në seancën dëgjimore publike, subjekti përsëriti të njëjtat shpjegime që kishte dhënë më herët Trupës së Vlerësimit, duke ritheksuar edhe njëherë se Komisioni nuk duhej të paragjykonte profilin arsimor të tij edhe për më tepër se në ato pak muaj në vitin 1991 që u bë pjesë e strukturës së Ish Sigurimit të Shtetit, ai nuk kishte prodhuar asnjë dokument.

Komisioni thekson se Verifikimi i figurës së punonjësit realizohet nëpërmjet: verifikimit nëse ka qënë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit për të drejtën e informimit me dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Në ligjin 12/2018 (i ndryshuar), megjithëse parashikohet verifikimi i subjekteve të vlerësimit në kuadër të kontrollit të figurës pranë Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Ligji 12/2018 (i ndryshuar), nuk parashikon dispozitë ndaluese për rastet kur subjektet rezultojnë me cilësitë e anëtarit, bashkëpunëtorit apo të favorizuarit nga ish Sigurimi i Shtetit. Në këtë kuptim Ligji 12/2018 (i ndryshuar), e ka lënë në vlerësimin e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit trajtimin e rasteve kur ka informacione nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për subjektet e vlerësimit.

Në frymë dhe kuptim edhe të standartit të vendosur në Ligjin 12/2018 (i ndryshuar) pikërisht për kontrollin e figurës së subjektit por edhe në natyrën rekomanduese që mbart në vetvete kjo dispozitë, po ashtu edhe në natyrën informuese që ka për synim vet ligji organik për dosjet, duke qënë se nuk është i parashikueshëm në ligjin e vetingut (në fakt në asnjë nga ligjet) ndalesë absolute për një drejtues që mund të ketë qënë në strukturat e Ish-Sigurimit të Shtetit, por ky fakt do të merret në konsideratë dhe vlerësohet nga Komisioni në propocion dhe tërësi me aspekte të tjera të figurës së subjektit.

Siç dhe shpjegohet nga subjekti por dhe konfirmohet nga vet Autoriteti i Dosjeve, punësimi i tij në këtë strukturë ka qenë vetëm për një periudhë 4,5 muaj në vitin 1991 dhe subjekti ka qenë më tepër një emër në bordero dhe ku roli i tij nuk ka qenë aktiv por thjesht më shumë i orientuar në mbajtjen e dosjeve dhe marrjen në dorëzim të tyre nga pararadhësi i tij i cili ishte shkeputur nga struktura.

Komisioni sa më sipër, arrin të krijojë bindjen lidhur me këto përfundime të faktuara pas dy vendimeve të Autoritetit të Dosjeve, si dhe dokumentacionit arkivor të vënë në dispozicion nga vet subjekti, ky i fundit nuk mund të penalizohet *apriori* vetëm për këtë rrethanë të qënies së tij 30 vite më herët për një kohë shumë të shkurtër në një strukturë të një sistemi që ishte rrëzuar dhe pa asnjë funksion konkret aq sa për të rënduar pozitën e tij në vlerësimin negativ tërësor të figurës së tij të tillë që të çojë automatikisht dhe *apriori* shkarkimin nga detyra për shkak të mosarritjes së nivelit të besueshmërisë për qënien në një detyrë shumë afatshkurtër dhe pa prodhuar asnjë dokument që mund të ndikonte në çënim të jetës dhe të drejtës së qytetarëve.

Trupa e Vlerësimit çmoi vendimarrjen e saj në fund të seancës e cila u bazua në rezultatet për kontrollin e figurës së subjektit sipas nenit 38-42 të Ligjit të Vlerësimit 12/2018 (i ndryshuar), duke konkluduar në një vlerësim të përgjithshëm dhe tërësor të të gjitha rrethanave dhe fakteve që rezultojnë nga verifikimi i kryer për kontrollin e figurës.

2. Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit për subjektin e vlerësimit, janë kryer edhe veprimet e tjera përkatëse duke kërkuar të dhëna me anë të korrespondencave pranë këtyre institucioneve:

DSIK

SHISH

SHCBA

Prokurori e Përgjithshme (për tre aspekte të kontrollit lidhur me):

Çështjen e dekriminalizimit, bashkëpunimin në kuadër të Task Forcës, përgjigjet e kërkesës për procedime penale, në hetim apo masa /urdhra ndalimi ndërkombëtar)etj.

Polici e Shtetit

Avokati i Popullit

Sindikata e Policisë

Sistemi TIMS

Zyra e Gjëndjes Civile

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Nga DSIK, është administruar informacioni se subjekti është i pajisur me certifikatë sigurie për një periudhë 5 vjeçare niveli “Tepër sekret” nga datat 1/3/2016 deri më datë 28/2/2021.

Ky intitucion sqaron se SCP është lëshuar bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në verifikimin e sigurisë dërguar nga SHCBA në datë 4/12/2015 dhe se nga periudha e lëshimit të CSP deri më tani, në DSIK nuk është adresuar asnjë informacion implikues për Z.Gjovalin Loka, nga autoritete verifikuese apo institucione të tjera ligjzbatuese sipas të cilave do të ishte i nevojshëm rishikimi i vendimit të marrë për lëshim të CSP.

Nga Policia kriminale: rezultoi se për subjektin Gjovalin Loka dhe personat e tij të lidhur, nuk janë të rregjistruar për veprimtari kriminale.

- 🚩 Nga Sindikata e Policise: Në kthim përgjigje shkresë së drejtuar nga KJV nuk ka asnjë informacion konkret që të ketë të bëjë me ndonjë ankesë konkrete, drejtuar funksionarit në fjalë.
- 🚩 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve: Rezulton se subjekti nuk ka qenë i dënuar në territorin e Shqipërisë.
- 🚩 Nga Avokati i Popullit: Nuk ka të dhëna për ndonjë hetim administrativ të nisur apo ndonjë ankese e trajtuar në emrin e tij.
- 🚩 Nga Zyra e Gjndjes Civile: Vërtetohet se subjekti nuk ka ndërruar gjeneralitetit.
- 🚩 Nga sistemi TIMS: Nuk ka rezultuar se lëvizjet e tij në intervale të caktuara kohore janë bërë me persona të papërshtatshëm. Subjekti ka shfaqur transparencë kur ka vënë në dispozicion në deklaratën vetting një fletë print të statement që vërteton veprimet e tij në kufi çdo here që ka lëvizuar dhe me cilin automjet ka lëvizur. Këto lëvizje kanë rezultuar të verifikueshme edhe nga kërkimi në sitetimin TIMS nga KJV. Ky i fundit, verifikoi të gjitha targat me të cilat kishte hyrë dhe dalë në pikat e ndryshme kufitare subjekti dhe personat e lidhur me të. Rezultoi se asnjë nga personat me të cilët kishte udhëtuar kishin ndonjë të dhënë që të përbëjë papërshtatshmëri në kontaktet e subjektit me ta.
- 🚩 Pranë Komisionit nuk janë paraqitur denoncime nga publiku për shkelje të rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës policie.
- 🚩 Nga Prokuroria e Përgjithshme janë administruar 4 (katër) kategori korrespondencash pasi Trupa e KJV ka kryer një hetim të avancuar dhe të gjithanshëm e sa më të plotë për subjektin Loka si më poshtë :

1.Korrespondenca e parë³², ka të bëjë me përgjigjet e listës emërore të subjekteve të shortuara ku për subjektin në fjalë nga të gjitha Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Rretheve, të Apelit të rretheve, të Krimeve të Renda Shkalla e I dhe II-të, bazuar në kërkesat e KJV, rezultuan negative për subjektin.

3.Korrespondenca e dytë,³³është administruar bazuar në kërkesën specifike të trupës lidhur me bashkëpunimin e drejtuesit me Prokurorët dhe Prokuroritë e Rretheve gjatë eksperiencës në kuadër të operacioneve të përshkëta dhe ushtrimit të kompetencave dhe kordinimit institucional në kuadër të Task Forcës.

Edhe nga këto, përgjigjet rezultuan se nuk ka patur të dhëna konkrete për veprime të koordinimit pasi nuk ka patur të tilla, ose përgjigjet kanë qenë të përgjithshme për drejtuesit e policisë më të cilët përgjithësisht organi i Prokurorisë ka bashkëvepruar dhe koordinuar veprimet procedurale për çdo rast specifik.

4.Korrespondenca e tretë,³⁴rezulton pas kërkesës së KJV për verifikim në kuadër zbatimit të Ligjit të Dekriminalizimit 138/2015 dhe Vendimit të Kuvendit 17/2016. Ky verifikim është kërkuar bazuar në kërkesën ligjore të Ligjit 12/2018(i ndryshuar) neni 38, pika 1 e tij sipas të cilit, në vlerësimin e rrethaneve për kontrollin e figurës, trupat e Komisionit, mbajnë në konsideratë ndër të tjera edhe verifikimin e procedimeve penale dhe administrative ndaj punonjësit, brenda dhe jashtë vendit, sipas

³² Shkresë Nr.***, dt.23/9/2019 nga Prokuroria e Përgjithshme

³³ Shkresë Nr.*** dt.5/12/2019 nga Prokuroria e Përgjithshme

³⁴ Shkresë Nr.***, datë 29/10/ 2019 nga Prokuroria e Përgjithshme

përcaktimeve të ligjit për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike.

Për këtë, Komisioni fillimisht bashkëpunoi me Policinë e Shtetit për vendosjen e formularëve të dekriminalizimit të plotësuar nga punonjësit e policisë në kuadër të zbatimit të Ligjit 138/2015 dhe që sipas rregullave dhe procedurave që detajon ligji dhe vendimi për zbatimin e tij, gjenden të depozituara pranë titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Me tej, pas vënies në dispozicion të këtyre formularëve të plotësuar dhe nënshkruar nga këta punonjës, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme, konkludua për këto veprime institucionale:

Komisioni, fillimisht u njoh dhe verifikoi formularin me të dhënat e raportuara në të. Nga verifikimi i këtij formulari, rezultoi se subjekti nuk ka raportuar ndonjë të dhënë për të cilën duhej të fillonte verifikimi i thelluar sipas kritereve dhe kushteve të Ligjit 138/2015.

Ky verifikim i subjektit kërkohet jo vetëm në zbatim të detyrimit të Ligjit të posaçëm 12/2018 për Vetingun e Policisë së Shtetit (i ndryshuar). Edhe në këtë formular, nuk ka të dhëna të plotësuara në rubrikat përkatëse apo indicie që gjatë hetimit të kryer deri më tani, të evidentohen nga Komisioni për t'u thelluar si verifikim i ndonjë të dhëne të mundshme. Në këtë kontekst, veprimet e Komisionit janë ndjekur edhe duke iu referuar bashkëpunimit të ngushtë me Prokurorinë e Përgjithshme e cila ka orientuar në shkresën e saj me Nr. ***, datë 9/10/2019, përcjellë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit nga Prokurorja e Përgjithshme, për sa më poshtë :

“Përfshirja në verifikim sipas Ligjit 138/2015 do të ndërmerret vetëm nëse ka nevojë për verifikim të thelluar për shkak se mund të rezultojë që ka indicie mbi bazën e një kërkesë ose kryesisht kur kanë të dhëna apo fakte përfshirë edhe ato të njohura botërisht për një të kaluar kriminale, si dhe për rastet kur personat kanë deklaruar të dhëna për të kaluarën e tyre kriminale, por organi përgjegjës vlerëson se duhet përcjellë për të verifikuar saktësinë e deklarimeve.

*Pavarësisht se për sa më lart, rezulton se deri më tani të mos ketë rrethana, ngjarje apo të dhëna/indicie për të cilat të diponohen infomacione në ngarkim të subjektit dhe për të cilin duhen nisur hetime të thelluara nga organet ligjzbatuese, në vijim të kërkesës së nisur nga Komisioni dhe koordinimit më Prokurorinë e Përgjithshme”, Komisioni është informuar nga PP (përkatësisht Drejtoria e Gjendjes Gjyqësore) me Nr.***, datë 25/10/2019, protokulluar me tonën Nr.***, datë 29/10/2019, ku rezulton se ka një rregjistrim penal Nr.***, datë 13/6/2016 bazuar në kallëzimin e shtetases A.B për të cilën ka vendim të Prokurorit të çështjes, pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Tiranë për “Mosfillim të procedimit penal me Nr.***, datë 12/7/2016”.*

Komisioni konstatoi se pavarësisht se prokurori i çështjes në fjalë ka arsyetuar se nuk janë vërtetuar konsumimi i elementëve të veprës penale të pretenduar nga shtetësja A.B, pasi prania e rrethanave të ngjarjes dhe fakti i ndodhur nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, nuk ka patur asnjë qëllim, dashje apo motiv për të dëmtuar interesat e shtetases ndaj të cilës kishte në ngarkim një çështje penale për keqtrajtim të të miturve dhe ishte në shqyrtim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier. Por pavarësisht këtij vendimi të prokurorit, ky fakt duke qënë se në vlerësimin e tij ka të bëjë me mospërmbushjen e rregullt të detyrës për shkak të pakujdesisë sidomos nga punonjësi i Drejtorisë së Rendit Publik, i cili

ka konceptuar shkresën në kundërshtim nga sa urdhërohet nga Gjykata e Rrethit Fier, si të tillë këto veprime duhet t'i nënshtrohen një procesi të rregullt hetimi disiplinor.

Sa më sipër, trupa vlerësuese e Komisionit, për të ndjekur parimin e objektivitetit dhe transparencës, ka kërkuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, praktikën e hetimit disiplinor, nëse do të kishte nisur nga Drejtoria e Policisë së Shtetit bazuar në urdhërimet e prokurorit të çështjes.

Nga praktika e venë në dispozicion të trupës së KJV, rezulton se:

-Ka patur praktikë të nisjes së procesit të hetimit/kontrollit nga specialistë të rendit publik autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm për Sigurinë në Strukturat e Rendit dhe të Sigurisë Publike në drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe Komisarariatit të Policisë Nr.6, urdhëruar nga Drejtori i Përgjithshëm për Sigurinë Publike Drejtues i Lartë A.Q.

-Ka patur ankesë nga vet shtetësja me pretendimin për shoqërim të detyrueshëm (të kundërligjshëm) në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku shqyrtohej çështja në ngarkim të kësaj shtetase.

-Ka patur informacion të detajuar nga grupi i inspektimit në Drejtorinë e Rendit Publik për verifikimin dhe trajtimin e rastit të shoqërimit forcërisht të shtetases nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Nr.6, si dhe kqyrje të dokumenteve, urdhrave, rregjistrave, formularëve dhe proces-verbaleve që faktojnë veprimet e kryera nga këta të fundit.

- Ka patur komunikim përmes korrespondencës zyrtare dhe asaj elektronike zyrtare midis vet Drejtuesit të Drejtorisë së Rendit Publik në atë kohë, subjektit të vlerësimit Z.Gjovalin Loka dhe shtetases (kallëzueses) ku Z.Loka i ka kërkuar ndjesë dy herë (edhe para depozitimit të kallëzimit penal të kësaj të fundit) për lapsusin e bërë nga ana e tij (në këtë rast siglimi i shkresës së konceptuar nga vartësi i tij për shoqërimin e shtetases në Gjykatë).

-Ka patur një informacion mbi analizën e kërkesës së shtetases datë 30/5/2016 drejtuar Drejtorit të Drejtorisë së Rendit Publik, subjektit të vlerësimit Z. Gjovalin Loka, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Departmentit për Sigurinë Publike (eprorit të tij).

Në këtë informacion subjekti i vlerësimit detajon veprimet dhe analizën që ka kryer në drejtorinë e tij për shqyrtimin e rastit konkret. Diskutimet dhe përgjegjësitë e secilit për rastin duke filluar nga vet subjekti i cili pranon se në rutinë të firmosjes së shkresave, nuk i ka dhënë rëndësi edhe për faktin se përpiluesi i kësaj shkrese ishte një punonjës me përvojë dhe që nuk mund t'i falej një neglizhencë apo lapsus i tij. Edhe përpiluesi ka pranuar përgjegjësinë për këtë gabim njerëzor duke u shprehur dakort për masën që do të merrej për të.

-Në fund, subjekti i ka kërkuar eprorit të tij se do të mirëpresë çdo lloj mase që do të gjykohej nga ana e tij për këtë rast.

-Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm është rekomanduar që ky rast le të shërbejë për të qënë më të kujdesshëm në të ardhmen.

-Në përfundim, në reflektim të këtij shqyrtimi tërësor të rastit më të gjithë personat përgjegjës që nga hartimi, siglimi i shkresës, njoftimi i saj dhe shoqërimi i shtetases, vet subjekti, në atë kohë Drejtor i Rendit Publik, për veprimet dhe mosveprimet e kryera nga ana e tij dhe punonjësit e tjerë të policisë është vendosur:

“Drejtues i Parë, Gj.Loka për neglizhencë në kontrollin dhe nëshkrimin pa studiuar, të një shkresë që solli shoqërimin e detyrueshëm të shtetases A.B., bazuar në nenin 237 të Rregullores së Policisë së Shtetit miratuar me VKM 750, dt.16.9.2015 , t’i jepet masa paralajmëruese “tërheqje vemendje”.

Kryekomisari B.D me detyrë Specialsit në Drejtorinë e Rendit Publik për mungesë korrektësie në përpilimin dhe hartimin e shkresës që solli shoqërimin e detyrueshëm të shtetases A.B, t’i jepet masa paralajmëruese “tërheqje vemendje”.

Edhe më shkresën e Drejtorisë së Përgjithshëm të Sugurisë Publike, drejtuar DVP Tiranë është propozuar:

“Dhënie masë disiplinore e lehtë tre punonjësve të Seksionit të Policimit në Komunitet në Komsiratiatin e Policisë Nr.6 Tiranë”.

E gjithë kjo praktikë i është bërë më dije edhe vet shtetases A.B., nga subjekti i vlerësimit që e ka vënë në dijeni për masat e marra duke i kërkuar edhe njëherë ndjesë personale dhe zyrtare duke i garantuar se ka qenë thjesht një gabim njerëzor dhe asgjë më tepër.

Në referim të Rregullores së Policisë së Shtetit Nr.750/2015, bazuar në nenin 237 “Masat parandaluese dhe disiplinore” për punonjësit e policisë :

Parashikohen si masa parandaluese masat: *Këshillim dhe tërheqje vëmëndje e procedimit disiplinor*, të cilën trupa do ta trajtojë më pas në këtë vendim në pjesën e vlerësimit të aftësisë profesionale. Këto janë masa/veprime që kryhen nga drejtuesit e të gjitha niveleve me synim korrigjimin e mangësive të konstatuara gjatë veprimtarisë së përditshme të punonjësit të policisë, pa përdorur procesin e ecurisë disiplinore. Këto mund të jepen para fillimit të ecurisë disiplinore ose në rastet kur pas verifikimit të shkeljes së konstatuar, eprori argumenton me shkrim arsyet e mosndëshkimit të personit me masë disiplinore.

Nga korrespondencat me (institucion ligjzbatues) Komisioni është njohur me disa informacione të klasifikuara sekret.

1. Fillimisht ky Institucion ligjzbatues, me shkresën Nr.*** prot., datë 16/07/2019, niveli i klasifikimit “Konfidencial”, afat ruajtje 10 vjet, informon se pas verifikimeve të kryera, për subjektin e vlerësimit Z. Gjovalin Bardhok Loka, dhe personat e lidhur bazuar në çertifikatën familjare, nuk disponohen të dhëna/materiale referuese/procedime penale në ngarkim të tyre.
2. Institucioni ligjzbatues me shkresën Nr.*** prot., datë 3/9/2019, niveli i shkresës ”Sekret” afat i ruajtjes 10 vjet, në kthim përgjigje shkresës së KJV e cila me herët i kishte kërkuar informacion të thelluar duke marrë shkak nga të dhënat e referuara nga një institucion tjetër ligjzbatues, për një informacion që datonte në vitin 2003, ku shprehet se: *”Ky informacion ka qenë në administrim në arkivën e Kartotekës dhe me gjithë punën e kryer në zbatim të kompetencave ligjore e profesionale të institucionit të asaj periudhe, nuk është bërë i mundur vërtetimi ligjor i tyre. Institucioni sqaron se në bazë të aftit të ruajtjes dhe të klasifikimit të dokumentacionit si dhe duke qënë se nuk është vërtetuar dot indicia, këto materiale janë çuar për asgjësim”.*
3. Institucioni ligjzbatues, me shkresën Nr.*** prot., datë 23/09/2019, niveli i klasifikimit “Sekret”, afati i ruajtjes 10 vjet, pas korrespondencave vijuese me KJV, vë në dispozicion të saj të gjithë praktikën e gjendur ndër vite në Kartotekën e institucionit si më poshtë :

-Informacione të vitit 2002-2003, që referojnë nga ky institucion për drejtuesin Gjovalin Loka, në atë periudhë në funksionin e Drejtorit të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, për dyshime se implikohej apo në favorizime të kontratës së naftës nga persona të tjerë.

-Informacione që referon përsëri për subjektin Gjovalin Loka në vitin 2003, në atë kohë Drejtor i Drejtorisë së Policisë së Qarkut Lezhë, i cili ndër të tjera përmendet për favorizime, emërimë punonjësish në rradhët e policisë, për të cilët nga materialet investiguese dhe operative të institucionit përkatës, dyshohen se janë të implikuar në veprimtari të paligjshme.

Për të gjitha këto informacione që rezultojnë në kartoketën e institucionit ligjzbatues, kanë përfundime të natyrës: *“Materialet nuk kanë vijueshmëri, nuk janë sqaruar/thelluar dhe vërtetuar më tej”*.

Këto informacione që datojnë në periudhë para 15 viteve, të vëna në dispozicion Komisionit, janë analizuar me kujdes në raport me ligjin përkatës të informacionit sekret, si dhe në konkludimet e institucionit verifikues ligjzbatues që ka përcjellë këto informacione.

Nga ana tjetër, këto të dhëna janë bërë edhe objekt i shqyrtimi gjyqësor, pasi subjekti ka zhvilluar një proces të gjatë gjyqësor me Ministrinë e Brendshme, që prej daljes së aktit administrativ të Ministrit të kohës Nr. 40/1, dt.14/02/2014 që e përjashtonte atë nga rradhët e policisë me akuza të renda të shkeljeve të ligjit të Policisë së Shtetit.

Për këtë, Trupa Vlerësuese ka kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të gjithë kronologjinë dhe fashikujt e proceseve gjyqësore që kishin lidhje me subjektin në fjalë.

Nga administrimi i të gjithë praktikës dhe procesit gjyqësor të ndjekur që prej vitit 2004 deri në datën kur vendimi mori formë të prerë gjyqësisht, rezultojnë se të gjitha pretendimet e ngritura në lidhje me subjektin, i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe në përfundim të të gjitha procedurave ligjore të shkallëve ankimore, pas 5 vendime gjyqësore³⁵, vendimi ka marrë formë të prerë gjyqësisht

³⁵ *Konkretisht: 1-* Me vendimin Nr.3932, datë 26.07.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur: “Pranimi pjesërisht i padisë; Anullimin e aktit administrativ, Urdhrit nr. 40/1, datë 14.01.2004, të Ministrit të Rendit Publik për përjashtimin nga Policia e Shtetit të paditësit Gjovalin Loka me gradën “Komisar”

2.-Kundër këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë e cila kjo gjykate me vendimin Nr.1181, dt./26.10.2004, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

3.- Kundër vendimit të lartcitur të Gjykatës së Apelit, pala e paditur Ministria e Brendshme ka bërë ankim në Gjykatën e Lartë e cila me vendimin Nr.1490, datë 27.10.2005 ka vendosur: Prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim po kësaj gjykate, por me tjetër trup gjykues, duke orientuar Gjykatën e Apelit për gjykimin e çështjes mbi bazën e parimit të kontradiktorialitetit, duhet të lejojë palët të paraqesin prova dhe provojnë pretendimet e tyre. Duke bërë një hetim tërësor gjyqësor të provave që nuk janë hetuar në gjykimet që i përkasin vendimeve Nr.3932, datë 26.07.2004 dhe Nr.1181, datë 26.10.2004 të gjykatës së Faktit dhe të Apelit. Duke qënë se objekti dhe shkaqet që pretendohen nga pala e paditur Ministria e Brendshme kanë qënë një sërë dokumentesh që sipas ligjit përbënin sekret shtetëror dhe këto nuk ishin shqyrtuar në gjykatat e faktit dhe apelit, Gjykata e Lartë vendosi që të dyja palët të paraqesin hollësisht detajet e provave për secilin rast.

4.-Kjo Gjykatë e Apelit e cila ka marrë çështjen përsëri në shqyrtim por me një trup tjetër gjykues, ka marrë Vendim Nr.946, datë 15.09.2006 duke lënë në fuqi vendimin Nr.3932, dt.26.7.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e cila anulonte tërësisht si të pabazuar urdhrin e përjashtimit nga Policia e Shtetit të paditësit/subjektit Gjovalin Loka me gradën “Komisar”.

5.-Kundër këtij vendimi është bërë Rekurs në Gjykatën e Lartë e cila me Vendimin Nr.1338, dt.16.11.2007 kjo Gjykatë ka vendosur “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur Ministria e Rendit Publik “ duke e bërë përfundimisht këtë gjykim të formës së prerë.

nëpërmjet të cilit është shpallur **“Anullimi i aktit administrativ të vitit 2004 për përjashtimin nga detyra” si të paligjshëm.**

Rezulton gjithashtu se subjekti ka vijuar gjyqësisht kërkimin e kompensimit financiar të tij për shkak të vendimit të padrejtë dhe të paligjshëm të shpallur tashmë nga Gjykatat duke bazuar kërkesën e tij legjitime sipas Kushtetutës³⁶ dhe ligjit, dëmshpërblimin për pasojat që i kanë shkaktuar gjatë kësaj periudhe nga një vendim i paligjshëm.

Kështu janë dhënë 5 vendime gjykatash³⁷ në të tre shkallët e gjyqësorit të cilat në përfundim kanë dëmshpërblyer subjektin për aktin e paligjshëm të ndërmarrë nga Ministria e Brendshme në vitin

³⁶ “pala që dëmtohet nga një pushim i padrejtë nga puna gëzon të drejtën e dëmshpërblimit në rregull gjyqësor pasi e drejta e dëmshpërblimit është një e drejtë që gëzon mbrojtje. Një konkluzion i tillë del nga neni 44 i Kushtetutës sipas të cilit: Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdemtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të Organeve shtetërore. Në ligjin “Për Policinë e Shtetit” thuhet: “Dëmi material i shkaktuar zhdëmtohet sipas akteve normative përkatëse” (neni 29/2). “Shpërblimi i demit duhet të jetë i tillë që ta vendos të dëmtuarin në atë gjendje pasurore që do të ishte po të mos ishte larguar nga rradhet e policisë. Pagat e humbura ose të pakësuara duhet të shpërblehen. Në këto raste dëmshpërblimi sipas këtij qëndrimi duhet të jetë real, i llogaritshëm me pagat e humbura dhe gjithë përfitimet e tjera, të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi, si pasojë e aktit të paligjshëm për largimin nga radhet e Policisë së Shtetit”.

³⁷ Konkretisht :

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.5495, datë 11.07.2007, ka vendosur:
 -) Pranimin pjesërisht të padisë.Detyrimin e palës së paditur Ministria e Brendshme t'i paguajë paditësit Gjovalin Loka pagat bazë dhe shtesat mbi pagë sipas pagës për gradën “Komisar” për periudhën e papaguar të dispozicionit që nga data 27.08.2003 deri më datë 14.01.2004.
 -) Detyrimin e palës së paditur Ministria e Brendshme t'i paguajë paditësit Gjovalin Loka pagat bazë dhe shtesat mbi pagë sipas pagës për gradën “Komisar”, për periudhën që pas datës 14.01.2004 e në vazhdim, deri në ekzekutimin e vendimit.Detyrimin e palës së paditur Ministria e Brendshme t'i njohë paditësit Gjovalin Loka si vjetërsi në punë dhe vjetërsi në gradën “Komisar” për periudhën nga data 14.01.2004 e në vazhdim.
 -) Detyrimin e palës së paditur Ministria e Brendshme t'i japë paditësit Gjovalin Loka përfitimet në veshje. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.
2. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e saj Nr.1198, datë 19.06.2008. Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur rekurs pala e paditur e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi.
3. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin Nr.1278 datë 21.03.2013 ka vendosur: “Prishjen e vendimit Nr.1198, datë 19.06.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues”. Ky kolegji ka arsyetuar se: Në gjykimin e çështjes, nga gjykatat e faktit, është zbatuar gabim Ligji nr.8553, datë 25.11.1999 “Per Policinë e Shtetit”(i ndryshuar), përta i përket dëmshpërblimit që mund të kërkojë paditësi, për shkak të përjashtimit të tij nga Policia e Shtetit. Meqenëse me vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është arritur në përfundimin se përjashtimi i paditësit nga Policia e Shtetit është bërë pa shkaqe të përligjura, atëherë, në këtë gjykim, duhet vetëm të llogaritet shpërblimi i plotë i demit të shkaktuar paditësit, nga përjashtimi i padrejtë i tij nga Policia e duke qenë se në ligjin e posaçëm, nuk parashikohet shprehimisht mënyra e llogaritjes së shpërblimit të demit të shkaktuar paditësit, ai do të llogaritet sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Punës.
4. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin Nr.245 datë 19.02.2014 ka vendosur :
 -) Ndryshimin e vendimit Nr. 5495 datë 11.07.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, “Pranimin e pjesëshëm të padisë të paditësit Gjovalin Loka
 -) Detyrimin e palës së paditur Ministria e Punëve të Brendshme t'i paguajë paditësit Gjovalin Loka, pagën bazë, shtesat mbi pagë sipas pagës për gradën “Komisar” për periudhën 27.08.2003 deri në datën 14.01.2004. Detyrimin e palës së paditur Ministria e Brendshme t'i paguajë paditësit Gjovalin Loka pagën bazë, shtesat mbi pagë sipas pagës për gradën “Komisar” për periudhën 1 vit si dëmshpërblim për ndërprerjen e menjëhershme të marrdhenieve të punës pa shkaqe të justifikuara.Ky vendim është i ekzekutueshëm nga shërbimi përmbartimor gjyqësor”.Kundër këtij vendimi, ka paraqitur rekurs pala e paditur Ministria e Punëve të Brendshme e cila ka kërkuar Prishjen e Vendimit Nr.5495 datë 11.07.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Vendimit Nr.245 datë 19.02.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, parashtuar shkaqet e mëposhtme:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me Vendimin 2293 dt.26.5.2016 ka vendosur : Mospranimin e rekursit të paraqitur pala e paditur Ministria e Punëve të Brendshme. kundër Vendimit nr.245 datë 19.02.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Pra ka mbetur në fuqi vendimi Nr. 245 dt.19.2.2014 i Gjykatës së Apelit Administrativ, me demshpërblimin deri në një vit pagë të paditësit në gradën “Komisar” si dhe periudhën e dispozicionit që prej datës 27.8.2003 deri në dt.14.1.2004 kur u përjashtua përfundimisht nga rradhët e policisë me urdhër të Ministrisë të Rendit Publik.

2004, ku subjekti ka përfituar edhe një shumë deri në 1.111.000 (një milion e njëqind e njëmbëdhjetë mijë) lek kjo e vërtetuar edhe nga vërtetimi bankar që përputhen edhe me deklaratimet e subjektit në deklaratën e pasurisë në ILDKPKI për vitin 2014.

Në aspektin e figurës së subjektit, i gjithë ky proces ligjor ka përfunduar në favor të subjektit si dhe dokumentet sekrete i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, ndërkohë që vet institucioni që i administronte i ka deklasifikuar ato, jo vetëm për kalimin e afatit të ruajtjes së tyre por edhe për mos arritjen e konkluzioneve konkrete mbi to për të vërtetuar ekzistencën e provuar të tyre.

TESTI PSIKOLOGJIK I PERSONALITETIT:

Në datën 15/05/2020 subjekti i është nënshtruar vlerësimit psikologjik bazuar në Ligjin 12/2018 (i ndryshuar), neni 38/2. Në përfundim të raportit të vlerësimit psikologjik, të miratuar me Nr.***, datë 27/05/2020, është arritur në konkluzionin se subjekti Gjovalin Loka:

“Aktualisht nuk shfaq probleme të shëndetit mendor të cilat mund të dëmtojnë funksionimin e përditshëm të tij. Shfaq aftësi të mira në marrëdhëniet personale dhe ndërpersonale. Subjekti paraqet funksionim të mirë ditor dhe tipare të një personaliteti të qëndrueshëm , të cilat bëjnë të mundur arritje të kënaqshme në të gjitha fushat e jetës”.

Në përfundim të hetimit të kontrollit të figurës :

Komisioni ka mbajtur në konsideratë standartet e kontrollit të figurës duke vlerësuar atë në mënyrë objektive dhe pa ndikime të karakterit personal, të cilat mund të favorizojnë ose jo subjektin.

Trupa vlerësoi të gjitha provat, faktet, deklaratimet apo mosdeklaratimet, shpjegimet e subjektit dhe interpretimet ligjore të institucioneve përgjegjës që administrojnë të dhënat, vendimet e formës së prerë të gjykatave në vend, objektin e veprimtarisë së tyre dhe shkallën e hetimit/shqyrtimit nga ana e tyre sipas legjislacionit të kohës dhe atij aktual në fuqi.

❖ Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me Ligjin nr. 12/2018(i ndryshuar) konstatohet se subjekti;

- a) ka plotësuar formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;
- b) nuk ka informacion në deklarin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në veprimtari kriminale.

C. VLERËSIMI I AFTËSISË PROFESIONALE

Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e vlerësimit, është kryer në përputhje me kreun V, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të Ligjit nr.12/2018 (i ndryshuar), bazuar në nenet 43 – 46 të tij.

-Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale sipas përcaktimit të nenit 43 të këtij ligji, ka të bëjë me vlerësimin e nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, respektimin e rregullave të etikës, si dhe përmbushjes së detyrave nga subjekti në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e Policisë së Shtetit.

-Procedura për vlerësimin e aftësive profesionale kryhet bazuar në nenet 44-46 duke mbajtur në vëmendje aftësitë profesionale dhe ecurinë në karrierë të punonjësit duke respektuar legjislacionin e posaçëm që rregullon marrëdhënien e punës (në këtë rast ligji për Policinë e Shtetit, Rregullorja e Policisë dhe aktet e tjera rregullatore e nënligjore në fuqi) si dhe në përshkrimet e punës për çdo funksion.

➤ Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit përdor si burime për vlerësimin e tij, fillimisht :

-Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, Ligjit 12/2018;

-Të dhënat nga institucionet përgjegjëse që konfirmojnë nivelin arsimor dhe kualifikimet përkatëse, ecurinë në karrierë të subjektit nga dosja e personelit dhe nga vërtetime e akte të tjera administrative të emerimeve në funksione dhe dhënies së gradave respektive, ecurinë disiplinore, vendimet e formës së prerë të gjykatave që lidhen me procese disiplinore etj;

-Më tej dokumentet e përgatitura nga punonjësi sipas nivelit respektiv menaxherial apo/ose operacional;

-Vlerësimet e punës individuale në tre vitet e fundit.

Gjithashtu, trupa e vlerësimit mban në konsideratë dhe shqyrton edhe denoncimet nga publiku për sjellje jo profesionale të punonjësit, apo informacione të tjera të lidhura me ushtrimin e detyrës së tij në mënyrë joetike.

❖ Afati kohor brenda të cilit shtrihet procesi i vlerësimit të aftësive profesionale:

Subjekti i vlerësimit kalimtar, Gjovalin Loka, më datë 4/5/2018, ka dorëzuar në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, (*formularin e vetëvlerësimit të aftësive profesionale*), sipas përcaktimeve të 44 pika 1, të Ligjit Nr. 12/2018, (*brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit*).

Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 7 vjet.

Subjekti në kohën e depozitimit të formularit, mbante detyrën e Drejtorit të Departamentit të Sigurisë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, funksion që e mban dhe aktualisht.

Për të vlerësuar aftësinë profesionale për subjektin e vlerësimit, KJV ka kryer veprimet duke kërkuar të dhëna pranë këtyre institucioneve:

🚩 Drejtoria e Standarteve Profesionale në Policinë e Shtetit;

🚩 Avokati i Popullit;

🚩 Drejtoritë arsimore dhe Ministrisë së Arsimit si dhe Akademisë;

- 🇫🇩 Akademisë së Sigurisë;
- 🇫🇩 Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave;
- 🇫🇩 Universitetit të Drejtësisë ;
- 🇫🇩 Prokurorive pranë rretheve për efekt të kordinimit dhe bashkëpunimit si institucione ligjzbatuese;
- 🇫🇩 Gjykatave (në rastet e proceseve gjyqësore të inicuar për masat disiplinore)

❖ **Vlerësimi i Nivelit arsimor:**

Në formularin e vetvlerësimit profesional, subjekti deklaron :

1. 01/09/1981-30/06/1985, Shkolla e Mesme Ekonomike, Lezhë, dega “Ekonomist i Mesëm”;
2. 01/09/1986-30/06/1990, Shkolla e Lartë e Ministrisë së Punëve të Brendshme 4 vjeçare e kryer ne Sauk, Tirane, Titulluar “Oficer i Ministrisë së Punëve të Brendshme”;
3. 01/10/2010-30/06/2013 Shkolla e Lartë Jopublike “Justicia”, Tiranë, Bachelor në Drejtësi

❖ **HETIMI NGA TRUPA E KOMISIONIT:**

Për të vërtetuar deklaratimet e subjektit lidhur me arsimimin, verifikoi të dhënat sa më lart si nga institucionet arsimore, të Akademisë së Sigurisë ashtu dhe të tjera arkivore, si dhe referuar dosjes së personelit e vënë në dispozicion nga DPPSH, nga ku rezultoi se:

Konfirmohen nga institucionet arsimore dhe të tjera të policisë, deklaratimet e subjektit Gjovalin Loka lidhur me nivelin arsimor të tij, e konkretisht:

- ✓ Referuar dosjes së personelit dhe Shkresës Nr.***, datë 02/09/2019 të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, konfirmon se Shtetasi Gjovalin Loka ka kryer Shkollën e Mesme Profesionale “20 Nëntori” Lezhë.
- ✓ Referuar dosjes së personelit dhe shkresës “Kthim Pergjigje” të Akademisë së Sigurisë, konfirmohet se Gjovalin Loka ka filluar studimet në shkollën e lartë 4-vjeçare të Ministrisë së Punëve të Brendshme Policisë në Shtator të vitit 1986 dhe i ka përfunduar në Qershor të vitit 1990, me Nr.Amze 1386. Bazuar edhe në legjislacionin Për Arsimin e Lartë, përkatësisht pika 2 e nenit 124 të Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë” dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH, ku citohet se diplomat e programeve të studimit të lëshuara në RSH që kanë zgjatur së paku 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve sipas sistemit të Bolonjës, janë ekuivalente me diplomat Master i Shkenacve. Në këtë referim ligjor edhe diploma e Z.Gjovalin Loka është ekuivalente me “Master i Shkencave”.
- ✓ Gjithashtu në 12/11/2013 është diplomuar në “Bachelor” Drejtësi (2010-2013) në Univesitetin privat Justicia, me Nr.diplome 000338.

❖ **Konkluzion i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit:**

Në kuptim të legjislacionit për Policinë e Shtetit dhe në Ligjin e fundit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”(i ndryshuar), trupa e vlerësimit arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, që në kohën e emërimit në detyrë për herë të parë në Policinë e Shtetit dhe deri në vijueshmërinë e ecurisë në karrierë të tij, ka qënë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor dhe kualifikimit përkatës për funksionin që ka ushtruar dhe /apo ushtron.

❖ Të dhënat për punësimin:

Në formularin e vetdeklarimit profesional subjekti deklaron marrëdhëniet e tij të punësimit që nga periudha e vitit 2010 e deri në datën e dorëzimit të deklaratës në 2018, ku rezultojnë periudha të aktivitetit privat dhe ato të funksioneve në Policinë e Shtetit vitet Nëntor 2013 e në vijim.

❖ HETIMI NGA TRUPA E KOMISIONIT:

Trupa vlerësuese ka verifikuar deklaratimet e subjektit me dosjen e personelit dhe korrespondencat me institucionet publike dhe vet subjektin, nga ku rezulton se përtej periudhës së fundit 7 vjeçare, bazuar në urdhrat e emërimit dhe largimit në funksione të ndryshme në strukturat e DPPP, ndër vite ka mbajtur funksione policore gjatë periudhave (91-94) 97-2003, 2013 –aktualisht, specifikisht:

- *Punësuar në rradhët e policisë që pas vitit 1991 deri në 1994 (Drejtor në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës) nga vitet 94-97 është liruar nga rradhët e policisë, në vitin 1997 është rimarrë në rradhët e policisë deri në 14 Janar 2004 kur është përjashtuar (Drejtor i Policisë Qarku Lezhë).*
- *Më tej nga vitit 2004 deri Nëntor të vitit 2013, subjekti ka qenë në aktivitet privat të cilat janë të dokumentuara nga korrespondencat e depozituara në Komision nga institucionet përkatëse si dhe nga vet dokumentacioni i përcjellë nga vet subjekti.*
- *Në vitin 2013 është ripranuar në Policinë e Shtetit dhe ku aktualisht, ka patur funksione të larta në Policinë e Shtetit (ndërkohë për efekt të përlllogaritjes kohore të vlerësimit profesional në kuptim të nenit 44 pika 2 dhe 3 e Ligjit 12/2018 (i ndryshuar), për periudhën limit 7 vjeçare deri në datën e plotësimit të deklaratës së vetingut 2018) subjekti ka mbajtur këto funksione:*
- *Më 01/11/2013 – ripranohet në Policinë e Shtetit me vendim gjykate të formës së prerë në funksionin e Drejtorit të Rendit Publik në DPPSH Tiranë, funksion që e mban deri në - 27/04/2017;*
- *Më 28/04/2017 deri më 12/02/2018 Drejtor i Policisë Vendore Shkodër;*
- *Më 16/02/2018 dhe aktualisht Drejtor Departamenti për Sigurinë Publike pranë DPPSh.*

Sa më lart, rezulton se ecuria në karrierë e subjektit që prej vitit 1991 e deri aktualisht (por duke llogaritur deri në datën e plotësimit të deklaratës në maj 2018) ka patur gjithsej vite përvojë pune në rradhët e policisë së shtetit mbi 18 vite kjo për arsye se ka patur dy here ndërprerje të marrëdhënise së tij të punës në rradhet e policisë, përkatësisht në vitet 1994 deri 1997 dhe 2004 deri 2013.

❖ Ecuria e fitimit të gradave

Nga dosja e personelit rezulton se :

- 🇹🇷 Urdhrat e emërimit janë shoqëruar edhe me funksionet dhe gradat policore të përshtatura rast pas rasti për funksionin si dhe rastet e ekuivalentimit të tyre sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kështu konkretisht: Subjekti që në kohën e emërimit për herë të parë në polinë e shtetit, ka patur gradat :

Nr.	Viti	Grada
1	1990	“Oficer”, diploma me mbarimin e shkolles së Lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme
2	1991	“Nëntoger” (bazuar në nenin 3 të Ligjit 7750/1993 “Për gradat në FA të RSH) Neni 3, “Gradën nëntoger e marrin oficerët që mbarojnë Akademinë ose shkollat e Larta ushtarake”.
3	1997	“Kapiten”, (Prill)
4	1997	“Kapiten i Parë”, (shtator 1997)
5	1999	“Major”
6	2001	“Kolonel”
7	2003	“Komisar”
8	2013	“Drejtues”
9	2014	“Drejtues i Parë”
10	2018	“Drejtues i Lartë”

❖ Vlerësimi i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit për dhënien e gradave

Trupa vlerësuese analizoi legjislacionin e kohës për dhënien dhe fitimin e gradave nga ku konkludon se gradat “Nëntoger, Kapiten, Kapiten i Parë, Major dhe Kolonel”, janë dhënë bazuar në Ligjin Për Policinë e Shtetit të vitit 1991 si dhe në legjislacionin për Gradat në Forcat e Armatosura në RSH (Ligj Nr.7750, datë 13.9.1993 “Për gradat në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”), si dhe bazuar në kategoritë e funksionit organik.

❖ Dhënia e gradës Komisar :

Me Urdhrin e Ministrit të kohës në 1 maj 2003, subjektit me funksion Drejtor i Drejtorisë së Policisë së Qarkut Lezhë, i jepet grada “Komisar”.

Trupa vlerësuese në analizë të legjislacionit përkatës të kohës, konkludon se dhënia e gradës nga “Kolonel” në “Komisar” është kryer bazuar në neneve 7,14,26 të Ligjit 8643 datë 20/07/2000 “Për Gradat e Policisë së Shtetit” dhe VKM 64, dt.2.2.2001 “Për Inkuadrimin i Gradës Ushtarake në Gradë Policore (pikat 1, 2, 3) specifikisht në përputhshmëri me pikën 3/ C2 (vjetërsi shërbimi 10 vjet dhe mban gradën “Kolokol”).

Në dosjen e personelit, figuron grada “Major” ekzistuese dhe qe i njihet si rol madhor bazuar në Ligjin e Policisë 1999, subjektit i jepet funksion i Lartë Drejtues me urdhër Ministri dhe Kryeministri Nr.4 , dt.9.01.2001. Po ashtu gradimi “Kolokol” në funksion i “Lartë Madhor” ku nga “Major” që ishte gradë ushtarake shkon “Kolokol” në 2001, sipas urdhrin përsëri të Ministrit të kohës, bazuar në nenin 8 të Ligjit 7750/93 për Gradat në Forcat e Armatosura. Është ekskluziviteti i Ministrit për oficerët e rolit madhor sipas këtij neni.

Më tej, me urdhër ministri, për lirim dhe emërimin në detyrë (Nr. 69, dt.9/4/2002) subjekti me gradë “Kolokol”, lirohet nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, dhe me urdhër të Ministrit nr.681/1, dt.10.04.2002 , emërohet në detyrën e Drejtorit të Policisë.

❖ Dhënia e gradës “Drejtues” (e lidhur me ripranimin në polici)

Dhënia e gradës “Drejtues” rezulton në të njëjtin akt të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë më 3/11/2013 me Nr.2406/2, për ripranimin në rradhët e policisë së shtetit të subjektit Gjovalin Loka.

Si shkak kryesor për ripranimin ka qenë Vendimi Gjyqësor Nr. 3932, datë 26/7/2004 i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit Nr. 946, datë 15/9/2006, i cili

ka anuluar të pambështetur në ligj dhe prova Vendimin Nr.40/1, datë 14/01/2004 të Ministrit të Rendit publik për përjashtimin nga detyra, si dhe Vendimin Nr.5495 datë 11/7/2007, lënë në fuqi me Vendimin Nr.1198 datë 19/6/2008 i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe pas Rekursit të kryer në Gjykatën e Lartë, me Vendimin e datës 19/2/2014, i ka njohur subjektit për detyrimin e Ministrisë së Brendshme si palë e paditur në gjyq për dëmshpërblimin e vendimit të paligjshëm dhe rregullimin e pasojave të krijuara prej tij, duke i njohur paditësit në këtë rast subjektit të vlerësimit Gjovalin Loka, disa të drejta të kthyer si :njohja e vjetërsisë në gradën që kishte, si dhe pagat baze dhe për gradë dhe pagimin e një viti pune (*detajet për vendimet gjyqësore janë referuar edhe në pjesën për kontrollin e figurës*).

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, mori në analizë të gjithë procesin e gjatë ligjor-gjyqësor të kryer ndërmjet palëve siç edhe listuar në pjesën për kontrollin e figurës ku që prej Janar të vitit 2004 kur është ndërmarrë akti i Ministrit të Rendit të kohës, për përjashtimin nga rradhët e policisë së subjektit dhe deri në kohën e rimarrjes në detyrë dhe më tej, renditen një numër prej 11 aktesh/vendimesh gjykatash në harkun e një beteje ligjore më shumë se 10 vite të subjektit.

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, vuri re se pavarësisht se nuk ka vendim gjykate që ka legjitimuar ose njohur në mënyrë të drejtëpërdrejtë të drejtën e rikthimit në polici, ashtu siç dhe arsyetohet më pas në vendimin e Gjykatës së Lartë ku është bërë Rekurs për natyrën dhe masën e dëmshpërblimit, e cila ka referuar në një vendim unifikues³⁸ të Gjykatës së Lartë se kthimi në punë edhe për punonjësit e policisë si punonjës që barazohen me ata që janë në shërbim publik dhe trajtohen me Kodin e Punës, nuk gëzon mbrojtje ligjore.

Në këtë referencë të Vendimit Unifikues të Gjykatës së Lartë por edhe duke zbërthyer ligjin e kohës nr.8553, datë 25.11.1999, “Për Policinë e Shtetit”(i ndryshuar), apo ligjin e mëpasshëm 9749/2007, provohet se ky ligj nuk e njeh rikthimin në punë. Ai nuk i ka dhënë të drejtën gjykatës për të rikthyer në punë punonjësit e larguar nga rradhët e policisë.

Ndërsa Gjykatat e faktit kanë arritur në përfundimin se, meqenëse me vendim të gjykatës së formës së prerë është anuluar akti për përjashtimin nga policia për paditësin, ai duhet të rikthehet në punën e mëparshme. Për rrjedhojë të këtij përfundimi, është bërë e llogaritja e dëmshpërblimit për përjashtimin e bërë në mënyrë të paligjshme, deri në rikthimin në punë.

Rezulton gjithashtu se subjektit menjëherë i është ofruar një post i Lartë “Drejtues”, duke përmbushur edhe funksionin, por edhe vjetërsinë në gradë, pra emërimi i tij në funksionin e lartë të Drejtorit të Rendit Publik, shoqërohet edhe gradën “Drejtues”. Ndërkohë në kohën e shkëputjes së marrëdhënieve të punës në vitin 2004, subjekti mbante gradën “Komisar”.

Mbështetur në VKM 803/2007 për funksionet ekuivalente me gradat, si dhe VKM 917, datë 4/10/2013, grada “Komisar” është ekuivalente me “Drejtues i Parë” .

Sa më lart, Komisioni konstaton dhe arsyen e aktit të ripranimit, pikërisht vendimi gjyqësor që ka anuluar masën disiplinore extreme, i cili duket se ka kthyer subjektin në gjëndjen e mëparshme të ekzistencës së marrëdhënies së tij të punës në policinë e shtetit, kjo edhe bazuar më pas në dizpozitivin e Vendimit të Gjykatës së Apelit që ka vendosur më tej edhe masë dëmshpërblimi financiar.

³⁸ Me vendimin njëhësues nr.3, datë 14.04.2003, të Kolegjeve të Bashkuara është arritur në përfundimin se: Me anë të ankimit në gjykatë punonjësi i policisë, ashtu si dhe një numër tjetër punonjësish publik që kanë detyra të caktuara shërbimi ndaj shtetit, për shkak të të cilave veprojnë si përfaqësues të shtetit për mbrojtjen e interesave të tij, nuk mund të realizojnë *gjyqësisht rikthimin në detyrën që kanë pasur*, edhe nëqoftëse provohet se janë larguar prej saj pa shkaqe të përligjura. E drejta e rikthimit në punë nuk gëzon mbrojtje gjyqësore, ndërsa e drejta e dëmshpërblimit është një e drejtë që gëzon mbrojtje. Pala që dëmtohet nga një pushim i pa drejtë nga puna gëzon të drejtën e dëmshpërblimit në rrugë gjyqësore.

Veprimet e organizatës së policisë për ripranimin bazohen kryesisht në zbatimin e drejtëpërdrejtë të Vendimit të Gjykatës së Apelit Nr.946, datë 15/09/2006, marrë formë të prerë me vendimin e Gjykatës së Lartë Nr.1338, datë 16/11/2007 dhe sipas të cilës subjekti rifiton mundësinë që organizata e policisë së shtetit në vlerësim të organikës së saj dhe të vullnetit të saj t'i japë të drejtën e kthimit në rradhët e policisë së shtetit.

Por duhet theksuar se ka qenë edhe vullneti i Organizatës së Policisë për të ripranuar subjektin bazuar në këtë vendim gjykatë që anulonte masën disiplinore të përjashtimit nga funksioni të subjektit në vitin 2004 duke e konsideruar largimin nga rradhët e policisë të papërligjur.

Në vijim të kësaj, rezulton se subjekti, bazuar në vjetërsinë në funksion dhe në gradë (*vendimi i gjykatës i formës së prerë në 19/2/2014 i ka njohur vjetërsinë e funksionit dhe gradës "Komisar" sipas përcaktimeve të kësaj gjykatë*) brenda një periudhe 6 mujore të ripranimit në polici, i është nënshtruar edhe procesit të riçertifikimit të gradës nga "Drejtues" në "Drejtues i Pare", për shkak edhe të funksionit të lartë që mbante.

Konstatohet se me Vendim (nr.2 datë 27/5/2014) Komisioni i Riçertifikimit për gradë policore për punonjësit e ripranuar në polici (me tre anëtare të komisionit) ka vendosur dhënien e gradës "Drejtues i Pare". Ky çertifikim ka ndjekur të gjitha procedurat³⁹ dhe rregullat standarte që duken të bazuara në aktet rregullatore të Policisë së Shtetit

Komisioni nuk ka informacion më të gjerë/plotë nëse në çdo rast të ngjashëm, Policia e Shtetit detyrimisht çdo vendim të paligjshëm të shpallur nga gjykata, ka gjetur vullnetin e organizatës për rikthim në detyrë, megjithëse i rezulton se në praktikën e riçertifikimit të gradës së subjektit, kishte një listë me ish punonjës që riktheheshin kjo edhe sipas një procedure standarte "Riçertifikimi i punonjësve që ripranohen në polici" miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Nr.691, datë 9/5/2014 si dhe në urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr.724, datë 12/5/2014 "Për krijimin e komisionit të riçertifikimit për gradë policore të punonjësve të ripranuar në polici".

Grada e lartë : "Drejtues i Lartë", është dhënë bazuar në legjislacionin në fuqi, Ligji 108/2014 ku përputhen edhe vitet e punës dhe nga "Drejtues i Parë" në "Drejtues i Lartë" minimalisht duhet të ketë 2 vite pune.

Është konstatuar se subjekti veçanërisht në periudhat prej vitit 2013 e aktualisht ka ecuri në karrierë për shkak edhe të vet pozicionit të emëruar në rol të lartë drejtues në Polinë e Shtetit, ka patur ngarkesa të punës dhe angazhime të shumta për shkak të detyrës dhe ka qenë pjesë përfshirëse në shumë grupe pune të nivelit kryesisht menaxherial.

❖ **Vlerësimet e punës**

Në dosjen e personelit të subjektit, gjenden vlerësimet e performancës për vitet 2016, 2017 dhe 2000.

- ✓ Vlerësim i rezultateve individuale të punës, Drejtoria e Përgjithshme për Sigurinë Publike, Drejtoria e Rendit Publik, nga 01/01/2015 deri më 31/12/2015
Vlerësuar me 28 pikë maksimale.

³⁹ Vendim nr.2, datë 27/5/2014 Komisioni i Riçertifikimit për vlerësimin në grade policore, punonjësve të ripranuar në polici, Vërtetim personaliteti, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, Kërkesë e subjektit, Vërtetim mjeko ligjor, CV etj.

- ✓ Vlerësim i rezultateve individuale të punës, Drejtoria e Përgjithshme për Sigurinë Publike, Drejtoria e Rendit Publik, nga 01/01/2016 deri me 31/12/2016
Vlerësuar me 28 pikë maksimale.
 - Avokati i Popullit, konfirmon se nuk rezulton të ketë pasur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht për subjektin Gjovalin Loka.
 - Gjithashtu, pranë adresës zyrtare të Komisionit, nuk janë paraqitur denoncime nga publiku ndaj subjektit për shkelje të rregullave të etikës gjatë ushtrimit të detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, sipas parashikimit ligjor të Ligjit 12/2018 (i ndryshuar).
 - Në formularin e vlerësimit profesional, subjekti ka deklaruar një sërë punësh në formën e: Informacioneve, memove, planeve të punës, pjesëtar në grupe të ndryshme të ngritura me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për hartim aktesh nënligjore, si psh në hartimin e ligjit për masat shpesh të sigurinë publike, ligjin “Për Policinë e Shtetit”, Rregulloren e Policisë së Shtetit apo edhe memo për zbatimin e legjislacioneve të ndryshme, problematikat e konstatuara etj.

❖ **Vlerësimi mbi tre dokumentet e përgatitura nga subjekti përkatësisht :**

Në dosjen e personelit janë administruar plane pune për garantimin e sigurisë publike në evente të ndryshme, periudha të ndryshme.

Nga njohja, studimi dhe analizimi i këtyre dokumenteve të punës të përgatitura nga subjekti në raport me funksionin dhe përshkrimet funksionale të punës (niveli menaxherial), trupa vlerësuese konstaton se ato janë në përputhje me legjislacionin e Policisë së Shtetit, rregullores së brendshme të saj, procedurave standarde të punës të kërkuara për hartimin e dokumenteve/dokumenteve strategjike etj., dhe për të cilët duhet të veprojnë strukturat zinxhir në policinë e shtetit.

Planet strategjike /programet e punës janë hartuar me elementët standard sipas modelit të miratuar ku përshkruhen prioritetet strategjike për t’u zbatuar gjatë vitit, objektivat, masat dhe detyrat që do realizohen për arritjen e çdo objektivi dhe prioriteti, afatet, strukturat përgjegjëse për zbatim, etj.

Gjatë zhvillimit të seancës publike, trupa vlerësuese i drejtoi pyetje subjektit lidhur me ushtrimin e funksioneve të tij si Drejtor Departamenti dhe rolin e përgjegjësive të drejtorive dhe strukturave në varësi të tij gjatë performancës së tyre për zbatimin e drejtë të ligjit si dhe rastet e tejkallimit të kompetencës funksionale në përdorim të dhunës apo të cënimit të të drejtave të qytetarëve.

Subjekti u përgjigj se Policia e Shtetit ka bërë veprime të ligjshme e standarte që janë konfirmuar edhe nga partnerët ndërkombëtarë që asistojnë si Pameca, Icitap etj. Sigurisht që ka patur edhe raste sporadike kur është tejkalluar kompetenca nga policia. Në këto raste janë proceduar policë me masa që nga heqja e pagës e deri me përjashtim nga policia.

❖ **Kualifikimet dhe trajnimet**

Në dosjen e personelit gjenden edhe një sërë trajnimesh dhe certifikata të seminareve të ndjekura ndër vite.

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, arrin në përfundimin se: trajnimet dhe pajisja me certifikata është kryer gjatë karrierës së tij dhe se janë të lidhura me ushtrimin e funksioneve të tij në detyra të posaçme të departamenteve ku ka punuar.

Po ashtu, urdhrat e shpërblimeve dhe certifikatat për shërbime të dalluara janë dhënë bazuar në Ligjin e Policisë së Shtetit 108/2014(i ndryshuar), neni 67 dhe 140 e tij si dhe në aktet/urdhrrat përkatës së Ministrisë të Brendshme dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për përfitimin dhe masën e shpërblimit të punonjësve të Policisë së Shtetit.

- J Urdhër 2015: shpërblim (një pagë mujore) për rezultate të larta në rritjen e standarteve të rendit dhe sigurisë publike në vend;
- J Viti 2016: “*Certifikatë për shërbime të dalluara*” (shoqëruar me shpërblim) 50.000 (pesëdhjetë mijë) lek;
- J Vitit 2017: Urdhër shpërblim për punë cilësore dhe merita të veçanta (Gusht) një pagë mujore;
- J Viti 2017 : “*Certifikatë për shërbime të dalluara*” me shpërblim (Nentor) 50.000(pesëdhjetë mijë) lek;
- J Viti 2017: Urdhër shpërblim kontribut në kryerjen e operacioneve të rëndësishme policore hetimin dhe ndalimin e veprave penale Dhjetor 40.000 (dyzetë mijë) lek;
- J Viti 2018 : Urdhër “Përkushtim dhe profesionalizëm në aritjen e rezultateve të larta në raport me periudhat paraardhëse, duke mundësuar realizimin e objektivave strategjike dhe programin vjetor të Policisë së Shtetit”, (shpërblim një pagë mujore);
- J Viti 2019 : “*Certifikatë për shërbime të dalluara për merita të veçanta*” në përmushjen e detyrave dhe kontributin e dhënë gjatë viteve për sigurimin e rendit e qetësisë publike në shërbim të Policisë së shtetit, (shpërblim 50.000(pesëdhjetë mijë)lek.
- J Maj 2019: Urdhër shpërblimi me një (pagë mujore) për rezultate të larta në kryerjen e detyrës.
- J Dhjetor 2019 :(Urdhër Nr.636, dt.18.12.2019) Medalje Nderi dhënë nga Ministri i Brendshëm për “Drejtimin dhe organizimin e nivelit operacional të strukturave të policisë së shtetit, kontribut të jashtëzakonshëm dhe profesionalizëm të lartë, në ushtrimin e përgjegjësive të parashikuara nga ligji “ Për policinë e shtetit” të treguar në operacionet e kërkim-shpëtimit, pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.

Subjekti gjithashtu është trajtuar në mënyrë periodike me dieta dhe trajtimin për ushqim e veshmbathje, kjo mbështetur në Ligjin e “Policisë së Shtetit”.

❖ **Ecuria disiplinore**

Nga verifikimet e thelluara të Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, rezulton se nuk ka në dosje asnjë masë disiplinore gjatë viteve 2013 në vijim. Siç dhe referuar në pjesën e kontrollit të figurës, subjekti është ripranuar në Policisë e Shtetit pas një vendimi të formës së prerë që ka shpallur të paligjshëm aktin e përjashtimit nga detyra në vitin 2004 si dhe rasti i një analizimi për një “tërheqë vemendje” për një veprim policor në vitin 2016 e trajtuar hollësisht në pjesën e kontrollit të figurës dhe për të cilën nuk është pjesë e ndonjë procedimi disiplinor, pasi nuk u provua se kishte elementë për procedim disiplinor dhe si e tillë nuk shënohet as në dosjen personale të subjektit.

❖ **Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit:**

Është i aftë pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të përshkrimeve të punës të përcaktuara për atë funksion, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme.

Konkluzione Përfundimtare

Trupa vlerësuese e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatorit të çështjes, parashtrimet me shkrim të depozituar nga subjekti i vlerësimit më përkatësisht datat 30/09/2019, 22/11/2019; 25/11/2019; 08/06/2020 dhe 09/06/2020, pasi dëgjoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i vlerësimit në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 19/08/2020, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, Gjovalin Bardhok Loka, në përputhje me nenin 60 të Ligjit 12/2018 (i ndryshuar), ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*
- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;*
- *Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale;*

PËR KËTO ARSYE

Trupa Vlerësuese e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, bazuar në pikën 7, 8, të nenit 56, të Ligjit Nr.12/2018 (të ndryshuar), pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në mbështetje të shkronjës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të Ligjit Nr. 12/2018 (i ndryshuar),

V E N D O S I:

- 1- Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit Gjovalin Bardhok Loka, me funksion “*Drejtor Departamenti për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit*”.
- 2- Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
- 3- Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit 12/2018 (i ndryshuar).
- 4- Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- 5- Ky vendim u shpall sot datë 19.08.2020, në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

Luljeta Qoku
Kryesues

Sonila Kadareja
Relator

Ledian Rusta
Anëtar